


REVISTË SHKENCORE DHE KULTURORE

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti II (XVI) - Nr. 4 (157) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJË | PSIKOLOGJË | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

4

2013

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI II (XVI) 2013 NR. 4 (157)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.kmsh.al
www.zaninalte.al

Tiranë 2013

Revistë shkencore dhe kulturore

Zani i Naltë

Organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923

Rifilluar në tetor 2012 VIII II (XVI), korrik, gusht, shtator 2013, nr. 4 (157)

Nën kujdesin: H. Selim Muça

Kryeredaktor & Drejtor: Dok. Genti Kruja

Bordi editorial: H. Bujar Spahiu
M.A. Ali Zaimi
Dr. Ferdinand Gjani
Prof. Dr. Qazim Qazimi
Prof. Dr. Ayhan Tekines
Prof. Dr. Njazi Kazazi
Prof. Dr. Hajri Shehu
Dr. Bayram Karci
Dok. Ramadan Çipuri
Dok. Skender Bruçaj
M.A. Dorian Demetja
M.A. Elton Karaj

Redaktor: M.A. Andrin Rasha

Fushat: Shkencat Islame
Tefsir
Hadith
Fikh
Sociologji
Filozofi
Gjuhësi
Letërsi
Psikologji
Histori
Kulturë
Art, etj.

Realizimi grafik: Bledar Xama

Fotoja në kopertinë: Shpëtim Bashmili
Xhamia Selimije, Lezhë
(sot varri monumental i Skënderbeut)

**KOMUNITETI MYSLIMAN
I SHQIPËRISË:**



9 772305 655001

**Rr. George W. Bush, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri
mail: info@kmshe.al**

**web: www.kmshe.al
www.zaninalte.al**

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Respekti ndaj Ramazanit
- **MA. Elton Karaj- Universiteti Bedër**.....5

Letërsi

2. “Hafiz Ali Korça - Hoxha i përndjekur”- (Vështrim për Abetaren e tij) -
Prof. dr. Njazi Kazazi – Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.....11
3. “Për fe dhe atdhe”; një letërsi vizionare dhe misionare
- **MA. Brikena Smajli – Tiranë**.....14

Histori

4. Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes kombëtare
H. Vebbi Dibra njëri nga shembujt konkretë
- **MA. Genti Kruja – Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**.....21
5. Kontributi i ulemave dibranë për çështjen shqiptare
- **Mr. Ruzhdi Lata-Dibër e Madhe, Maqedoni**.....28
6. Roli i imamëve dhe i ulemave në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare
- **MA. Ramadan Shkodra-Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë**.....32

Filozofi

7. Qasjet estetike në mendimin filozofik mysliman
- **Msc. Redi Shehu - Tiranë**.....43

Shkenca Komunikimi

8. Komunikimi përmes objekteve të kultit islam
- **Msc. Ferit Lika - Tiranë**.....53

Personalitete

9. I nëmuri i fundmë i rilindjes kombëtare
- **Prof. dr. Rahim Ombashi – Universiteti Bedër**.....71
10. Një shqiptar në shërbim të njerëzimit: Mehmet Akif Ersoj
- **MA. Eduard Caka**.....88

Aktivitete - Promovimi i revistës “Zani i Naltë”

11. Lajmi.....99
Kumtesat:
12. Përshëndetja e Kryetarit.....102
13. Prof. Dr. Ferit Duka.....103
14. Besnik Mustafaj.....104
15. Dr. Agron Tufa.....107

Retrospektivë

16. Problemi fetar dhe filozofia (II)
- Prof. Vexhi S. Demiraj.....110
17. Pasqyrat e fletoreve dhe e rivistave që janë botuar prej vitit 1882 deri në fund të vitit 1927 - nga Teki Selenica.....114



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

RESPEKTI NDAJ RAMAZANIT

MA. Elton Karaj

Hyrje

Faja Islame është e ndërtuar mbi dy baza. Njëra është besimi/imani, e tjetra është praktikimi/Islami. Nëse një njeri dëshiron ta quajë veten e tij mysliman me kuptimin e plotë të fjalës, duhet të vendosë në jetën e tij të dyja këto baza të fesë. Sepse, megjithëse nga kuptimi leksikor i dy fjalëve iman dhe islam ka një ndryshim; mendimi më i saktë i pranuar është se s'mund të ketë Islam pa iman, dhe as iman pa Islam¹.

Njëra nga pesë pjesët përbërëse të Islamit është edhe agjërimi i muajit të Ramazanit, me të cilin është urdhëruar çdo besimtar i fesë Islame. Agjërimi ka qenë një nga adhurimet më të rëndësishëm duke nisur që nga Hz. Adem alejhisselam. Me ardhjen e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), ky adhurim ka ruajtur këtë rëndësi dhe është caktuar si detyrim në ditën e dhjetë të muajit Shaban në vitin e dytë të hixhretit me anë të këtij ajeti:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى
الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.”²

1 Gülen, Fethullah, *Kendi Dünyamıza Doğru*, Nil yay., Stmaboll 2010:179.

2. Bekara 2/183.

Agjërim do të thotë të largohesh nga ngrënia, pirja dhe kryerja e marrëdhënieve intime me qëllim adhurimi, që nga agimi deri në perëndimin e diellit dhe është detyrim/farz për çdo person, burrë e grua, që është mysliman, në moshë madhore (të ketë hyrë në moshën e pubertetit), i shëndoshë mendërisht dhe fizikisht dhe nuk është i sëmurë apo udhëtar.

Respekti ndaj Ramazanit

Çdo person agjërues ka gjendjen e tij të veçantë, por në këtë artikull do të trajtojmë vetëm gjendjen e tri grupeve të mëposhtme gjatë muajit të Ramazanit:

1. Personat që nuk agjërojnë, që nga nisja e ditës, për një shkak, apo një pengese të justifikueshme,

2. Personat, të cilët e kanë nisur agjërimin e Ramazanit, por që gjatë ditës në një farë mënyre i është prishur,

3. Personat, të cilët në krye të ditës nuk kanë qenë në gjendje të përshtatshme për ta nisur agjërimin, por që gjatë ditës shpëtojnë prej kësaj gjendjeje.

Si do të sillen grupet e lartpërmendur në pjesën e mbetur të ditës?

Kjo çështje është trajtuar në veprat klasike të jurisprudencës islame dhe në bazë të argumenteve e të interpretimit çdo medh'heb ka paraqitur gjykimin e tij. Që në krye mund të themi, që sipas medh'heb hanefi dhe hanbeli, të tri

grupet e lartpërmendur e kanë vaxhib vazhdimin e agjërimit gjatë ditës në muajin e Ramazanit. Sipas medh'heb shafii e kanë mustehab, kurse sipas medh'heb maliki nuk është as vaxhib e as mustehab.³ Shkaku i kësaj dispozite të veçantë është ekzistenca e një respekti të veçantë kundrejt muajit Ramazan.

Në një hadith të transmetuar prej Seleme b. Ekua (r.a) thuhet kështu:

بَعَثَ رَسُولُ اللَّهِ رَجُلًا مِنْ أَسْلَمَ يَوْمَ عَشْرَاءَ فَأَمَرَهُ أَنْ يُؤَدِّنَ فِي النَّاسِ: مَنْ كَانَ لَمْ يَصُمْ فَلْيُصِّمْ وَمَنْ كَانَ أَكَلَ فَلْيُصِّمْ صِيَامَهُ إِلَى اللَّيْلِ.

*"I Dërguari i Allahut (s.a.s) dërgoi ditën e Ashures dikë nga fisi Eslem t'i japë njerëzve këtë lajm: Kush nuk e ka nisur agjërimit, le ta nisë atë; kush ka ngrënë diçka, le të qëndrojnë larg ngrënies e pirjes deri në mbrëmje."*⁴

Duke u nisur pikërisht nga ky hadith i transmetuar *muttefekun alejh*⁵, dijetarët e jurisprudencës islame, duke aplikuar kijasin (analogjinë), për shkak se atëherë agjërimit i ditës së ashures ishte farz, të njëjtën dispozitë e quajnë të vlefshme edhe për agjërimitin e muajit Ramazan, i cili është quajtur si farz më pas.⁶

Profeti (s.a.s), urdhëron që kush nuk ka ngrënë asgjë në krye të ditës të agjërojë, e kush ka ngrënë, për shkak të respektit ndaj periudhës kohore, të vazhdojnë ditën sikur të ishin agjërueshëm. Në bazë të kësaj, dijetarët shprehin që personat të cilët nuk agjërojnë, që nga fillimi i ditës për një shkak të një pengese, ata të cilët në

krye të ditës nuk kanë qenë në gjendje të përshtatshme për ta nisur agjërimitin, por që gjatë ditës kanë shpëtuar prej kësaj gjendjeje dhe ata të cilët e kanë nisur agjërimitin e Ramazanit, por që gjatë ditës në një farë mënyre, me dashje ose pa dashje, i është prishur, duhet/e kanë vaxhib, që pjesën e mbetur të ditës ta vazhdojnë porsì një agjëruës. Sepse koha e Ramazanit është e çmuar dhe për këtë arsye duhet treguar sa më tepër respekt ndaj saj. Nëse për çfarëdolloj shkaku nuk kemi mundësinë ose na ikën nga duart mundësia për ta respektuar atë me anë të një agjërimi të plotë, kemi për detyrë që ta respektojmë, duke i përngjasuar sa më tepër agjëruësve. Në këtë mënyrë personi e shpëton veten edhe prej paragjykimeve të njerëzve.⁷

Kjo çështje është parashtruar kështu në librin el-Ihtijar të imam Meusiliut: Personi duhet të vazhdojë të agjërojë në pjesën e mbetur të ditës, në mënyrë që të shpëtojë nga paragjykimet. Të qëndrosh larg paragjykimeve të të tjerëve është vaxhib, sepse Profeti (s.a.s) shprehet kështu:

مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلَا يَقَعَنَّ مَوَاقِعَ النَّهْمِ
*"Kush i beson Allahut dhe ditës së gjykimit të qëndrojnë larg vendeve të dyshimta (vendeve që mund të çojnë të tjerët në paragjykime)"*⁸

Si përfundim, këta persona, duke nisur nga momenti i heqjes së pengesave të agjërimit e deri në vaktin e akshamit duhet të sillen si agjëruës.

Tani, duke e parashtruar çështjen në bazë të tri grupeve të përmendur

3. Zuhajli, Uehbe, *el-Fikhu el-Islami ue Edil'letubu*, Daru'l-fikr I-VIII, Sham 1989, Botimi, III, 649; en-Neueui, Muhjiddin Jahja b. Sheraf, *el-Mexhmu' Sberhu el-Muhedhdheb*, Dar el-Fikr I-XX, Bejrut 2000, VI, 252-253.

4. Buhari, 2/692, Muslim, 2/798.

5. Muttefekun alejh: Hadith i transmetuar nga dy librat themelorë të hadithit Buhari dhe Muslim

6. et-Tahanevi, Meulana Eshraf Ali, *Ila es-Sunen*, Arabia Saudite, viti hixhri (sipas kalendarit hënor) 1415, Botimi 3, IX, 168.

7. el-Kâsâni, Ebu Bekr b. Mesud b. Ahmed, *Bedai es-Sanai' fi Tertibi esh-Sherai'*, I-VII, Botimi 1, II, Bejrut 1996:155.

8. el-Meusilî, Abdullah b. Mahmud b. Meudud, *el-Ihtiyar li-Ta'lîl el-Muhtar*, I-V, Bejrut 2002, Botimi 1, I, 179; ez-Zejla'î, Xhemaluddin Abdullah b. Jusuf b. Muhammed, *Tabrixb el-Ehadithi ue el-Athar el-Uakia fi Tefsiri el-Keshshaf li ez-Zemahsberi*, Dar Ibn Huzejme, I-IV, Rijad 1414 hixhri, I, 136.

në krye të artikullit, do të mundohemi të qartësojmë, se si duhet të sillen këta persona në pjesën e mbetur të ditës.

1. Personat, të cilët nuk kanë kompetencë zbatimi për të agjëruar që në krye të ditës

Kompetencë zbatimi do të quhet kompetenca e domosdoshme, që veprat e personit të quhen të vlefshme juridikisht. Baza e kësaj kompetence nuk është qenia e personit në jetë, por ekzistenca e aftësisë dalluese.⁹ P.sh: të dallosh të mirën nga e keqja, të drejtën nga e gabuara. Nëse personi ka kompetencë zbatimi, atëherë vepra e tij është e vlefshme juridikisht, nëse jo, atëherë vepra e tij është e pavlefshme.

Këtë grup mund ta ndajmë në dy nëngrupe:

a) Fëmijët të cilët nuk kanë kompetencë zbatimi në krye të ditës

Agjërimet në muajin e Ramazanit e fëmijëve, të cilët nuk kanë kompetencë zbatimi, vlerësohen si nafile.¹⁰ Sepse agjërimi i muajit të Ramazanit është farz dhe për të zbatuar një adhurim farz është kusht të kesh kompetencën e zbatimit. Kështu që, fëmijët të cilët nuk kanë mbushur moshën e pubertetit nuk kanë kompetencë zbatimi dhe si rezultat nuk janë të detyruar të agjërojnë muajin e Ramazanit. Megjithatë, siç u shprehëm më sipër, agjërimi i tyre është i vlefshëm dhe quhet si një adhurim nafile.

Nëse fëmija që në krye të ditës në muajin e ramazanit nuk posedon kompetencë zbatimi, gjatë ditës hyn

në moshën e pubertetit, ai e fiton automatikisht kompetencën dhe kështu, në pjesën e mbetur të ditës e ka vaxhib të sillet si një agjëruar.¹¹ Vetëm se, kjo pjesë e ditës nuk quhet si agjërim. Ai do të sillet pors një agjëruar për shkak të respektit ndaj Ramazanit. Kurse sipas medhhebit shafii, fëmija e ka mustehab të sillet pors të agjëruar në pjesën e mbetur të ditës.¹²

Fëmija që hyn në moshën e pubertetit gjatë ditës nuk e ka për detyrë të bëjë kazanë (të agjërojë më pas) e kësaj dite dhe të atyre të mëparshmeve të muajit të Ramazanit në të cilin ndodhet.¹³ Sepse ai nuk e kishte farz agjërimin e kësaj dite dhe të atyre të mëparshme. Por, duke nisur nga dita e mëpasme, për shkak se u realizua shkaku i agjërimit¹⁴ dhe kompetenca e zbatimit, ai duhet të nisë të agjërojë muajin ramazan.¹⁵

Nëse një fëmijë bën nijet për të agjëruar përpara zevalit (koha kur dielli ndodh në kupolën e qiellit, pra koha e hyrjes së vaktit të namazit të drekës) dhe më pas hyn në moshën e pubertetit, përsëri agjërimi i tij *nuk është i vlefshëm si farz*, sepse në krye të ditës ai nuk posedonte kompetencën

11. el-Kasani, *po aty*, II, 154; Komision, *Fetava-ya Hindiyë*, Prkth: Mustafa Efe, Akçağ Yay. I-XVI, Ankara - pa datë, II, 72; et-Tehaneui, *po aty*, IX, 168.

12. esh-Shirbini, Muhammed b. Ahmed el-Hatib, *Mugni el-Muhtaxh ila Ma'rifeti Eljadbi el-Minhaxh*, Dar el-Marife I-IV, Bejrut 1997, I, 438.

13. Mehmet Zihni Efendi, *Nimet-i İslam*, Huzur Yay., Stamboll 2004, f. 671; en-Neueui, *po aty*, VI, 253; Zuhajli, *po aty*, III, 181.

14. Shkaku i agjërimit është hyrja e muajit Ramazan ose, siç është në këtë rast, të ndodhesh në këtë muaj.

15. es-Sivasi, Kemaluddin Muhammed b. Abdilvahid, *Sherb Fet'h el-Kadir*, Dar el-Fikr, I-VII, Bejrut – pa datë, II, 363-365; Shih: Ibn Nuxhejm, *el-Bahr err-Rraik Sberbu Kenz ed-Dekaiik*, II, 313.

9. Shaban, Zekijuddin, *İslam Hukuk İminin Esaslar*, Prkth: Prof. Dr. İbrahim Kafi Dönmez, Ankara 2000:296.

10. Ibn Abidin, *Raddu el-Mubtar ala ed-Durri el-Mubtar*, Prkth: Ahmet Davutoğlu, Şamil Yay. I-XVIII, Stamboll 1983, IV, 308.

e zbatimit. Kështu që ky adhurimi i tij është i pjesshëm, kurse agjërimi është një adhurim që nuk pranon pjesëzim.¹⁶ Ai duhet të nisët në krye të ditës e të përfundojë në aksham në të njëjtat kushte. Por agjërimi i tij vlerësohet si nafle, sepse ai është kompetent për një agjërimit të këtij vlerësimi juridiko-fetar. Nëse agjërimi nisët me këtë nijet, duhet të plotësohet deri në fund, përndryshe quhet si prishja e agjërimit nafle dhe ai që e prish atë duhet të bëjë kazanë.¹⁷

Sipas medhëbit shafii, ndryshe nga ai hanefi, nëse një fëmijë bën nijet për të agjëruar përpara zevalit dhe më pas hyn në moshën e pubertetit, agjërimi i tij është i vlefshëm si *farz*, por nëse prishet gjatë ditës, fëmija nuk e ka borxh kazanë e kësaj dite.¹⁸

b) Personat, të cilët nuk posedojnë kompetencë të zbatimit në krye të ditës për shkak se nuk janë myslimanë, por që më pas pranojnë Islamin

Nëse një mosbesimtar, kthehet në mysliman gjatë ditës në muajin e Ramazanit, është vaxhib të sillët pors një agjërues në pjesën e mbetur të ditës.¹⁹ Megjithatë, kjo ditë nuk quhet si e agjëruar. Gjithashtu personi në fjalë nuk është i detyruar të bëjë kazanë e saj pas Ramazanit. Por, duke nisur nga dita e mëpasme, për shkak se u realizua shkaku i agjërimit dhe kompetenca e zbatimit, ai duhet të nisët të agjërojë muajin Ramazan.²⁰ Sipas medhëbit

shafii, personi i konvertuar në mysliman gjatë ditës në muajin Ramazan e ka mustehab të sillët si agjërueshëm në pjesën e mbetur të ditës. Gjithashtu, nëse nuk sillët si i tillë, nuk ka borxh kazanë e kësaj dite.²¹

Nëse një mosbesimtar, kthehet në mysliman përpara zevalit gjatë ditës në muajin e Ramazanit dhe bën menjëherë nijet për agjërimit, përsëri agjërimi i tij nuk vlerësohet si *farz*, megjithëse ai mund të mos ketë ngrënë asgjë pas hyrjes së namazit të sabahut, pra kohës së nisjes së agjërimit. Sepse personi në fjalë nuk posedonte kompetencën e zbatimit në krye të ditës. Për më tepër, ndryshe nga fëmija që hynte në moshën e pubertetit gjatë ditës në Ramazan, nuk i quhet as si agjërimit nafle, përsëri për shkak ai nuk ka patur kompetencë për agjërimit nafle në krye të ditës.²²

Personat, të cilëve i prishet agjërimi gjatë ditës

Personat, të cilëve i prishet agjërimit gjatë ditës me dashje ose pa dashje, e kanë përsëri vaxhib të sillen pors agjërues në pjesën e mbetur të ditës.²³ Kjo do të thotë që, nëse personi në fjalë vazhdon të ushqehet pasi i është prishur agjërimit, ai bëhet mëkatar.

Agjërimit i personit që mendon se nuk ka hyrë namazi i sabahut dhe vazhdon syfyrimin anulohet dhe duhet bërë vetëm kazaja pas Ramazanit. Edhe ky person, megjithëse agjërimit i është prishur në krye të ditës, e ka vaxhib ta kalojë të gjithë ditën pors një agjërues.²⁴

16..es-Sivasi, *po aty*, II, 364.

17. Ibn Abidin, *po aty*, IV, 308.

18. En-Neueui, *po aty*, VI, 253; esh-Shirbini, *po aty*, I, 437-438.

19. El-Kasani, *po aty*, II, 154; Fetava-yı Hindiyye, II, 72; et-Tehaneui, *po aty*, IX, 168; Zuhajli, *po aty*, III, 180.

20. es-Sivasi, *po aty*, II, 363-365; Shih: Ibn Nuxhejm, *po aty*, II, 313.

21. Esh-Shirbini, *po aty*, I, 438; en-Neueui, *po aty*, VI, 252.

22. Ibn Abidin, *po aty*, IV, 308.

23. El-Kasani, *po aty*, II, 154-155; Fetava-yı Hindiyye, II, 72.

24. Ibn Abidin, *po aty*, IV, 307; es-Sivasi, *po aty*, II, 372.

2. Personat, të cilët në krye të ditës nuk kanë patur një justifikim të vlefshëm për të mos e nisur agjërimin, por që gjatë ditës shpëtojnë prej kësaj gjendjeje

Pesë janë rastet, të cilat quhen justifikime të vlefshme për mosmbajtjen e agjërimit gjatë muajit Ramazan:

1. Udhëtimi²⁵
2. Sëmundja
3. Pleqëria
4. Shtatzënia dhe laktacioni
5. Uria dhe etja e thellë

Pra, personi përgjegjës për agjërimin e muajit Ramazan, nëse është udhëtar ose nëse sëmuret, ka leje të mos agjërojë për aq ditë sa vazhdon kjo gjendje.²⁶ Gratë, të cilat janë të përmuajshme gjithashtu e kanë të ndaluar agjërimin.²⁷ Por këta grupe duhet të bëjnë kazatë e ditëve të paagjëruara. Pleqëria dhe uria e etja e thellë gjithashtu janë shkaqe për mosagjërim.

Nëse udhëtarit i përfundon udhëtimi, i sëmuri shërohet, apo grave i përfundon përmuajshmëria gjatë ditës në muajin e Ramazanit, personat në fjalë e kanë vaxhib ta kalojnë pjesën e mbetur të ditës porsia agjëruesis. Kështu, për

25. Që një person të quhet juridikisht udhëtar, duhet të udhëtojë në një vend të largët minimumi në një distancë 90 km ose më tepër.

26. Bekara 2/184:

أَيُّهَا الْمُعْتَدُونَ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامٍ مَسْكِينٍ فَمَنْ تَلَوَّحَ خَيْرًا فَأْتُوا بِهِمْ خَيْرٌ لَهُ وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ **“Agjërimi zgjat disa ditë, por nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.”**

27. Shih: Ibni Maxhe, *Sijam*, 3; Nesai, *Sijam*, 50-51, 62.

shkak të respektit ndaj Ramazanit. Kjo ditë duhet të bëhet kaza më pas, sepse nuk është e vlefshme si agjërim. Siç kaloi edhe më parë, agjërimi nuk pranon pjesëzim.

Por, nëse udhëtarit bën nijet për agjërim përpara se t'i përfundojë udhëtimi, e të kthehet në vendas, ose nëse është në kohë për të bërë nijet për agjërim, d.m.th., përpara zevalit, dhe më parë nuk ka vepruar asgjë që ta prishë agjërimin, atëherë ai mund ta plotësojë ditën si agjërues i Ramazanit. Sipas medhëhebit shaffi është mustehab, që personat në fjalë të sillen porsia agjërues për shkak të respektit ndaj Ramazanit. Nuk e kanë vaxhib, sepse ashtu siç ndodh me personat që kthehen në vendas pasi kanë shkurtuar namazin, rënia e justifikimit nuk ndikon pasi të jetë përdorur leja. Por, nëse nuk agjërojnë, është mustehab që të ushqehen në fshehtësi.²⁸

Përfundim

Siç mund të kuptohet qartësisht, personat të cilët nuk agjërojnë që nga fillimi i ditës për një shkak të një pengese, ata të cilët në krye të ditës nuk kanë qenë në gjendje të përshtatshme për ta nisur agjërimin, por që gjatë ditës kanë shpëtuar prej kësaj gjendjeje dhe ata të cilët e kanë nisur agjërimin e Ramazanit, por që gjatë ditës në një farë mënyre, me dashje ose pa dashje, i është prishur, duhet/e kanë vaxhib që pjesën e mbetur të ditës ta vazhdojnë porsia një agjërues.

E thamë edhe në krye të shkrimit, që adhurime të tilla si agjërimi kanë rëndësi të madhe. Për këtë arsye edhe dispozitat rreth tij janë të trajtuara deri në detajet më të thella. Çdo mysliman ka për detyrë

28. esh-Shirbini, *po aty*, I, 438; en-Neueui, *po aty*, VI, 254, 261-262.

që t'i përshtatet këtyre vlerësimeve. Kjo do të tregojë edhe se sa rëndësi i jep çdo person urdhëresave të fesë.

Nga ana tjetër, këtu trajtuam edhe dispozitat në lidhje me personat mosbesimtarë, të cilët e pranojnë fenë Islame ditën (dhe jo natën) në muajin e Ramazanit. Në momentin që ata konvertohen në besimtarë dhe janë në moshë madhore, duhet të nisin menjëherë të sillen porsì një agjërues. Mos të harrojmë që kjo është një dispozitë juridike, praktikimi i së cilës mund t'i vijë rëndë një personi që sapo ka pranuar fenë. Prandaj, në këtë rast, duhet bërë një analizë e thellë rreth “myslimanit të ri”. Nëse ai është

në gjendje ta përballojë njohjen me një praktikë të tillë, atëherë i duhet prezantuar edhe kjo dispozitë. Nëse është e kundërta, p.sh., nëse ai ka shprehur që pranon fenë, por ende nuk është i gatshëm për praktikimin e urdhëresave, d.m.th., nëse ka pranuar imanin/besimin dhe ende jo islamit/pratikimin, atëherë personat, të cilët po e prezantojnë atë me fenë Islame, duhet të jenë të matur në kumtimin e këtyre dispozitave. Dispozita, të cilat edhe shumë besimtarë e praktikantë “të vjetër” të fesë Islame “ndoshta” nuk e kanë idenë që ekzistojnë.

Allahu di gjithçka më së miri!

BIBLIOGRAFI

El-Buhari, Ebu Abdil'lah Muhammed b. Ismail, *Sahib*, Dar Tauki en-Nexhat, I-IX, Bejrut 2001.

Gülen, Fethullah, *Kendi Dünyamıza Doğru*, Nil Yay., Stamboll 2010,

Ibn Abidin, *Raddu el-Mubtar ala ed-Durri el-Mubtar*, Prkth: Ahmet Davutoğlu, Şamil Yay. I-XVIII, Stamboll 1983.

El-Kâsâni, Ebu Bekr b. Mesud b. Ahmed, *Bedai es-Sanai' fi Tertibi esb-Sherai'*, I-VII, Bejrut 1996, Botimi 1.

Komision, *Fetava-yı Hindîye*, Prkth: Mustafa Efe, Akçağ Yay. I-XVI, Ankara - pa datë.

Mehmet Zihni Efendi, *Nimet-i Islam*, Huzur Yay., Stamboll 2004.

El-Meusilî, Abdullah b. Mahmud b. Meudud, *el-Ihtiyar li-Ta'lîl el-Mubtar*, I-V, Bejrut 2002, Botimi 1.

Es-Sivasi, Kemaluddin Muhammed b. Abdilvahid, *Sherb Fet'h el-Kadir*, Dar el-Fikr, I-VII, Bejrut – pa datë.

Muslim, Ebu el-Husejn Muslim b. el-Haxhxhaxh, *Sahib*, Dar Tajbe, Rijad 2006.

En-Neueui, Muhjiddin Jahja b. Sheraf, *el-Mexbmu' Sherbu el-Mubedbdbeb*, Dar el-Fikr I-XX, Bejrut 2000.

Esh-Shirbini, Muhammed b. Ahmed el-Hatib, *Mugni el-Mubtaxb ila Ma'rifeti Elfadbi el-Minbaxb*, Dar el-Marife I-IV, Bejrut 1997.

Et-Tahanevi, Meulana Eshraf Ali, *I'la es-Sunen*, Arabia Saudite, viti hixhri (sipas kalendarit hënor) 1415, Botimi 3.

Ez-Zejla'i, Xhemaluddin Abdullah b. Jusuf b. Muhammed, *Tabrixh el-Ehadithi ne el-Athar el-Uakia fi Tefsiri el-Keshshaf li ez-Zemahsheri*, Dar Ibn Huzejme, I-IV, Rijad 1414 hixhri.

Shaban, Zekijjuddin, *Islam Hukuke İlminin Esaslari*, (Prkth: Prof. Dr. İbrahim Kafi Dönmez), Ankara 2000.

Zuhajli, Uehbe, *el-Fikhu el-Islami ne Edil'letuhu*, Daru'l-fikr I-VIII, Sham 1989, Botimi 3.

“Hafiz Ali Korça - Hoxha i përndjekur” (Vështrim për Abetaren e tij)

Prof. dr. Njazi KAZAZI

USH “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Gjuhësisë



Hyrje:

“Hafiz Ali Korça i përket atij brezi ideologesh e organizatorësh, që më veprimtarinë e tyre i bënë një shërbim të denjë çështjes së zgjimit dhe bashkimit kombëtar, çështjes së tërësisë dhe pavarësisë së Atdheut dhe çështjes së përparimit të kombit”.¹

“Midis hoxhallarëve të përndjekur nga pushtuesit, nga fanatikët dhe komunistët për

idetë, pikëpamjet dhe veprimtarinë e tyre është edhe Hafiz Ali Korça”, shkruan Dr. Ramiz Zeka në librin e tij: “Zhvillimi i kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”, ribotim, Tiranë, 2002, dhe vazhdon “...i rritur në një mjedis patriotik, fetar e kulturor korçar të pastër, ai u brumos me bindje dhe parime, që e ngritën lart emrin e tij”.²

Hafiz Ali Korça, duke përkthyer kryeveprat si “Gjylistani”, “Rubairat”, si dhe “Jusufi me Zelihane”, i bëri të flasin në shqip poetët e mëdhenj si Saadiun, O. Kajamin etj., siç la një kontribut të shquar me veprat origjinale në prozë e poezi fetare dhe laike në një periudhë të gjatë kohore mes viteve 1900-1942.³

Duke folur për jetën e tij, autorët thonë se Hafiz Ali Korça bashkëpunoi me një varg figurash, që luajtën rol të rëndësishëm në historinë e kohës së re të Shqipërisë, siç janë: Kristo Luarasi, Jusuf Turabi Kërçova, Pandeli Sotiri, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci, Sali Nivica etj.

Kujtojmë se më 1925 botoi në Tiranë pamfletin “Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit”, ku shprehu pikëpamjet e tij për komunistët.

1. Hafiz Ali Korça në Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Enciklopedi, 100- personalitete shqiptare të kulturës Islame, shekulli XIX-XX, Editor Genti Kruja, Andrin Rasha, Tiranë, 2012, fq. 24-27

2. Hafiz Ali Korça (1874-1957) Shih: Sadik Bega, “Hfz. Ali Korça” në rev. “Kultura Islame” 1941/ Nr. 3-4, fq. 102-107.

3. Shih më gjatë librat në fjalë.

ABETARE

PRËJ

Hafiz Ali-ut
Hatib i Korçës



KORÇË

ypur ne atypeshkronjen „Korça“ ne Korçë
1910 (1326).

Dr. Zeka duke vazhduar thotë se ai na ka lënë një numër të konsiderueshëm veprash, në mes të cilave me një rëndësi të veçantë edhe tekstet shkollore, si: “Abetare shqip” (1910), “Fe Rrëfenjësi, morali” (1914), “Gramatika, Sintaksa shqip-arabisht dhe fjalime” (1916) etj.

“Abetare shqip” (1910):

Në do të ndalemi pikërisht për këtë tekst, në një këndvështrim të ri ndryshe (nga ajo që kemi shkruar më parë).⁴

Në dhjetëvjeçarën e parë të shekullit XX, në prag të Pavarësisë, forcat intelektuale shqiptare u angazhuan me nisma konkrete për krijimin e një shtetit të pavarur shqiptar me mësonjëtores shqipe, tekste në gjuhën amtare, mësuës shqiptarë, alfabet të përbashkët.

Botimi i abetareve shqip ishte një ndër rrugët më konkrete dhe më popullore për realizimin e këtyre ideve.

Një nga autoritetet e kohës që mori pjesë aktive në këto ndërmarrje qe edhe Hafiz Ali Korça, i njohur si erudit, poliglot, mësuës i “Mësonjëtores së parë shqipe të Korçës”, (... “*bashkëpunoi ngushtë me Pandeli Sotirin, drejtorin e kësaj shkollë... Aty dha pa pagesë Edukatën*

Islame.”⁵ përfaqësues i nacionalizmit shqiptar, i dënua me vdekje për pikëpamjet e tij.

Hafiz Ali Korça siç duket i njihte dhe i kishte parasysh abetaret e deriatëhershme që nga Veqilharxhi, Mjeda, Gurakuqi, Boriçi, S. Frashëri, abetaret anonime etj., të botuara deri në atë kohë dhe ndikohet prej tyre.

Hafiz Ali Korça u radhit në radhët e ithtarëve të përdorimit të alfabetit latin. Me këtë alfabet ai botoi tekstin shkollor “Abetare”⁶.

Abetarja, botuar më 1910, është shtypur në shtypshkronjën “Korça” në Korçë, gjeti miratim të përgjithshëm në publik, sepse ishte në korrent të lëvizjes arsimore-kulturore për alfabetin shqip.

Botimi kësaj abetareje për mësimin e gjuhës shqipe me alfabetin latin nga një përfaqësues i klerokracisë myslimane ishte një sukses për çështjen kombëtare, sepse dilte në mbrojtje të alfabetit të përbashkët dhe përjashtonte përdorimin e abetareve të tjera.

Në këtë tekst autori përdori dy abetare: Alfabetin e Stambollit (variantin e vitit 1884) dhe alfabetin e Kongresit të Manastirit (1908). Kështu autori bëri i pari publikimin e këtij alfabeti në një abetare dhe është meritë e Hafiz Ali Korçës.

Po cila është përmbajtja e kësaj abetareje dhe nga ç’metodë niset ajo?


Kjo abetare nuk sjell ndonjë gjë të re. Ajo është e tipit të zakonshëm dhe i përmbahet thuasje njëlloj traditës së abetareve të mëparshme.

H. Ali Korça e ndërtoi abetaren e tij sipas metodës fonetike dhe e ndau lëndën në njësi mësimore, duke

4. Shefik Osmani, Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i MASH, Shtëpia botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, fq. 366.

5. Dr. Ramiz Zeka, “Zhvillimi i kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”, Ribotim, Tiranë, 2002, fq. 318

6. Shih frontespicin e librit në fjalë.



u mbështetur në renditjen alfabetike të shkronjave të vogla të shtypit. Në 17 njësi mësimore ajo bën objekt përvetësimin e 36 tinguj-shkronjave të gjuhës sonë. Çdo njësi mësimore është mjaft e ngarkuar, sepse numri i fonemave të përfshira në secilën është 8-9, por ato rimerren në mësimet në vazhdim, me qëllim që të përvetësohen sa më mirë.

Copat e leximit që vijnë menjëherë pas pjesës së shkronjave, janë të gjitha në prozë. Ato përshkohen nga edukimi moral dhe janë të lidhura me problemet e jetës së përditshme dhe synojnë t'i edukojnë nxënësit me vetitë e mira morale, si: dashurinë për Allahun (xh.sh.), mirësjelljen, dashurinë për prindërit dhe njëri-tjetrin etj. Fjalët e urta të nxjerra nga folklori popullor dhe që janë vendosur në fund të tekstit, ia shtojnë vlerat edukative të saj.

Përmbajtja e disa pjesëve ndonëse është e vështirë për moshat e mitura, por mendojmë se autori e ka bërë edhe

për moshat e rritura, që kishin nevojë edhe ato për një tekst të tillë dhe u ka shërbyer edhe të rriturve.

Botimi i kësaj abetareje përbën një kontribut të madh në kushtet e pushtimit, mungesës së librave në gjuhën shqipe, në prag të Pavarësisë. Teksti ka përmbajtje pa asnjë dallim fetar, gjë që përçon platformën e rilindësve në planin e edukimit atdhetar dhe arsimor.

Abetarja ka një vëllim të konsiderueshëm dhe shërbeu për disa vite me radhë për mësimin e leximshkrimit të gjuhës shqipe nga masat e popullit.

Ndryshe nga shumë abetare të tjera, mësimi i shkronjave të dorës jepet në fund të tekstit. Këtu jepet edhe një pasqyrë përmbledhëse e tyre, me shkronja të vogla e të mëdha, përkatësisht sipas dy alfabeteve të përdorura në abetare.

Përfundime:

Vlerat e kësaj abetareje janë të veçanta sepse është i pari ndër shqiptarët, autorë të Abetareve shqipe që ka botuar një tekst me Alfabetin e Kongresit të Manastirit, 1908. Hafiz Ali Korça, vazhdon punën e filluar rreth 50 vjet më parë H. Daut Boriçi, më 1861, që hyri si atdhetar, didakt, tekstolog dhe si organizator i arsimit popullor (për të cilin do të flasim në një shkrim tjetër) dhe zë vend të nderuar në rreth 220 abetaret e botuara në gjithë historinë e abetareve shqipe, brenda dhe jashtë vendit, si: në Bukuresht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Vjenë, Napoli, Selanik, Athinë, Paris, Milano, Bari, Worcester, Lajpcig, Konstancë dhe Aleksandri të Egjiptit.

“Për fe dhe atdhe”; një letërsi vizionare dhe misionare

Dok. BRIKENA SMAJLI
Tiranë

Një vështrim në krijimtarinë apo veprimtarinë shkri-more të drejtuesve fetarë, në përgjithësi dhe atyre islamë, në veçanti, gjatë periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë dhe më tej, na zbulon disa të dhëna dhe veçori, të cilat kanë të bëjnë me *shkrimin* si proces, *krijimtarinë* si koncept edhe marrëdhënien që, këto të fundit, kanë me *përkushtimin fetar, vlerën e misionit* dhe përjetimin e tyre, në cilësinë e njeriut të përkushtuar ndaj besimit, besimtarëve dhe atdheut.

Nëse Said Najdeni ose Hoxhë Voka (Vogli) thotë: “*Nuk vuaj për para e për grada, por për komb e atdhe. Unë dua të fitoj liri me i mësua këtij populli gjubën shqipe, që ta njeh veten e tij e të përpiqet për vetvete.*”¹ kjo, në njëfarë mënyre është vlera e misioni i pjesës më të madhe të prijësve fetarë, të cilët priren drejt përmbushjes së këtij qëllimi, duke e konceptuar veten pjesë e së tërës, pjesë e atdheut dhe, që e tëra të jetë, e atdheu të bëhet, lipset që secili, sidomos ata, të plotësojë më së miri pjesën që i takon, me përkushtim. Pikërisht, është kjo marrëdhënie me

përkushtimin fetar dhe vlerën e misionit, që përcakton edhe natyrën e letërsisë së shkruar në aspektin fetar, e cila, dallohet në më të mirën e saj, për cilësinë edhe vizionare.

Ndërkohë, ndërsa ndalemi tek krijimtaria e drejtuesve fetarë islamë, i rëndësishëm mbetet fakti se kjo krijimtari u zhvillua dhe u shkrua, në vetëdije dhe përkrah asaj letërsie që shkruan gjithë klerikët shqiptarë, të cilëve, pikërisht besimi fetar përkatës u prin drejt një atdhedashurie, si binom i pandashëm i besimit që kultivojnë edhe shpallin.

Nëse priremi të hedhim vështrimin më gjerë, në ngjarjen e rëndësishme të Pavarësisë së Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, edhe të formimit e vazhdimësisë së shtetit shqiptar, vërejmë, që pikërisht mendësia që kultivon thënia “*për fe e atdhe*”, “*për fe e atdhe*” sipas thënies “*pro aris et focis* (për altarët tanë e zemrat tona)” për tek “*pro patria et fede*” apo “*pro fede et patria*” apo thënia e Profetit Muhamed (s.a.s) se: «*Dasburia ndaj atdheut është prej besimit*», është një motiv i përgjithshëm i formimit dhe i ekzistencës së Shtetit Shqiptar dhe Pavarësisë, pikënisja e të cilës janë pikërisht prijësit fetarë.

1. Enciklopedi “100 personalitete shqiptare të kulturës islame”, shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012:210.

Nga vetë organizimi dhe tubimi i shoqërisë shqiptare prijësit fetarë janë të tillë, jo vetëm kundrejt besimit që përhapin e për të cilin janë prijës, por ata janë pika e qëndrueshme e referimit edhe në jetën shoqërore e politike. Prej nga, vokacioni mbi shkrimin është veçse një pjesë e një personaliteti të përkushtuar ndaj shoqërisë, por më e ngulitur, më e qëndrueshme dhe më jetëgjatë, në cilësitë që vetë letërsia a krijimtaria shkrimore kultivon.

Pikërisht në këto cilësi, kundrejt besimit dhe atdheut, letërsia që shkruhet, ka karakter shoqëror dhe fetar dhe vetë letërsia apo literariteti, nuk është cilësi e shkëputur nga të parat. Në veçoritë kryesore të saj, ajo paraprihet nga koncepti i ndryshëm i shkruarit, kundrejt *individit krijues*, si cilësim për shkrimtarin a poetin, prej këndeje edhe për një mendësi të të perceptuarit të botës dhe të vetes, e cila nuk nënkupton domosdoshmërisht poetin si krijues, formësues e të përveçuar. Kjo vjen nga fakti se në letërsinë e cila ka lidhje të ngushtë me besimin fetar, nuk ekziston një koncept i *individit krijues*, për sa kohë që prijësi fetar edhe shkruar, e koncepton edhe shkrimin poetik edhe veten pjesë të misionit dhe të përkushtimit, njëjtësisht, por jo të përveçimit. Për këtë arsye, nëse poezinë dhe poetin e kemi lidhur, sipas kuptimit origjinar të termit, me krijimin dhe formësimin dhe poetin, si krijues e formësues të diçkaje të re, madje e kemi parë edhe si një individ të ndryshëm nga të tjerët, të dallueshëm; koncepti që bart drejtuesi fetar për vetveten dhe shkrimin, që transmeton, është kryekëput i ndryshëm nga kjo veçori.

Kështu, nëse flasim për Sheh Ahmet Shkodrën dhe 22 librat e tij, apo ato

që kanë mbërritur prej tyre, krahas tematikës ngushtësisht fetare, të cilat kanë vlerë edhe sociologjike, duhet të dallojmë veprën “*Këshilli i atdheut*” e cila, shpreh vetëdijen kundrejt atdheut dhe përparimit të tij.

*Herët fort jam Atdhetar
Nuk e du kush asht tradhtar,
Unë nji here kam ba be,
Për besim e për Atdhe.*

Për çfarë vetë kjo vepër dëfton, nuk është cilësia veçanërisht letrare-artistike, por vlera e misionit kundrejt tjetrit, të tjerëve, atdheut, sidomos përjetimi i brendshëm i këtij misioni, i shprehur në vargje.

Kultura fetare dhe vlera e misionit e lidh drejtuesin fetar (jo vetëm drejtuesit myslimanë, por të gjithë drejtuesit fetarë, në përgjithësi) me konceptin *semit* të poetit dhe të poezisë, të cilit nuk i njihen cilësitë krijuese dhe e përjeton procesin e shkrimit si këngë-vaj² dhe vetë përjetimin shkrimor në vargje, si ndjenjë të vërtetë dhe që i drejtohet vetes dhe Zotit. Për këtë arsye, ndërsa vendoset në rolin e ndërmjetësit të fjalës së Zotit edhe aktin e shkrimit përjeton si pjesë e përfytyrimit hyjnor, prej nga, i frymëzuar kësioj, shkruari e ndien veten impersonal, jo individ të përveçuar. Shkrimi dhe krijimtaria, letërsia që zhvillohet është përjetim i

2. Shih Al-MAWRID, A Modern Arabic-English Dictionary, Dar El-Ilm Lilmalayin, Beyrut, 1995, f. 701, për fjalën: “*Shi’ir*” شعر dhe The Gateway to Modern Arabic Poetry, translated by Munir Mezyed (Romania) & Prof. Abdul-settar Abdul-Latif, Al-Assady (Iraq), Ed. Abdul-Settar Al-Assady, Art-GatE Association, Romania, 2007. f. 311, për interpretimin etimologjik të saj.

përkushtimit në vlerën e misionit dhe me thelbin e vet, në besimin.

Cilësia dhe veçoria e kësaj letërsie nuk qëndron në individin, por në vlerën e përjetimit të brendshëm dhe të vërtetë. Pikërisht nga kjo mendësi mbi shkrimin dhe lidhja e këtij të fundit me doemos me përkushtimin fetar, përjetohet barazueshëm kundrejt dheut, tokës, besimtarëve, atdheut. Ky vokacion e bën dashurinë dhe përkushtimin ndaj njerëzve dhe atdheut, një detyrë të qëndrueshme dhe jetëgjatë. Një cilësi të tillë kundrejt misionit merr vepra letrare e publicistike e Hafiz Ali Korçës, i cili përveçse shquhet për shërbimin e tij të paçmuar kundrejt *çështjes së zgjimit dhe bashkimit kombëtar, çështjes së tërësisë dhe pavarësisë së atdheut, çështjes së fesë e përparimit të kombit*,³ me veprën e tij publicistike dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore e politike të vendit, realizon kundrejt shoqërisë shqiptare të kohës atë që Dean Keith Simonton në përkufizimin e individualitetit krijues e quan *dobishmëri kundrejt komunitetit*,⁴

3. Enciklopedi “100 personalitete shqiptare të kulturës islame”, shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012:24.

4. *The Dictionary of the History of Ideas*, Gale Group, University of Virginia Library, 2003:493. *Dean Keith Simonton: Creativity in the Arts and Sciences: Historical Conceptions. Si koncept, krijimtaria është më fort e lidhur me qytetërimin evropian. Kjo jo sepse qytetërimi të tjera nuk shfaqin krijimtari. Përkundrazi, nuk ka dyshim që qytetërimi të tjera botërore – të tilla si kinezë, indiane dhe islame – kanë nxjerrë gjeni krijues të një shkalle të lartë. Dallimi buron kryesisht nga se si ngjizet krijimtaria në kultura të ndryshme. Thelbi i ndryshimit dubet të gjendet në përkufizimin e saktë të fenomenit. Ndonëse një ide nuk është krijuese, nëse nuk është njëherësh origjinale dhe e dobishme, përpjesëtimet e sakta të origjinalitetit dhe dobishmërisë nuk janë të prera. Në të njëjtën kohë, qytetërimet botërore ndryshojnë vërtetë shumë në rëndësinë relative që luajnë*

por i cili nuk i mohon shkruarit cilësitë krijuese, por këto i përgjigjen vlerës së misionit dhe jo të përveçimit individual.

...“*Vullneti i përbashkët i vazhdueshëm, bashkimi vëllazëror, ideali i vërtetë kombëtar, - vëren Hafiz Ali Korça, - në pakë kohë shtetin e bënë lulishte diturie e trëndafilshhtë qytetërimi*”...⁵

I dhënë gjithashtu ndaj përparimit të atdheut dhe të shoqërisë shqiptare, ai shkroi “*Shtat ëndrrat e Shqipërisë*” (1944), një vepër në vargje, ku me anë të alegorisë vë në dukje veset që mund të “shqyejnë” Shqipërinë. Shfaqja e ëndrrave dhe paraqitja vizionare e Kuçedrës, si shëmbëlltyrë e politikanit, që kërkon të kthehet në diktator e të dëgjohet veç zëri i tij, që largon, vret, mbyt njerëzit e ditur; pasohet nga Nepërka që del nga kasaforta dhe nënkupton të huajt që përpiqen të zhvatën Shqipërinë - bankat e huaja që kërkojnë të përprijnë pasurinë e shqiptarëve. Ariu i madh me gojë të stërmadhe është një sundimtar i huaj, që do t’i vijë Shqipërisë, për sa kohë që shqiptarët nuk bëjnë dot pa të huajt. Sa herë grinden, zihen e vriten, kërkojnë një të huaj që t’u vijë nga jashtë e t’i pajtojë. Krijesat e frikshme, të ëndrrës së katërt, nënkuptojnë përsëri politikanët që përpiqen si e si të pasurohen më shumë dhe në garë me njëri-tjetrin: kush e kush të vjedhë më shumë, e ndiejnë

mbi individualizimin kundrejt kolektivizimit. Prandaj, kultura më individualiste i kushtojnë më tepër rëndësi origjinalitetit, sepse ky tipar sjell një kuptim për të provuar veçanësinë personale. Në të kundërt, kultura më kolektiviste synojnë të theksojnë dobishmërinë. Me qenë “të dobishëm” në atë rast do të thotë që një ide origjinale dubet të jetë e përkueshme me vlerat sociale dhe traditat kulturore. Në të kundërt, nuk mund të vlejë si ide, aq sa të tregojnë përçarje më tepër se përkueshmëri.

5. Hafiz Ali Korça, *Shtat ëndrrat e Shqipërisë*, Shtypshkronja e shtetit, Tiranë, 1944:79.

veten të pangopur. Shfaqja, në ëndrrën e pestë e një bukurosheje, nënkupton Shqipërinë, por ajo është prapë pre e politikanëve lakmitarë. Në ëndrrën e gjashtë, nënkuptohen shqiptarët, të cilët pajtohen vetëm atëherë kur i kanë punët pisk, vetëm atëherë kur u rrezikohet jeta, kur kuptojnë se askush nuk i do, atëherë kërkojnë t'u vijë në ndihmë një udhëheqës nga jashtë e t'u rregullojë punët që kanë katranosur. Përfundimisht, ëndrra e fundit nënkupton prapë politikanët shqiptarë që gjithnjë kanë jetuar duke ngrënë kokën e njëri-tjetrit...

Alegoria e fundit godet bolshevizmin e komunizmin, që janë në prag, por e parë në syrin e këndvështrimit të sotëm, dallohet për cilësinë vizionare dhe vetëdijen, për sa kohë nxjerr në pah të këqijat e përgjithmonshme të vendit të vet e shqiptarëve, kundrejt Shqipërisë, pra, kundrejt vetes. Shkrimi i ngjan natyrës satirizuese të Konicës, i cili si Hafiz Ali Korça nuk idealizon shoqërinë shqiptare dhe të metat e saj, dhe pikërisht prej dashurisë e përkushtimit atdhetar zgjedh të vërë gishtin në plagë, duke qenë i vërtetë.

Kuptimplotë është fakti se pas shkrimit të saj autori pati pasojat e pritshme, të çdokujt që thotë të vërtetën. Megjithëse botohet më 1944, vepra u shkrua më 1924 dhe, një vit më vonë, u pasua nga pamfleti *“Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit”*. Veprat ndjekin njëra tjetrën në cilësinë e vizionit që i përbën. Çfarëdo rrethanash ta kenë detyruar të shkruajë autorin vargjet e mëposhtme:

*“Shih pra, nuk mbetën fare ndërtesa
Ndër këmbë’ u muar e shenja besa,*

*Xhami e kish s’lan’, i rrënuan
E kësi punësh djajt i shënuan,
Pristërinjt e hoxhët si kec i grinë,
Inteligjentët në dhet i shtrinë...»⁶*

vërtetësia që ato përcjellin edhe në ditët tona, që vitet e diktaturës i kemi kaluar, në mënyrë poetike e të zhdërvjellët të shprehjes, nuk mund të vlerësohet ndryshe, veç si cilësi vizionare. Ndërsa vepra e këtij prijësi fetar nuk përmbillet këtu, por vazhdon edhe me një tërësi tjetër të krijimtarisë poetike, si edhe me përkthimet e veprave nga letërsia perse: me *Rubairat* e Omar Khajamit, *Gjylistani dhe bostani* dhe *Jusufi me Zelibanë*, të Saadiut, të cilat shquhen për cilësinë e përkthimit, rezultat i njohjes, dijes së thelluar mbi gjuhët, të njohjes së kulturës, traditës filozofike e shkrimore perse dhe për më tepër; vetë akti i përkthimit priret drejt vërtetësisë dhe vlerës së misionit, më tepër se sa kundrejt një poetizimi individual.

Në një plan tjetër, megjithëse nuk mund të flitet për vlera të spikatura letrare, as për lëvrimin e një gjinie të caktuar të letërsisë, qoftë kjo edhe në natyrën e vargjeve fetare, vepra e Hafiz Ali Krajës, vlen të përmendet për mendësinë vizionare dhe të pakompromis, me thelbin e vet në të vërtetën dhe besimin, që transmeton, në shkrimin publicistik.

Ndërsa fjalimi i mbajtur mbi varrin e poetit Patër Gjergj Fishta, nënvizon cilësitë e mendësisë, që po trajtojmë: përkushtimin ndaj idealit kombëtar dhe përparimit të vendit dhe vëmendjen ndaj trashëgimisë shqiptare, për më tepër i thënë mbi varrin e *Poetit kombëtar*, një misionari dhe atdhetari si ai, një

6. “Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit”, f. 41.

prifti françeskan, në të njëjtën natyrë vijnë edhe predikimet fetare, të cilat paraqesin vizionin e qartë, të angazhuar edhe qytetar, në vlerën e misionit. Autori kishte shkruar më 1934 veprën “*A duhet feja? A e pengon ajo bashkimin kombëtar?*” duke i dhënë përgjigje një kohe jo fort të përshtatshme kundrejt besimit dhe besimeve edhe në Evropë dhe duke nënvizuar: *Ashtu siç është e pamundur të bëhet fjalë për moral dhe virtut të lartë atje ku s’ka fe, është mjaft vështirë gjithashtu, të bësh fjalë për lumturi. Sepse burimi i moralit dhe i virtutit është ndërgjegjja, ndërsa i vetmi element që e urdhëron ndërgjegjen është feja-lidhja me Zotin. Ata që s’e pranojnë fenë, me kohë nisin të sillen pa respekt edhe ndaj koncepteve të larta si nderi, kombi, atdheu...*⁷ Në shtator 1943 ai iu drejtua besimtarëve me hytben: “*Çfarë është komunizmi dhe pasojat e tij për popullin shqiptar.*” Cilësimi në veçanti i kësaj hytbeje, predikimi, e cila më fort ka vlerë të qartë sociale dhe politike, është prapë i rëndësishëm edhe kundrejt një ideje mbi shkrimin artistik dhe cilësinë bazë të një letërsie, e cila përgjithësisht kultivon dhe promovon cilësi morale e fetare dhe prej këndeje as nuk priret ta përfillë veten si më e mira dhe as më e larta, qysh se prej këtu, synon tjetër qenësi dhe bukuri. Ajo thekson cilësi të individit, i cili, nuk pushon së qeni pjesë e përgjegjshme e shoqërisë ku jeton dhe predikon, prej nga, cilësitë e tij edhe letrare, i përkthen në një qenësi të angazhuar kundrejt besimtarëve, në vlerën e misionit ndaj tjetrit dhe atdheut, që ka përqafuar, që në fillim.

Kleriku islam, dhe këtu përmendim

7. Kraja, Hafiz Ali, “A duhet Feja, a e pengon bashkimin kombëtar?”, KMSH, 2010.

Hafiz Bajram Aganin, Hafiz Halit Bushatin, Haxhi Ymer Lutfi Paçarizin, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Tarin etj... në punën e tij, si shkrues dhe hartues tekstesh, nuk i përgjigjen nocionit të poetit, si krijues, ashtu siç shpjegohet në termin grek, [poezi (poesis) - me krijue me formësue], meqenëse shkrimi është i bashkëlidhur me përkushtimin fetar, ai i përgjigjet të vërtetës, të vërtetës dhe ndjeshmërisë së vërtetë dhe të përkushtuar të besimtarit kundrejt Zotit, por jo të bukurës, të veçantës, fantastikes, të përveçarës.

Kuptohet, në konceptin estetik-filozofik, poezia fetare (qoftë edhe vetëm ajo) ka si kategori qendrore të vërtetën dhe besimin, rrjedhimisht, *moralin*, etikën. Qenësia a saj si kategori etike është edhe kategori estetike, qysh se sjellja e mirë është edhe sjellje e bukur. Pyetjes se si e realizon bukurinë artistike, arti dhe letërsia e lidhur ngushtë me besimin fetar, i përgjigjemi me një pyetje tjetër: a ka arti ndërgjegje, vetëdije, moral? A është e vërteta vetëm kategori etike? Përjetimi dhe ngazëllimi në vepra i drejtuesve fetarë islamë, shqiptarë, apo edhe më gjerë i njerëzve të besimit në Shqipëri, përfshi këtu katolikët dhe ortodoksët, a nuk është tregues i një momenti të rëndësishëm të qenësisë si komb, a duhet vlerësuar si përkushtim mirëfilli fetar, për sa kohë, që ai i kapërcen caqet e predikimit të thjeshtë në xhami apo kishë? Pohimi i Profetit Isa (a.s.), *për dashurinë edhe për tjetrin*, a nuk duhet kuptuar si vlerë e qenësishme njerëzore dhe e bukur? Nuk do mend, se në këtë drejtim teologu do të na ofronte shembuj të mjaftueshëm se besimi, madje edhe falja e besimtarit të thjeshtë,

kundrejt artit si vargëzim, në qenësinë e tij të njëmendtë është e sinqertë dhe e bukur, përderisa ajo i përgjigjet me zemër të vërtetës, duke e vërtetuar këtë qenësi në të qenët i vetëdijshëm dhe i sinqertë në besim. Atëherë, cila është vetëdija krijuese e gjenit krijues që e sheh veten të përkushtuar në punë të tilla që kanë në themel dobishmërinë ndaj komunitetit a kombit? Nëse ndjekim jetën dhe veprën e gjithsecilit nga të përmendurit më sipër si edhe e lidhim atë veprë, në thelb modeste, me dobishmërinë kundrejt komunitetit dhe kombit, do të shohim se vetë konceptit tonë mbi të shkruarit letërsi, diçka i shpëton.

Hartimi dhe përimtimi i fondit të veprave orientale, skedimi dhe certifikimi; përkthimi i parë i mevludit në shqip, apo edhe çdo poezi a shkrim (Hafiz Ali Ulqinaku) përbën në radhë të parë punën misionare dhe të përkushtuar të një individi krijues, i cili vlerën e tij e sheh në marrëdhënie tërësie dhe misioni.

Nëse në krijimin e një identiteti kombëtar, shqiptar, si edhe në platformën e Rilindësve motoja për “fe dhe atdhe” pati një trajtim po aq të veçantë sa edhe vetë kushtet specifike që formimi i shtetit shqiptar përballte, letërsia dhe kultura, cilës natyrë i përgjigjej?

Në vendet e rajonit dhe më gjerë, periudha e pavarësimit a krijimit të vetëdijes kombëtare, përkon apo bashkëshoqërohet me shkrimtarë e poetë, që bëhen zëdhënës të vetëdijes kombëtare, ashtu si edhe me vizionin e ndërtimit e një historie kombëtare, goftë kjo edhe me kërkimin e rrënjëve

mitologjike të kombit. Shekulli i XIX-të përkon jo thjesht me letërsinë, por edhe me studimin sistematik të mitologjisë, mbijetojave të trashëgimisë popullore, si edhe një rikërkim në rrënjë të religjionit. Kështu mund të përligjet për kulturën gjermane vetëdija mbi rrëfenjat popullore, si edhe rivlerësimi i religjionit a njohja e religjioneve, prej këndeje edhe vështrimi vizionar mbi kulturën e vëllezërve Grim, pikënisja që i sjell simbolizmit në letërsi Wagneri, apo fillesat e letërsisë së krahasuar të nisur nga Gëte, vështrimet dhe arritjet kulturore të këtyre ndërsa përcjellin në këndvështrimin tonë një përvojë të formimit të vetëdijes dhe traditës, na sugjerojnë vështrimin e shkrimtarisë si proces që nuk i drejtohet kryekëput përveçimit autorial, por vlerës dhe përgjigjes në rrënjë të misionit dhe përkushtimit atdhetar edhe fetar. Pa një përkushtim të tillë misionar të klerikut, Shqipëria nuk do të bëhej. Kështu vlera e misionarit, prijësit fetar, në kulturën shqiptare, përkon edhe me një veçori religjionare, e cila në zgjidhjen e këndvështrimin, në vend që të bëhej pengesë, u bë faktor kryesor bashkimi dhe njësimi për atdheun. Ashtu si pa përkushtimin fetar deri në flijim atdhedashuria nuk do të kishte jetëgjatësi dhe të ardhme, ashtu siç ajo do të ishte sporadike dhe e paqëndrueshme në vlerën e misionit.

Pikërisht vokacioni fetar i ideologëve dhe ideuesve të shtetit shqiptar është një faktor i rëndësishëm për jetëgjatësinë dhe suksesin e idesë kombëtare. Motoja e mësipërme, për “fe dhe atdhe” është e rëndësishme për të tre besimet fetare, si dhe e qenësishme në qëndrueshmëri e

klerikëve gjatë regjimit të kaluar.

Vështrimi i letërsisë (poezisë), që i shërben artit të së bukurës, shënon këtu një pikënisje, jo vetëm të letërsisë kombëtare, por edhe të formimit qenësor të vetë natyrës së poezisë-letërsisë që kjo kulturë, kultura shqiptare përmban.




Në natyrën e vështrimit të individit krijues (poetit), si edhe veprës artistike, kryesisht poezisë dallohen këto veçori:

1. Marrëdhënia e religjionit dhe e atdheut.

2. Vështrimi i poetit si misionar, kundrejt atdheut dhe kombit.

3. Cilësia vizionare e shkrimit artistik.

Pohimi i mësipërm, karakterizues i Letërsisë Shqipe, në refleksion të 100-vjetorit të themelimit të Shtetit Shqiptar, vë para pyetjen e dykrahshme: kërkimin e një letërsie-poezie që përruron rolin parësor të Krijuesit dhe individit ekzistencial në të, nga njëra anë.... dhe shpjegimin e kësaj qasjeje, drejt etnocentrizmit dhe atdheut, si vlerë e qenësishme e shkrimit letrar.



Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes kombëtare

H. Vehbi Dibra njëri nga shembujt konkretë

Dok. Genti Kruja

Abstrakt

Shqipëria dhe të gjithë shqiptarët në trojet e veta kanë hyrë në vitin jubilar të 100 vjetorit të ngritjes së flamurit, shpalljes së pavarësisë dhe themelimit të shtetit shqiptar. Kështu është një fat që bashkësitë islame shqiptare ndërmorën nismën e organizimit të kësaj konference shkencore, për të ndriçuar jo pak historinë e lëvizjeve të mëdha kombëtare për liri e pavarësi, për arsimim dhe aspirata në ndërtimin e identitetit kombëtar, ruajtjes së vlerave universale islame dhe trashëgimisë së madhe kulturore të shqiptarët, nëpërmjet figurave të ndritura të prijësve myslimanë shqiptarë.

Kur hulumtojmë mbi librat e historisë shqiptare, por fatkeqësisht jo shumë asaj të botuar dhe zyrtare, por asaj arkivore dhe që akoma nuk njihet shumë, e flet për këto lëvizje dhe përpjekje mbarëkombëtare, kupton se një rol të jashtëzakonshëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë, të cilët në shumë raste ishin prijës myslimanë me detyra të larta fetare, ku në kushtet dhe rrethana të ndryshme dhe shpesh herë mjaft të vështira, punuan për krijimin dhe ngritjen e shtetit shqiptar, si dhe kontribuuan në formësimin e vetëdijes kombëtare dhe fetare të popullit tonë.

Periodha e Rilindjes, Lidhja e Prizrenit, Kongresi i Dibrës, i Manastirit, Shpallja e Pavarësisë, e në vazhdimësi përbëjnë kauzën shekullore shqiptare në mbrojtje të vlerave kombëtare. Dhe padyshim se kësaj epoke të vështirë iu bashkëngjitën edhe djedarët myslimanë shqiptarë, madje në shumë raste roli i tyre ishte vendimtar.

1.1.

Me shpalljen e pavarësisë dhe ngritjen e flamurit më 28 nëntor 1912, krahas figurave patriotike të të gjitha besimeve në vendin tonë, do të ishin pikërisht prijësit myslimanë, hoxhallarë, myderrizë, imamë, pedagogë e studiues, të cilët të brumosur me kulturën e lartë islame dhe atdhedashurinë ndaj vendit të tyre, shkruan me jetën dhe veprat e tyre historinë e lavdishme të vendit tonë.

Në fakt, liria e fesë është më e vjetra ndër të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe çdo ditë e më shumë vërtetohet fakti se, jeta fetare nuk venitet. Argumenti më i fuqishëm për ta mbrojtur atë është se liria e ndërgjegjes, feja dhe besimi mbështeten në thelbin e dinjitetit njerëzor. Periodha e Rilindjes Kombëtare, ajo e pavarësisë dhe e luftërave të ndryshme në mbrojtje të trojeve shqiptare, dëshmuar se ekzis-

tenca e besimit fetar, jo vetëm që nuk u bë pengesë për përballimin e situatave të vështira të atyre kohërave, por u bë faktor i domosdoshëm për ruajtjen e pavarësisë dhe forcimin e shtetit, duke u vlerësuar se diversiteti fetar ka qenë dhe është një pasuri kombëtare, falë kjo prijesve të shquar fetarë. Një realitet ky i cili herë pas here vlerësohet edhe nga opinioni ndërkombëtar. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, klerikët myslimanë, së bashku me ata të besimeve të tjera, radhiteshin mes personaliteteve politike e shoqërore dhe krahe përpyekjeve të lëvizjes kombëtare.

Shqipëria përgjatë historisë së saj ka qenë një shembull se si njerëzit e fesë kanë ditur të zgjidhin saktë marrëdhëniet e besimit me kombin.

Periodha e Rilindjes, Lidhja e Prizrenit, Kongresi i Dibrës, i Manastirit, Shpallja e Pavarësisë, përbëjnë kauzën shekullore shqiptare në mbrojtje të vlerave kombëtare. Padyshim se kësaj epoqe të vështirë iu bashkëngjit dhe kleri mysliman shqiptar, madje në shumë raste ai ishte vendimtar.

I zgjedhur në krye të Pleqësisë më 1912 me propozim të Luigj Gurakuqit, H. Vehbi Dibra u ngarkua nga kuvendi me detyrën e Kryemyftiut të Shqipërisë për organizimin e Komunitetit Mysliman në maj 1913 dhe më 24 shkurt 1923 në Kongresin e Parë Mysliman, mbajtur në Tiranë, ku kishte një përfaqësi mbarëkombëtare, Kryemyftiu i Shqipërisë i emëruar nga qeveria e Vlorës, do të zgjidhej si kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Në muajin mars të vitit 1924, me vendim të Kongresit të Parë Mysliman, u hap Medreseja e Naltë, e më vonë u

quajt Medreseja e Përgjithshme e Tiranës. Këtë shkollë, e cila shumë shpejt u bë djepi i dijes dhe kulturës kombëtare, e kanë drejtuar personalitete të shquara si: Qamil Bala, Hafiz Ismet Dibra, Jonuz Buliqi, Haki Sharofi, Esat Myftia, Sherif Putra etj.

Më pas shkrimet kundër ideve komuniste vijnë te revista “Zani i Naltë” që në numrat e parë të botimit të saj më 1923. Kurse gjatë kohës së komunizmit, të gjithë ata hoxhallarë dhe atdhetarë, që kundërshtuan idetë shkatërrimtare të këtij regjimi, u përdoqën, u burgosën, u internuan dhe u vranë, por as kjo nuk mundi të shkulë rrënjët e besimit në vendin tonë.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, për herë të parë në këtë lloj, me rastin edhe të 100 vjetorit të pavarësisë ka hartuar një enciklopedi të përbërë prej 100 personaliteteve të shquara shqiptare të kulturës islame, të cilët kryesisht janë dijetarë dhe prijes fetarë, por nuk mungojnë edhe myderrizë, profesorë katedrash universitare, udhëheqës politikë, deputetë, senatorë, ministra, mjekë, kryetarë parlamenti, kryetarë bashkish, liderë dhe udhëheqës të lartë të Komunitetit Mysliman në Shqipëri, në trojet tona dhe diasporë. E përbashkëta e këtyre është se ishin të brumosur me besimin e lartë islam dhe me dashurinë për atdheun dhe shërbimin ndaj vendit dhe popullit shqiptar, por jo vetëm.

Shumica e këtyre figurave të ndritura janë shkolluar dhe diplomuar në universitetet e shquara të botës islame të asaj kohe, si në Stamboll, Kajro, e vende të tjera dhe në mjaft raste, disa prej tyre për shumë kohë kanë qenë pjesë e stafit akademik të atyre katedrave, që dikur

kishin qenë vetë studentë. Një prej figurave më të shquara mund të përmendet edhe Hoxha Hasan Tahsini, rektori i parë i Universitetit të Stambollit, si dhe shumë të tjerë, të cilët shërbyen si pedagogë në universitetet dhe medresetë e Stambollit, Edirnesë, Kajros, etj.

Në këtë enciklopedi, këto figura historike shtrihen nga mesi i shekullit të XIX deri në fund të shekullit XX, por kryesisht i përkasin plejadës së rilindësve dhe dijetarëve të një fillimshkulli, si ai XX, plot dallgë historie dhe ngjarjesh të shumta në përpjekje për krijimin e shtetit shqiptar dhe institucioneve zyrtare, qofshin ato shtetërore, apo fetare.

Disa prej figurave më të shquara shqiptare të kulturës islame:

1.2. H. Vehbi Dibra

Me shpalljen e pavarësisë dhe ngritjen e flamurit më 28 nëntor 1912, krahas figurave patriotike të të gjitha besimeve në vendin tonë, do të ishin pikërisht prijësit myslimanë, hoxhallarë, myderrizë, imamë, pedagogë e studiues, të cilët të brumosur me kulturën e lartë islame dhe atdhedashurinë ndaj vendit të tyre, shkruan me jetën dhe veprat e tyre historinë e lavdishme të vendit tonë. Në krye të tyre vjen Haxhi Vehbi Dibra, i cili do të firmoste aktin e pavarësisë, duke i dhënë një shtysë të fortë themelimit të shtetit shqiptar. Ai ishte gjithashtu kryetari i parë i Pleqësisë (Kuvendit, apo Senatit) Shqiptar.

H. Vehbi Dibra njihet edhe si komentuesi më i mirë i Kur'anit në gjuhën shqipe.

Në vitin 1908, mori pjesë në Kongresin e Manastirit.

Në vitin 1909, mori pjesë në Kon-



gresin e Dibrës, ku u zgjodh kryetar i Kongresit.

Në Qeverinë e Parë të Shqipërisë, zgjidhet edhe nënkryetar i Qeverisë.

Kur Ismail Qemali për ndonjë arsye, mungonte, ishte Haxhi Vehbi Dibra që e zëvendësonte.

Në vitin 1913, Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë e ngarkon Haxhi Vehbi Dibrën me detyrën e Myftiut të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Në vitin 1916, nuk që e rastit kur ngarkohet me detyrën e Kryetarit të Gjyqit të Naltë të Sheriatit.

Në vitin 1923, Haxhi Vehbi Dibra u zgjodh Kryetar i Kongresit të Parë të Myslimanëve Shqiptarë, detyrë të cilën e vazhdoi deri në vitin 1929.

Komuniteti që fitoi njohjen juridike, filloi të botojë revistën e përmuajshme "Zani i Naltë". Ai ndikoi në hapjen e "Medresesë së Naltë" në Tiranë. Më 1935 H. Vehbi Dibra shkon për herë të dytë në Haxh.

Në vitin 1924, ishte Haxhi Vehbi, ai që e përruroi Medresenë e Naltë në Tiranë.

Përveç këtyre detyrave me shumë rëndësi, me shumë përgjegjësi, Haxhi Vehbi Dibra është marrë edhe me krijimtari.

Ka shkruar, ka botuar shumë punime, studime, krijime e përkthime, që janë botuar në shtypin e kohës, kryesisht në revistën “Zani i Naltë”, që botohej në Tiranë prej muajit tetor 1923 deri në prill 1939.

H. Dibra ishte një nga komentuesit më të shkëlqyer të Kur’anit në gjuhën shqipe. Këto ligjërata të mbajtura në xhami janë botuar në revistën “Zani i Naltë”. Ndërsa në vitin 1993 botohen të plota në Detroitit, SHBA nga Imam Vehbi Ismaili, nën titullin “Ç’urdhëron Kur’anit?”

Të gjitha cilësitë e teologut mysliman personifikoheshin te Vehbi Dibra, imam dhe haxhi, kryemyfti dhe kryetar senati, vaiz dhe komentator i Kur’anit. Kryesoi dhe drejtoi për vite me radhë teologët më të shquar shqiptarë.

Në komentin që i bënte Haxhi Vehbiu disa citateve Kur’anore thoshte:

“Me zgjedhë të aftin e të meritueshmin dhe me e vu në krye të detyrës, e pastaj ky me veprue e me gjykue me arsye, me drejtësi...”

Në planin politik te Haxhi Vehbiu gjejmë një propagandist të shkëlqyer, që punonte gjithmonë për mbarëvajtjen e kombit e të atdheut. Në unitetin dhe bashkimin e gjithë shqiptarëve shihet të vetmen rrugë për të siguruar të ardhmen tonë. Ai do të thoshte në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 se “Kristiani e myslimani janë vëllezër shqiptarë të pandarë”. “Armikut të atdheut i pritët hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një

qëllim të naltë”; “Naltësimi e përparimi i një vendi varet në sigurimin e qetësisë së brendshme. Atje ku mungon qetësia, nuk mund të përparojë industria, tregtia e burimet e tjera ekonomike që e lumturojnë një popull”.

Vehbi Dibra për çdo veprim mbështeti Ismail Qemalin. Kur u nis në krye të delegacionit, Ismail Qemali, la në krye të Qeverisë së Përkohshme Vehbi Agollin (Dibrën), i cili nga data 30 mars 1913, për dy muaj rresht kryesoi qeverinë në mbledhjet e saj, madje përballoi lakmitë serbe e malazeze dhe organizoi kryengritje shqiptare në mbrojtje të trojeve, që udhëhiqeshin nga Bajram Curri, Elez Isufi, Hasan Prishtina etj. dhe se mbajtja e tërësisë tokësore mund të bëhet vetëm me armë dhe se kryengritësit patën mbështetjen e qeverisë së përkohshme dhe veçanërisht të Vehbi Dibrës.

Vlen të theksohet se pas vitit 1925, Vehbi Dibra i përkushtohet tërësisht punëve të Komunitetit Mysliman dhe u shkëput nga veprimtaria e drejtpërdrejtë politike, sido që deri në frymën e fundit ai pati për moto Fe – Atdhe, këtë binom.

Haxhi Vehbi Dibra u nda nga kjo jetë, kaloi në jetën e vërtetë, më 24 mars 1937, në moshën 70 vjeçare, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë shqiptare...

Në fjalën e Imzot Vissarionit, kryetar i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, mbajtur me rastin e ceremonisë mortore të Haxhi Vehbi Dibrës, shihet vlerësimi maksimal që i bën lideri ortodoks një lideri mysliman, duke e thënë edhe vetë, se mund të jetë ndoshta rasti i vetëm dhe unikal në botë, sidomos për atë kohë, kur një kryepriift mban një

ligjëratë në varrimin e një kryehoxhe.

Ndër figurat të tjera më të spikatura mund të përmendim shkurtimisht disa prej tyre:

Hafiz Ali Korça (1873-1957)

Publicist dhe shkrimtar, atdhetar i shquar.

Hasan Tahsini (1811-1881)

Rektor i parë i universitetit të Stambollit. I dekoruar me titujt:

“Mësues i Popullit” (1961), Urdhërat “Për veprimtari patriotike” të kl. II-të (1962), dhe “Naim Frashëri”, kl. I-rë (1995)

Sheh Ibrahim Karbunara (1879-1947)

Klerik, patriot e politikan i pushkatuar nga komunizmi.

Hafiz Ibrahim Repishti (1882-1943)

Deputet, klerik, politikan

Personalitet i shquar i jetës qytetare, politike, shoqërore e fetare, luftëtar në mbrojtje të trojeve tona dhe kontribuues në arsim, si kryetar i Këshillit Arsimor të Bashkisë Shkodër (1919), anëtar i Asamblesë Kombëtare e deputet, klerik i përkushtuar për Fe e Atdhe.

Hoxha Kadri Prishtina (1878-1925)

Avokat, Deputet, Ministër i Drejtësisë në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës.

Mahmud Hastopalli

Myderriz, Atdhetar i Rilindjes Kombëtare, i dekoruar me medaljen “Për kontributin patriotik që ka dhënë, për propagandimin e tij aktiv në klubet patriotike që punonin për çlirimin e Shqipërisë”.

Vildan Faik Dibra (?-1925)

Mbrojtësi i Alfabetit Shqip.

Hafiz Xhemal Mullaj (1881-1959)

Kryetar i Shoqërisë “Bashkimi”, Stamboll, Deputet, Nënkryetar i Asamblesë.

Xhemal Naipi (1887-1955)

Kadi, kryetar komisioni i arsimit, myfti, drejtor i përgjithshëm i Vakfeve, senator, deputet, kryetari i parë i parlamentit pluralist, intelektual i shquar fetar e atdhetar. I dekoruar me Urdhërin “Për veprimtari patriotike të Klasit I” dhe me medaljen “Pishtar i demokracisë”.

Ymer Haxhi Prizreni (1826-1886)

Myderriz, Myfti, Udhëheqës i qeverisë së Lidhjes së Prizrenit.

H. Hafiz Abaz Golemi (1870-1925)

Drejtor i parë i shkollës shtetërore të Parrucës (1913-1925)

“Mësues i Popullit” (1993), me këtë motivacion:

Mësues dhe drejtor i shquar që punoi me pasion tërë jetën për edukimin dhe formimin moral e qytetar të nxënësve, për ngritjen e përparimin shoqëror, shembull devotshmërie e përkushtimi ndaj idealeve njerëzore për mirëkuptim, bashkëpunim e drejtësi shoqërore, që themeloi e drejtoi plot autoritet shkollën e Parrucës në agimet e arsimit tonë shtetëror.

Haxhi Ali Derhemi (1850-1938)

Kryetar i Bashkisë së Tiranës (1923-1924). I dekoruar me urdhërin “Skënderbeu”, Klasi I”, 1937.

Haxhi Ali Elbasani (1835-1928)

Patriot dhe predikues, Kryetar i Klubit “Bashkimi” dhe “Komiteti i zgjimit dhe i besës shqiptare”.

Hafiz Ali Podgorica (1855-1929)

Kryetar i parë i Bashkisë Durrës (1909-1912), Kadi e Myfti i

Durrësit, Ngritës i Flamurit në Durrës. I dekoruar me urdhërin e Klasit I në vitin 1992, “Qytetar nderi i Durrësit” 1996, “Mirënjohje e qytetit të Durrësit” 2005.

Daut efendi Boriçi (1825-1896)

Drejtor Arsimi, Kryetar i Lidhjes së Prizrenit - Dega Shkodër, Gjuhëtar, Autor Abetaresh dhe Fjalorësh.

Ferit Vokopola (1887-1967)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, Deputet në Vlorë e Berat, Ministër i Bujqësisë (1927-1928), Teolog, Ekonomist, Poet, Publicist, Themelues i Organizatës “Drita Hyjnore”, Drejtor i Revistës “Njeriu”.

Hoxhë Hasan Moglica (1852-1915)

Atdhetar me përmasa mbarëkombëtare, klerik, luftëtar dhe dijetar i shquar.

Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952)

Dijetar dhe publicist, iniciues në hapjen e shkollave të vajzave në Tiranë.

Haxhi Ibrahim Kaduku (1869-1949)

Myfti, pedagog universiteti në Stamboll dhe Kajro, drejtor i parë i medresesë Shkodër. I dekoruar me urdhrin “Naim Frashëri të Klasit I” me këtë motivacion: *“Klerik që iu kushtua tërë jetën çështjes së lartë të edukimit fetar dhe atdhetar të popullit, i devotshmërisë së lartë, i formimit intelektual, mësues dhe edukator i nderuar”*, si dhe “Qytetar Nderi” i Shkodrës, më 2012.

Ismail efendi Ndroqi (1876-1944)

Myderriz, hoxhë, pedagog, kadi, myfti, gjuhëtar, atdhetar, Kryetari i parë i Bashkisë Tiranë, si kryeqytet.

Mytesim Këlliçi (1866-1924)

Myfti, Kadi në Kavajë, Durrës e Tiranë.

Qamil Bala (1878-1933)

Drejtor i Arsimit në Bagdat, Inspektor i Përgjithshëm i Arsimit në Siri, Drejtor i Gjimnazit në Jeruzalem, mësues në Manastir e Selanik, Drejtor i parë i Medresesë së Tiranës, Deputet 1924.

Rexhep Voka (1847-1917)

Myfti i Vilajetit të Manastirit

I dekoruar me Urdhrin për Vepërimtari Patriotike të Klasit të Parë, me motivacion:

“Udhëheqës, propagandues e luftëtar për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit e ripushtuesit, duke qenë shembull për pasuesit në luftën për pavarësi e çlirim”, Tiranë, 1993.

Said Najdeni “Hoxhë Voka (Vogli)” (1864-1903)

“Nuk vuaj për para e për grada por për komb e atdhe”.

Hafiz Sherif Langu (1877-1956)

Patriot i shquar, aktivist në çështjet kombëtare, kryetar i Komunitetit Mysliman në vitet 1942-1945.

Zyber Hallulli (1842-1927)

Atdhetar i shquar, kryetar bashkie i Tiranës, hapës i shkollave shqipe dhe i jetimores së parë në Shqipëri, që edhe sot Shtëpia e Fëmijës e Tiranës mban emrin e tij.

Hafiz Adem Kazazi (1880-1944)

“Klerik i përkushtuar në shërbim të njerëzve, atdhedashës, humanitar dhe promotor i përdorimit të gjuhës shqipe në ligjëratat dhe tubime qytetare.”

Jusuf efendi Tabaku (1797-1904)

Myfti që hapi dinastinë e myftive në Shkodër, drejtues i Komisionit të Ndihmave për ulqinakët e ardhur gjatë luftës, personalitet i shquar me një kontribut të veçantë në jetën kulturore,

arsimore, shkencore e fetare të vendit.

Haxhi Muhamed Shaban Efendi Domnori (1868 -1934)

Shembull i ndritur për të gjithë besimtarët, prijës islam i Tarikatit Tixhani, përhapës i kulturës, qytetarisë dhe virtyteve më të larta në Shkodër dhe mbarë trojet shqiptare.

Hafiz Musa Dërguti (1888-1961)

Pishtar i Demokracisë, hoxhë i nderuar, i shquar për devotshmërinë e tij të thellë, në ndihmë të nevojtarit, atdhetar e antikomunist, promovues i tolerancës dhe bashkëjetesës.

Sheh Qazim Hoxha (1893-1959)

Klerik i përkushtuar në edukimin e brezave me moralin e lartë shpirtëror, interpretues i Kur'anit Famëlartë, kontribuues i shquar në ngritjen e institucionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Haxhi Hasan Alia (Sheh Shamia)

(1814 -1891)

Reformator i gjendjes social-kulturore dhe administrativo-politike të qytetit të Shkodrës, aktiv i çështjes kombëtare, prijës i shquar islam.

Vehbi Ismaili (1919-2008)

Themelues i Qendrës së parë Islame Shqiptare në Amerikë, patriot i shquar dhe prijës i lartë islam, edukues me moral islam dhe atdhetar i mijëra emigrantëve shqiptarë në SHBA dhe më gjerë.

Xhemal Naipi (1887-1955)

Kadi, kryetar komisioni i arsimit, myfti, drejtor i përgjithshëm i Vakfeve, senator, deputet, kryetari i parë i parlamentit pluralist, intelektual i shquar islam.

Dhe qindra e qindra të tjerë..



KONTRIBUTI I ULEMAVE DIBRANË PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE

Mr. Ruzhdi Lata-Dibër e Madhe, Maqedoni

Në kuadër të të gjithë patriotëve shqiptarë bën pjesë edhe një plejadë e konsiderueshme e ulemave të Dibrës, të cilët përveç njohurive profesionale fetare që kishin arritur gjatë shkollimit në qendrën e Perandorisë Osmane, Stamboll, kishin kultivuar edhe atdhedashurinë. Për këtë, atyre u mundësonte edukimi dhe shkollimi islam i mirëfilltë, i cili në parimet kryesore ka edhe atdhedashurinë, ngase askush nuk mund të jetë besimtar i mirë nëse nuk ka dashuri maksimale ndaj atdheut të vet. Po ashtu, ulematë dibranë kishin edhe një inspirim vendor të Dibrës ku gjithmonë respekti, dashuria, përkushtimi dhe angazhimi për çështjen kombëtare ishte parim i domosdoshëm për çdo njeri. Ulematë dibranë njihnin mirë historinë dhe traditën e Dibrës, kanunin dhe raportet shoqërore, familjet patriotike etj., kështu që ishin të brumosur me idenë maksimale të përkushtimit për çështjen shqiptare, për tokat shqiptare dhe për ardhmërinë e shqiptarëve.

Ulematë dibranë kishin edhe një përparësi shumë të madhe, ngase në detaje e njihnin historinë, fenë dhe

egërsinë e sllavëve që i rrethonin trojet shqiptare. Ata denjësisht i mbetën besnikë gjuhës shqipe, ruajtjes së traditës shqiptare në rrethin e Dibrës dhe lidhshmërisë së Dibrës me qytetet dhe trojet tjera shqiptare, si me Kosovën, Shkodrën, Elbasanin, Vlorën etj.

Ata ulema që u shkolluan në Stamboll, disa prej tyre, kishin fatin që drejtpërdrejt të njihen me vëllezërit Frashëri dhe me të gjithë patriotët shqiptarë, që vepronin dhe punonin në Stamboll. Kështu që, kuadri fetar islam i rrethit të Dibrës, denjësisht, sa ishte i pajisur me mësimet islame, aq ishte i pajisur edhe me idetë për çështjet kombëtare shqiptare.

Dibra, si regjion dhe territor, kishte specifikat e veta për kultivimin e islamit dhe të patriotizmit. Dibranët, që në periudhën e Osmanlinjve, dinin të dallonin përkatësinë fetare me sistemin politik të kohës. P.sh. Dibra është e njohur me nëntë malet, të cilat nuk e njihnin sistemin politik, nuk jepnin ushtarë, nuk paguanin taksa, por Islamit e kishin pranuar për fe. Në këtë ambient, duhej të punojë dhe të kontribuojë edhe predikuesi fetar. Që predikuesi fetar ka ditur të jetë efektiv në këtë ambient dhe

i dobishëm, vërtetojnë shumë të dhëna. Njëra prej tyre është se, përderisa shumë individë shpërbleheshin me lira floriri, apo me dhuratë të ndonjë çifligu nga osmanlinjtë, në anën tjetër asnjë predikues fetar, asnjë hoxhë nuk kishte pranuar ndonjë çiflig, pronë apo diçka tjetër nga osmanlinjtë.

Predikuesit fetarë në Dibër, historikisht kishin unin dhe egon islame dhe kombëtare. Këta predikues, sa ndjenin obligime dhe detyrime ndaj Perëndisë, aq ndjenin obligime dhe detyrime ndaj popullatës-shqiptarëve. Jo rastësisht, Said Najdeni, në veprën “Ferrëfenjësja e myslimanëve” botohet në Sofja në vitin 1900, kur ende nuk ishte formuar alfabeti i gjuhës shqipe, thotë: “Para Zotit dhe popullit do të jenë përgjegjës të gjithë ulematë-hoxhallarët dhe intelektualët e kohës, pse në kohën e tyre ndër shqiptarët ka pasur ndarje dhe përçarje, vrasje dhe armiqësi.” Po ashtu, Said Najdeni i shtyrë nga ndjenja për ardhmërinë shqiptare, në vitin 1988, në kushte jashtëzakonisht të vështira, hapi shkollën shqipe në Dibër të Madhe.

Në frymën e interesit kombëtar kanë punuar të gjithë ulematë e Dibrës, por në kuadër të kësaj mund të veçojmë aktivitetin e disave prej tyre, si p.sh. Haxhi Vildanin nga Reka e Dibrës, i cili në Stamboll merrej me çështje teologjike dhe filozofike. Ka të shkruara disa vepra në gjuhën perse dhe njëkohësisht ishte shok dhe bashkëpunëtor i vëllezërve Frashëri. Për karakterin islam dhe patriotik që kishte, jo rastësisht, u zgjodh delegat në Kongresin e Manastirit, ku me një nivel të lartë fetar, arsimor dhe patriotik, argumentoi se asgjë të keqe nuk ka nëse gjuha shqipe shkruhet me

alfabet latin. Ky ishte një inspirim i Haxhi Vildanit nga Naim Frashëri, që edhe gjuha shqipe është gjuhë Perëndie. Të njëjtit person, vëllezërit Frashëri ia besuan misionin më të rëndësishëm arsimor për trojet shqiptare dhe e emëruan kryesues të këshillit për hapjen e shkollave shqipe gjithkund ku banojnë dhe jetojnë shqiptarë.

Është obligim moral dhe fetar, që kur t’i kujtojmë vëllezërit Frashëri dhe Haxhi Vildanin, të mos e harrojmë hoxhë Maliq Tanushën, i cili jetonte në Stamboll, por kishte një pasuri të konsiderueshme, të cilën e vendosi në dispozicion për shpenzimet e aktiviteteve patriotike, arsimore dhe atdhetare të shoqërisë shqiptare të Stambollit dhe e harxhoi të tërën për interesin e atdheut.

Përderisa, Haxhi Vildani dhe Hoxhë Maliq Tanusha, vepronin dhe punonin në Stamboll, në territorin e Dibrës kishim edhe disa ulema, të cilët pas besimit në Perëndinë, në profetin Muhamed (a.s.), i besonin zgjidhjes së çështjes shqiptare përmes arsimimit. Hoxhë Muglica dhe Kurt Balla, në malësinë e Dibrës, arritën të themelojnë një bibliotekë të pasur dhe e pranuan për mision propagandën për afirmimin dhe nevojën e hapjes së normales në Elbasan.

Besojmë se nuk ka shembull më të mirë për atdhedashurinë, për mësimin e gjuhës shqipe dhe për qenien shqiptare, sesa shembulli i një hoxhe, i cili në gjeneratën e parë të Normales së Elbasanit, ku prej njëzet e nëntë nxënësve, shtatë ishin të familjes së Hoxhë Muglicës.

Peshën e punës së këtyre hoxhallarëve më së miri mund ta

kuptojmë prej maltretimeve, që u bënë serbët kur i arrestuan dhe u vendosën samarë në shpinë duke u thënë, se ne kështu do t'i shpërblejmë patriotët, por ata nuk u zmbarsën, mbetën në historinë e ndritur të popullit shqiptar dhe Normalja e Elbasanit vazhdoi punën, kurse, fatkeqësisht, bibliotekën e hoxhës e dogjën.

Politika sllave antishqiptare serbe, zgjodhi për myfti të Ohrit, Aziz Lilën nga Klenja e Dibrës, duke shpresuar se do t'u shërbejë interesave serbe në Ohër, mirëpo Azizi ishte hoxhë, ishte shqiptar dhe nuk mund ta tradhtonte shpirtin e vet. Kështu që serbët, në mënyrë zyrtare, e përcollën deri në kufirin shqiptar dhe me të shkelur në tokën shqiptare, pasoi pushkatimi. Vdiq i përzënë nga serbët, por i nderuar për virtytet e larta patriotike dhe islame.

Sot, ne dibranët dhe të gjithë shqiptarët jemi të nderuar me këto personalitete dhe shembulli i tyre duhet të na shërbejë për aktivitetin, qëndrimin, sjelljen, angazhimin dhe përkushtimin tonë.

Aktiviteti i ulemave dibranë për çështjen shqiptare, kulmon me paraqitjen e Haxhi Vehbi Dibrës për nevojat e popullit të vet. Një personalitet me plot virtyte të larta islame, i edukuar nga Kur'ani, i cili shembull e kishte profetin Muhamed (a.s.), me vlera të jashtëzakonshme fetare, me fisnikëri dhe zgjuarsi të pakrahasueshme njerëzore, me gatishmëri për sakrificë, me fjalor bindës, të arsyeshëm dhe plotë dituri, që më shumë i përngjante një engjëlli, sesa një njeriu, i dha për detyrë vetes që t'i shërbejë atdheut në çdo moment dhe situatë. Kështu që, kur turqit përgatitnin Kongresin

e Dibrës (1909) për ta devaluuar atë të Manastirit, Haxhi Vehbiu u zgjodh kryetar i kongresit dhe me zgjuarsinë dhe fleksibilitetin e tij politik, mundësoi që, kongresi të përfundojë në interes të shqiptarëve. Ai ishte myfti i Dibrës së Madhe, por ishte edhe anëtar i klubit patriotik "Bashkimi", të cilin e themeloi Hafiz Sherif Langu.

Situatat politike në Dibër dhe rrethinë për çdo vit vështirësosheshin. Ishte fundi i Perandorisë Osmane, ku ambiciet serbe, bullgare, malazeze, greke dhe italiane, për të grabitur tokat shqiptare, dukeshin haptazi. Këtë më mirë se çdo kush e kuptuan Haxhi Vehbi Agolli dhe Sherif Langu. Kur paria e vendit priste se kush do të vijë nga Mavrova, serbët apo bullgarët, këta dy (Haxhi Vehbiu dhe Sherif Langu), në petkun e hoxhës, morën rrugën për Vlorë që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912. Në këtë ngjarje të madhe të shqiptarëve, myftiu i Dibrës u zgjodh kryetari i Senatit të parë Shqiptar.

Në këtë njëqind vjetor, ne dibranët e ndjejmë për obligim ta nderojmë me të gjitha ndjenjat shpirtërore, madhërinë e plakut të Vlorës, Ismail Qemalin, për dy arsye: e para: kur Sait Najdeni kishte marrë rrugën për Tripoli, pushoi në Romë, ku gjendej edhe plaku i Vlorës të cilin e njihje që në Stamboll. Ai (Ismail Qemali) gjeti mjekët më të mirë të Romës për ta shëruar Sait Najdenin. Dhe e dyta: nuk ka nder më të madh se atë që na bëri Ismail Qemali, i cili kur udhëtonte jashtë shtetit, punët shtetërore ia besonte Haxhi Vehbiut, kurse nënkryetar e kishte Don Nikoll Kaçorin nga Lura e Dibrës.

Haxhi Vehbiu pas themelimit të shtetit shqiptar merr pjesë edhe në një aktivitet tjetër patriotik, ndihmon dhe furnizon me ide dhe armë kryengritjen shqiptare kundër serbëve në vitin 1913. Haxhi Vehbiu, pas këtij përkushtimi patriotik, përsëri i kthehet shërbimit fetar, duke e gërshtuar me atë kombëtar dhe themelon Komunitetin Mysliman Shqiptar.

Në themelimit e Komunitetit Mysliman Shqiptar, kontributi i Haxhi Vehbiut është i jashtëzakonshëm, sepse në mënyrë shumë të kulluar diti të gërshetojë interesat fetarë me ata kombëtarë. Kështu që, rreth vetes tuboi hoxhallarët më të ditur dhe më patriot të kohës, si Hafiz Ali Korçën, Ibrahim Dalliu, Hafiz Ismet Dibrën, Hafiz Xhelalin nga Dibra, Haki Sharofin etj., për të ngritur dhe themeluar medresenë e Tiranës. Ai nga Stambolli solli Hafiz Ismet Dibrën, një ulema, një pedagog, një filozof, për të përgatitur plan-programet mësimore për fillimin e punës në Medrese.

Ulematë dibranë pas vitit 1912, deri në fillimin e Luftës së Dytë botërore ishin shëmbëlltjërë të atdheut dhe të Islamit. Vazhduan rrugën e Haxhi Vildanit, të Hoxhë Muglicës, të Kurt Ballës, Azis Lilës, të Saït Najdenit etj. Kështu që, në këtë periudhë na paraqitet, me plot dinjitet dhe prezantim të shkëlqyeshëm atdhetar dhe kombëtar, Hafiz Ismet Dibra, drejtor i Medresesë së Tiranës; Muharem Mullai, vaizi kryesor i Tiranës; Haki Sharofi, mësues i gjuhës shqipe dhe edukatës fetare; Hafiz Xhelali; Sherif Langu, kryetari i ulemave të Shqipërisë etj.

Kontributi i këtyre ulemave dibranë u vlerësua nga të gjithë shqiptarët dhe jo rastësisht, me rastin e njëzet e pesë vjetorit të pavarësisë, mbreti i parë i shqiptarëve, Ahmet Zogu, dekoron tetë hoxhallarë nga Dibra për veprimtari patriotike dhe fetare. Fatkeqësisht, sistemi monist, diktatorial i Enver Hoxhës, këta njerëz të nderuar i dënon me burg: Hafiz Sherif Langu, pjesëmarrës në shpalljen e pavarësisë, themeluesin e klubit patriotik “Bashkimi”, e dënoi me shtatë vjet burg; Haki Sharofin e izoloi në aktivitet, edhe pse aftësitë e tij maksimalisht i shfrytëzoi në kompletimin e dokumentacionit të arkivit shtetëror. I mundoi të gjithë ulematë për të çrrënjësuar bindjen islame, mirëpo këta ulema aq shumë kishin punuar, sa që edhe pas një ndalese kushtetuese dyzetvjeçare, për aplikimin e fesë, pas shpalljes së demokracisë, u ringjallën ndjenjat dhe mësimet e ulemave nga njerëzit të cilët kishin ndenjur me ta dhe nga nxënësit që kishin mësuar prej tyre.

Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë, se besimin në Zotin dhe dashurinë ndaj atdheut nuk mund të ta marrë askush. Kështu që, na mbetet për obligim dhe parim jetik, ashtu siç Profeti deshi Mekën dhe Medinën, ne ta duam Shqipërinë.¹

1. Kumtesë e mbajtur me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar, në Konferencën Shkencore “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar” organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë më 28-29 shtator 2012, Universiteti Bedër, Tiranë.

Roli i imamëve dhe i ulemave në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare

MA. Ramadan Shkodra
Bashkësia Islame e Kosovës - Prishtinë

Rrethanat politike në të cilat u krijua LNDSH

Gjendja e rëndë që u krijua në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, bëri që aty të merrte hov rezistenca kundër shtypjes dhe pushtesit të ri jugosllav. Për organizimin e qëndresës popullore, për përpunimin e programit dhe kërkesave të popullit shqiptar në këto treva, u formuan dhe u riaktivizuan grupe dhe organizata politike që ishin pjesë përbërëse e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH).

Ndër organizatat më të rëndësishme të asaj kohe ishin Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) dhe “Besa Kombëtare”, me degët e tyre në Kosovë dhe në trevat etnike shqiptare në ish-Jugosllavi. Nuk ka ndonjë rast tjetër ndokund në Evropën Lindore, që pikërisht atëkohë të jetë themeluar një lëvizje demokratike, natyrisht pa llogaritur këtu mbetjet e shkapërderdhura të lëvizjeve të rezistencës antikomuniste, që vinin nga ditët e para të luftës. Pra, fjala është për një lëvizje dhe organizatë me program të qartë e me aspirata po ashtu të qarta politike e kombëtare.

LNDSH-ja bazohej në traditën e besëlidhjeve të moçme shqiptare, por hapat konkretë për riorganizimin e saj u bënë më 12 shtator 1943 në Pejë nga Prof. Ymer Berisha, At Bernard Llupi, Kolë Parubi, Marie Shllaku, Gjergj Martini etj. Ndërkaq, dy javë më vonë Shefqet Shkupi, Rifat Krasniqi, Haki Taha, Ejup Binaku, Selman Riza, Ibrahim Fehmiu dhe veprimtarë të tjerë formuan Komitetin Nacional Demokratik Shqiptar në Gjakovë. Ky komitet do të punonte për çlirimin dhe për bashkimin e trojeve shqiptare me përkrahjen e demokracive përëndimore.

Në fillim të vitit 1945 formohet ilegalisht Organizata Nacional Demokratike Shqiptare. Kjo organizatë hap një kaptinë të re në lëvizjen për çlirim dhe bashkim kombëtar. Mirëpo, pas vitit 1945, rrethanat dhe kushtet kishin ndryshuar, andaj imponohej një strategji e re veprimi. Themelues të kësaj organizate ilegale ishin: Prof. Ymer Berisha, ideolog i lëvizjes për ruajtjen e tërësisë etnike shqiptare dhe iniciues për formimin e organizatave ilegale në Kosovë e Maqedoni, pastaj profesorët e gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë: Luan Gashi, Hajdar Maloku-Planeja, Gjon Serreqi; agronomi Adem Gllavica,

gjykatësi Limon Staneci, që të dy kryeshefa të rretheve, njëri në Ferizaj e tjetri në Gjiçan; gjykatësi Ibrahim Lutfiu, Ukë Sadiku, kryeshef i Qarkut në Mitrovicë; Ejup Binaku, kryeshef i rrethit në Rahovec, me profesion mësues; Ajet Gërguri, teknik i bujqësisë dhe shumë e shumë të tjerë.

Platforma programore e NDSH-së

Platforma programore e NDSH-së, për zgjidhjen e çështjes shqiptare përmbledhet në pesë pika kryesore:

- *“Liri dhe pavarësi të plotë me të drejtë vetëqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të shfaqur lirisht.*

- *Nën tokat shqiptare kuptohen kreu të vendet, ku banojnë shqiptarët, në 60% pa dallim se si qubet kerabina e vendi dhe nga kush është i pushtuar.*

- *Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinj, as kundër partive politike, vetëm insiston në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet të arrijë idealet shekullore të kombit shqiptar që të jetë i lirë dhe vetësundues në shtetin e vet me kufij etnikë.*

- *Mbasi të vendosen kufijtë etnikë, pa marrë parasysh kushtet e tjera të kufijve siç janë ato: strategjikë, ekonomikë, politikë etj... në mënyrë miqësore do bëhet shkëmbimi i popullatave e pakicave nacionale, duke i tërhequr shqiptarët, që do të mbesin jashtë kufijve në vend të atyre që do të shpërngulen dhe do të përcillen jashtë.*

- *Në kohë paqe, Lëvizja nuk do të pushojë, por do të vazhdojë si shërbim roje të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të brendshme, ashtu edhe atyre të jashtme, ndërkombëtare duke organizuar një regjim me të vërtetë demokratik dhe relacione miqësore me popujt fqinj Ballkanikë».*

Kontributi i ulemave për çështjen kombëtare

Roli dhe kontributi i ulemasë shqiptare për çështjen kombëtare e shtetformuese gjatë historisë ka qenë i madh dhe përcaktues në ngjarjet e mëdha për popullin tonë dhe për mbrojtjen e trojeve tona, duke nisur që nga Lidhja e Prizrenit me myderrizin e njohur Haxhi Ymer Prizrenin, Halim ef. Ramadanin, Ahmet ef. Korenicën, Hafiz Ymer Gutën, Hasan ef. Shllakun, Hafiz Myrteza Luzhën, Jusuf ef. Podgoricën dhe shumë ulema të tjerë nga të gjitha viset shqiptare; për të vijuar me Lidhjen e Pejës, ku shquhet Haxhi Zeka; Shpalljen e Pavarësisë me Vehbi e Ismet Dibrën, Daut Boriçin me ulemanë shkodrane, Hafiz Ali Korçën e Hafiz Ibrahim Dalliu e të tjerë; Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës me Hoxhë Kadri Prishtinën, Rrystem Shportën, Iljaz Brojën, Mulla Idriz Gjilanin e Haki Sermaxhajn, Sheh Hysenin e Musa Shehzaden... e shumë e shumë të tjerë me një kontinuitet deri në ditët tona.

Kontributi i ulemasë shqiptare ishte përcaktues, si me marrjen pjesë aktive në kryengritje të shumta, madje edhe duke i udhëhequr ato, por edhe duke u dhënë kurajë luftëtarëve të lirisë me këshilla e vepra dhe me autoritetin, që e gëzonin në masë. Ulemaja shqiptare ishte e motivuar nga mësimet kura'nore dhe porositë e Muhamedit (a.s.) që të japin në vazhdimësi kontributin e tyre për liri e pavarësi.

Ulematë shqiptarë nuk ishin politikanë me profesion, por ishte vetëdija e tyre morale e politike, si

sintezë e dy komponentëve kryesorë: patriotizmit dhe besimit, që i vuri ata në krye të ngjarjeve të mëdha të kombit, me të cilat jo vetëm që hynë në histori, por edhe e bënë historinë. Në këtë kontribut tonin shkurtimisht do të paraqesim kontributin e ulemasë shqiptare në radhët e NDSH-së.

Prania e imamëve në radhët e NDSH

Që nga fillimi në radhët e NDSH-së, në strukturat e saj, do të gjejmë shumë imamë e hoxhallarë që ndihmuan në drejtimin, në strukturimin, por edhe në masivizimin e kësaj lëvizjeje.

Angazhimi i imamëve dhe hoxhallarëve në radhët e NDSH-së është vazhdimësi e kontributit të ulemasë shqiptare në lëvizjet e mëdha për popullin tonë, që nga Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës, pastaj kontributi i ulemasë gjatë Rilindjes Kombëtare, si dhe përkrahja dhe mbështetja për formacionet patriotike, që ishin në shërbim të filozofisë së kombformimit e shtetformimit.

NDSH-ja e zhvilloi aktivitetin e saj në trojet shqiptare, që atëbotë rrezikonin të mbeteshin nën pushtimin jugosllav, në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni.

NDSH-ja, për shkaqe që i ishin imponuar, në nivelin qendror udhëhiqej nga komitetet e Prizrenit dhe Shkupit, ndërsa në nivel lokal udhëhiqej dhe organizohej nga komitetet e zonave apo të rretheve.

Meqenëse nuk është bërë ndonjë studim i hollësishëm për praninë e

imamëve dhe ulemave në radhët e NDSH-së, - ndërsa them se në të ardhmen duhet të bëhet, - në këtë vështrim tonin, po paraqesim vetëm disa veprimtarë të shquar që e bënë historinë dhe lanë gjurmë në radhët e NDSH-së.

Hafiz Ymer Shemsiu (1895-Sazli 1945)

ishte pinjoll i një familjeje intelektuale hafizësh dhe haxhilerësh. Ymer Shemsiu i ndoqi mësimet e mesme fillimisht në Medresenë e Prishtinës e pastaj në atë të Shkupit. Mirëpo, për arsye madhore, nuk arriti t'i përfundonte. Me vullnet të patundur arriti të zotëronte disa gjuhë të huaja, si: arabishten, persishten, turqishten, gjermanishten dhe serbishten. Krahas zotërimit të këtyre gjuhëve, ai u thellua edhe në studimet letrare, e në mënyrë të veçantë, në studimet filozofike, duke formuar kështu fizionominë e intelektualit të mirëfilltë islam. Ymer Shemsiu është një figurë poliedrike. Ai ishte imam, poet, luftëtar, veprimtar, mësues. Në periudhën e Luftës së Parë Botërore Ymer Shemsiu hapi në fshatin Sazli një shkollë shqipe. Shkolla fatkeqësisht pati jetë të shkurtër. Pushtuesit bullgarë, kur hynë këtu, e mbyllën menjëherë këtë shkollë, ndërsa mësuesin e saj shqiptar, Hafiz Ymerin, e lidhën me vargonj dhe e dërguan në burgun e Ferizajt.

I ngritur nga ana botëkuptimore islame, botëkuptim që e respekton lirinë dhe lufton për të, Hafiz Ymeri, gjithashtu i mbrujtur me dashuri për kombin, u aktivizua në shërbim të Komitetit për

Çlirimin Kombëtar të Kosovës dhe bëri pjesë në partinë politike shqiptaromyslimane “Bashkimi”, që kryesohej nga Ferhat Bej Draga. Në këtë kohë, Hfz. Ymeri shpërtheu me tërë personalitetin e tij, bashkëpunoi me lëvizjen kaçake kombëtare, këndoi me çifteli këngë për të kaluarën e lavdishme të kombit, shkroi ilahi dhe thuri poezi me metrikë të ndryshme, por ku mbizotëron vargu popullor.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së Hfz. Ymer Shemsit është edhe organizimi i mësimin të gjuhës shqipe fshehurazi. Në xhaminë e Talimocit, ku shërbente si imam, ngriti Komitetin e Kosovës. Ai jepte mësimin e gjuhës shqipe fshehurazi dhe, në të njëjtën kohë, e mbante edhe mejtepin. Mësimin e nxënësve, në lokalitë të ngritur nga vetë populli, e vazhdoi që nga viti 1934 deri më 1941. Hfz. Ymeri bëri punë pedagogjike përtej programit që zhvillohej në mejtepe.

Përveç shkrim-leximit në gjuhët orientale, ai u mësoi nxënësve dhe shkrim-lexim në gjuhën amtare shqipe dhe i pajisi me njohuri e aftësi të vlefshme për jetën e përditshme.

Në veprimtarinë e tij zë një vend të rëndësishëm edhe krijimtaria si rapsod i talentuar. Talenti i rapsodit kronikan shoqërohej nga virtuozeiteti i tij si valltar i shkëlqyer. Ai i hartonte vetë këngët, i këndonte me çifteli dhe i kërcente me lëvizje karakteristike shqiptare. Protagonistë dhe tema të rapsodive e të këngëve të tij qenë heronjtë e kombit, betejat, bëmat e ndryshme, duke na dhënë kështu tablo realiste të kohës.

Nga krijimtaria e tij spikat poema «Nazmi Gafurri». Për këto cilësi, Hfz. Ymer Shemsiu nga studiues u quajt «Bard i Kosovës». «Bardi i Kosovës» e sfidoi policinë serbe, duke i mësuar shqip nxënësit dhe popullin, duke shkruar shqip dhe duke botuar në shqip. Ai hartoi rreth 30 ilahi shqipe, që kapin rreth 1.000 vargje dhe përçoi te nxënësit e populli besimin islam. Ai kishte një qëndrim të prerë dhe një mendim të qartë për bashkimin e popullit, për luftën kundër përçarjes fetare dhe asaj kombëtare. «Të mbrosh fenë islame për kohën e poetit ishte luftë për kombin shqiptar, ta mbrosh gjuhën shqipe ishte heroizëm kombëtar, të përpiqesh për lirinë, ta ndihmosh rezistencën shqiptare kundër denacionalizimit të Kosovës, kundër shpërnguljes së shqiptarëve, ishte luftë patriotike, ishte sakrificë e heroizëm kombëtar». Hfz. Ymeri ishte për një Shqipëri etnike. Ai mori pjesë aktive për realizimin e kësaj ideje, duke ngjallur armiqësinë e pushtetit serb ndaj tij. Vdiq në mënyrë të dhembshme, por të madhërishtme, që konkretizohet në fjalët e fundit të tij: *“Lamtumirë, o populli im! Për ty dhashë atë që mund ta jepja: pasurinë, familjen, veten. Për ty do të vijmë ditë më të mira”*.

Idriz Hajrullahu - Mulla Idriz Gjilani (1901-1949)

lindi në Velekincë të Komunës së Gjilanit, më 4 qershor 1901. Mësimet fillestare i ndoqi në mejtepin e Cernicës, të cilat edhe i mbaroi në vitin 1911, për t'i vazhduar ato në medresenë e mesme «Atik» në Gjilan. Pas një ndërprerjeje të

shkollës, më 1926 arriti të diplomonte. Shërbeu në detyrën e imamit në Karadak e në Hogosht (fshat në Komunën e Dardanës). Më 1941 u zgjodh në postin e Bashvajzitet në Ulema-Mexhllisin e Kuvendit fetar-arsimor të Vakëfit të Shkupit.

Gjatë kohës si hoxhë dhe kryevaiz zhvilloi një veprimtari intensive në fushën e edukimit fetar me frymë atdhetare. Hapi mejtepin e Pidiçit për mësimin e djemve dhe të vajzave, organizoi ilegalisht mësimin e shkrim-leximit me alfabetin e gjuhës shqipe, futi mësimin shqip në medresenë “Atik”, ushqeu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin vëllazëror me bazë kombëtare shqiptare në popullsinë myslimane-katolike të zonës së Karadakut.

Nga prilli i vitit 1941, Mulla Idriz Velekinca, iu kushtua plotësisht veprimtarisë politike. Si hoxhë me forcën e Zotit, si mësues me forcën e fjalës, si luftëtar me forcën e armës, si komandant me besnikërinë e ushtarit, ai luftoi për unitetin territorial të trevave shqiptare, luftoi kundër gjenocidit serb e bullgar, kundër komunizmit.

Në qershor të 1944-ës drejtoi betejën e Kikës, në të cilën, shqiptarët të udhëhequr prej tij, dolën fitimtarë kundër ushtrisë sllavo-komuniste. Veprimtaria e Mulla Idriz Gjilanit është heroike. E tillë është edhe periudha 1944-1949. E dogjën në natën e 25-26 nëntorit 1949.

Ishte intelektual i kohës, i cili zotëronte shumë gjuhë orientale, gjë që e mundësoi të njihej me arritjet shkencore të kohës, në fushën e

fizikës, kimisë, mjekësisë, astronomisë, etj. Botoi punimet fetare “Lindja e Pejgamberit” dhe “Vllazëria Islame”, të cilat përshkoheshin nga mesazhi i paqes, vëllazërimit, bashkimit kombëtar etj.

Mulla Idriz Gjilani thoshte: *«Liria e vatanit nuk fitohet me parti e me tarafe, me të pafe e me shkjeje të veshur shqiptarçe».*

Ibrahim (Hazër) Lutfiu nga Prizreni

Ishte sekretar i përgjithshëm i Rijasetit të Bashkësisë Islame të asaj kohe me seli në Sarajevë, ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore prefekt i Mitrovicës. Në nëntor të vitit 1944 u arrestua nga OZN-ja, por rrugës për në Prishtinë e liruan luftëtarët shqiptarë, të cilët më 2 dhjetor e kishin rrethuar Ferizajin. Pasi kaloi në ilegalitet, veproi në vise të ndryshme të Kosovës, u lidh me KQ të ONDSH-së me qendër në Shkup; i bashkërendoi aksionet politike me Shtabin Suprem të Kosovës dhe me organizatën “Besa Kombëtare” të Ymer Berishës. Në vitin 1946 mori pjesë në Kongresin e Lypovicës dhe bashkëpunoi me udhëheqës të LNDSH-së e të njësiteve guerile në Drenicë, Shalë, Llap, Moravë etj. Ai ndërroi jetë në vitin 1950.

Haki Taib Salihu (Myderriz Haki ef. Sermaxhaj)

Lindi më 14 tetor 1914 në Hogosht të Kamenicës, në një familje me tradita fetare e atdhetare, i edukuar dhe i formuar si intelektual i guximshëm për çështjen e besimit fetar, për kombin dhe atdheun.

Pasi e kreu shkollën fillore, në vendlindjen e tij më 1925/26, Hakiu regjistrohet në medresenë “Meddah” të Shkupit në vitin 1927/28, ku u shkollua te myderrizi dhe patrioti i shquar Ataullah ef. Kurtishi.

I sapokthyer nga medreseja “Meddah” e Shkupit, ku kishte marrë titullin Myderriz, në vitin 1940 Haki Efendiu fillon aktivitetin e tij fetar e patriotik, në medresenë “Atik” të Gjilanit, si myderriz dhe drejtor i saj. Gjatë kësaj kohe ai e reformon medresenë. Më e rëndësishmja është se ia doli të luante rol të rëndësishëm për zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe bashkimit kombëtar, duke e futur gjuhën shqipe si lëndë mësimi në medrese.

Pas Luftës së Dytë Botërore inkuadrohet në përpjekjet e popullit shqiptar për liri e dinjitet kombëtar. Duke mos u pajtuar me ripushtimin sllavo-komunist të viseve etnike shqiptare, Haki Sermaxhaj do të gjendet në vorbullën e LPLTSh-së (Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare), gjegjësisht ONDSH dhe “Besa Kombëtare”, si organizata legale politike të organizuara mirë dhe të krijuara në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, me degët e shtrira në të gjitha viset shqiptare të ish-Jugosllavisë, të cilat kishin program dhe aspirata politike kombëtare, qëllimi i të cilave ishte çlirimi dhe bashkimi i trojeve shqiptare. Këtu Haki Sermaxhaj shquhet si udhëheqës dhe organizator i aftë, duke qëndruar në krye të Komitetit të Qarkut NDSH-së për Rrethin e Gjilanit, për shpëtim e bashkim kombëtar.

Pas zbulimit dhe burgosjes së KQ me qendër në Shkup, në gjysmën e dytë të muajit gusht të vitit 1946, burgoset edhe Haki Sermaxhaj në burgun e OZN-së të Qarkut të Shkupit, ndaj të cilit përdoren tortura çnjerëzore nga më të tmerrshmet. Si pasojë e tyre sëmuret rëndë dhe nuk i ofrohet kurrfarë ndihme mjekësore. Ishte kjo arsyeja që Haki efendiu të mos gjykohej së bashku me të tjerët në “Procesin e Gjilanit”, por për të do të organizohet gjykim i veçantë në Gjyqin e Qarkut në Gjilan, ku dënohet me 20 vjet burgim të rëndë. Për vuajtje të dënimit dërgohet në Burgun e Mitrovicës së Sremit.

Myderrizi Haki ef. Sermaxhaj vdiq më 27 janar 1948, pas 9 muaj qëndrim në spitalin e Burgut të Mitrovicës së Sremit. Disa shokë, me leje të drejtorisë së burgut, e varrosën në varrezat e burgut. Eshtrat e tij edhe sot prehen në tokën e huaj.

Mulla Iljaz (Hysen) Broja (1892-1946)

Lindi në fshatin Kastriot. Kreu medresenë në Gjakovë dhe shërbeu imam në Brojë dhe në disa vende të tjera të Drenicës. Veprimtar i “Xhemijetit” (Bashkimit) dhe i Lëvizjes Çlirimtare, u angazhua për ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Gjatë viteve 1941-1944 mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e trojeve etnike nga sulmet çetnike, ishte veprimtar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Tiranë (1943-1944). Në nëntor të vitit 1944 bashkëpunoi për ngritjen e

këshillave në Skenderaj e më gjerë dhe u inkuadrua në Brigadën e Drenicës. Pas përfundimit të Luftës së Drenicës, u përfshi në qëndresën kundër zgjedhës jugosllave. U arrestua më 1946 dhe u ekzekutua në Zllakuqan të Klinës.

Mulla Januz Abazi - Lubishta (1885-1951)

Lindi në fshatin Lubishtë të Vitisë dhe ishte imam i këtij fshati. Në kohën e Luftës së Parë Botërore u keqtrajtua dhe u ndoq nga forcat bullgare të cilat e mbanin të okupuar këtë pjesë të Moravës, ndërsa gjatë viteve 1941-1944 u angazhua për bashkimin e këtyre viseve me Shqipërinë dhe për mbrojtjen e kufirit etnik në Karadak e në Kozjak dhe në sektorët e tjerë.

Arif ef. Shala

Bir i Drenicës së Kosovës. Lindi më 1909 dhe që në moshë të re, kur ishte ende nxënës në mejtepin e Mulla Rifatit, shquhej ndër shokët e tjerë për zgjuarsinë e tij, shkathtësinë dhe karakterin e fortë. Duke qenë ende i ri, ai arriti të mësonte Kur'anin përmendsh dhe të dallohej për deklamimin e bukur që bënte. Më 1927 mbaroi medresenë e Gjakovës dhe në ato vite të rënda për Kosovën vazhdoi gjimnazin në Tiranë. Në fshatin Korroticë e Epërme, ku u caktua si imam, ai, së bashku me mësimit e fesë, u mësoi nxënësve në mënyrë ilegale lexim-shkrimin e gjuhës amtare shqipe. I tronditur nga krimet që bënte xhandarmëria serbe mbi popullin shqiptar, i dërgoi më 1933 letër proteste krajlit serb, Pjetrit. Më 1935,

me anë të një pamfleti, e ftoi popullin e Kosovës që t'i bojkotonte zgjedhjet. Mirëpo, ajo që e bëri popullor imam Arifin ishte kushtrimi i tij, që kosovarët të mos shpërnguleshin në Turqi, por të qëndronin në trojet e veta. Falë aktivitetit të tij, asnjë familje shqiptare nga Drenica nuk emigroi në Turqi.

Imam Arif Shala iu kundërvu fashizmit italian. Ai mori pjesë në çlirimin e Prishtinës dhe të Ferizajit. Arifi ishte njeri me karakter të fortë, me botëkuptim të qartë islam, me devocion patriotik, deri në vetëmohim, me një dashuri të papërshkrueshme për vendlindjen dhe për Kosovën. Ishte demokrat me ndjenjë dhe me zemër.

Arif efendiu nuk mund të pajtohej me politikën diskriminuese sllave antishqiptare dhe antikosovare. Ai doli ilegal, komit, për të luftuar për lirinë e popullit dhe lirinë e besimit islam. U ndesh disa herë me patrullat e UDB-së dhe më 1 janar 1947 policia serbe, pasi e diktoi, e rrethoi dhe e vrau në mënyrë barbare. Me gjithë kundërshtimet e policisë serbe, populli i Drenicës e varrosi me nderime imamin e tyre, Arif ef. Shalën.

Mulla Zekë Bërdynaj

U lind rreth vitit 1918 në fshatin Novosellë të Pejës.

Në vitin 1926 fillon medresenë në Pejë, për ta vazhduar më tej te mësuesi Fahri Efendiu, i njohur për dijenitë e gjera. Kështu, Zeneli (Mulla Zeka i ardhshëm), u përgatit që t'u jepte mësim të tjerëve. Ishte koha kur shkollat shqipe ishin mbyllur nga ligjet e rrepta

të pushtuesit, për asimilimin e breznive të reja. Mirëpo, pati edhe prej mësuesve të njohur për fusha të tjera të shkencave, si gjuha e letërsia shqipe, historia, matematika, gjeografia etj.

Një nga mësuesit, që e kreu shkëlqyeshëm këtë detyrë, ishte edhe Mulla Zeka, duke ngritur një mejtep në fshatin Radavc, pikërisht më 1938, ku përveç lëndëve të besimit dhe të gjuhës amtare e shkencave shoqërore me karakter kombëtar u mësonte nxënësve edhe psikologji.

Prej vitit 1941 e deri në vitin 1944, Mulla Zeka ishte në frontin e Rozhajës dhe Novi Pazarit, duke iu kundërvënë çetave çetnike me çetat vullnetare. Në njërin prej këtyre betejave, në vitin 1943, në masakrën e Bihorit, plagoset rëndë edhe Mulla Zeka, i cili ishte në detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të çetave vullnetare.

Në vitin 1948 burgoset dhe kalon nëpër burgjet e rënda të ish-Jugosllavisë të «Bella Kuçës» në Nish, ku kaloi katër vjet, dhe në Goli Otok nga vitet 1952-1960, i dënuar me motivacion të shpifur si prostalinian. Atje Mulla Zeka u qëndroi burrërisht torturave më të egra, duke mbetur i papërlyer dhe i nderuar. Në një rast, duke kujtuar momente nga Burgu i Goli Otokut, ai pati thënë: «*Më e vështira për mua ishte të bartja gurë..!? Po të ishte për të ndërtuar diçka do ta bëja me dëshirë..! Por ne ishim të detyruar t'i bartnim gurët sa në njërin anë sa në anën tjetër*».

Mulla Zeka, pasi doli nga burgu, përveç si imam i fshatit Novosellë, ku organizonte edhe mësim besimin me nxënësit e fshatit, u angazhua sidomos

për pajtimin e gjaqeve dhe konflikteve mes njerëzve. Prandaj, me të drejtë e quajten edhe pionier i pajtimit të popullit në Podgor. Ato probleme, që nuk i zgjidhte ligji i shtetit të instaluar, i zgjidhte Mulla Zeka. Vdiq më 12 janar 1987.

Haxhi Hafiz Jakub Dukagjini - Muqeziu (1919-2006)

U lind në Prizren në vitin 1919. Mejtepin e kreu pranë Xhamisë së Emin Pashës, ndërsa e vazhdoi edhe mësimin e hifzit (përmendsh) të Kur'anit te mentori i njohur i asaj kohe, muhafiz Beqir Kajserliu, i cili njëkohësisht ishte edhe imam i Xhamisë së Emin Pashës në Prizren.

Hifzin e kreu për 3 vjet, në vitin 1937, në moshën 18-vjeçare. Pas kësaj i vijoi mësimet për disa vite në Medresenë e Gazi Mehmed pashës të Prizrenit te myderrizët e njohur të asaj kohe - Hfz. Abdullah efendi Hizri, Hfz. Sylejman efendiu dhe në fund, te Hasan ef. Nahi.

Pas ripushtimit serb të Kosovës dhe vendosjes së pushtetit komunist, ai u inkadrua në celulën ilegale të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar të Rrethit të Prizrenit dhe veproi aktivisht në ilegalitet të plotë gjer në vitin 1950.

Pas denoncimit të celulës së Komitetit Nacional Demokrat Shqiptar në Prizren, Hafiz Jakub Muqeziu ishte burgosur me shokët e vet dhe dënuar me vdekje. Ky dënim pastaj i qe kthyer në burgim prej 20 vjetësh, për të kaluar plot 12 vjet në kazamatet e Nishit, duke bërë punë të rëndë fizike. Mirëpo, Hafizi i nderuar nuk ndenji kot as në

burg, madje aty mësoi mjeshhtërinë e xhamaprerësit, gjë që i ndihmoi shumë, sepse pas daljes nga burgu do të hapte një dyqan për të mbajtur gjallë familjen për vite me radhë. Pas daljes nga burgu, plot 7 vjet nuk iu lejua të punonte si predikues fetar dhe mezi në vitin 1969 u caktua për të punuar imam në Xhaminë e Emin Pashës, ku shërbeu plot 35 vjet, gjer në vitin 2004, kur doli në pension. Për plot 35 vjet, me përkushtim të madh, punoi si imam dhe në dekada u mbajti shumë të rinjve e të rejave mësimbesim.

Ai ishte një burrë i rrallë shqiptar, i cili çmohej për idetë e tij antikomuniste dhe antiserbe, si dy faktorët me pasoja më tragjike për popullin shqiptar. Ai në vepër, praktikoi thënien e njohur “Pa iman, s’ka vatan”, që do të thotë - “Pa fe, s’ka as atdhe”. Të gjithë atdhetarët gjatë gjithë historisë, përveçse kanë qenë patriotë të çmuar, kanë qenë edhe besimtarë të devotshëm.

Pas rënies së sistemit komunist, Hafiz Jakub Muqeziu mori pjesë në shumë takime dhe aktivitete të Partisë Nacional Demokrate Shqiptare e më vonë edhe të Ballit Kombëtar, si veteran i aktiviteteve të para antikomuniste dhe antiserbe gjatë viteve 1945-1950. Hafiz Jakub Muqeziu vdiq më 13 dhjetor 2006.

Mulla Nuredin (Halit) Gjinovci (1895-1954)

ishte kryetar i Komunës së Therandës dhe veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941). Në vitin 1943 u zgjodh kryetar i Komitetit

Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe deputet i Therandës në Kuvendin e Shqipërisë (1943-1944). Pas vitit 1944 ishte veprimtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH)-së dhe kryetar i Komitetit të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) të Therandës. U arrestua më 1947 dhe u dënua më 7 vjet burgim. U vra nga UDB-ja, në Burgun e Nishit (1954), 6 muaj para afatit të lirimit.

Mulla Hamit Sllovia

lindi më 1919 në fshatin Sllovi të Lypjanit. Në rininë e hershme ishte veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, ndërsa gjatë luftës i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Mbas nëntorit të vitit 1944 dhe deri në mars të vitit 1949, kur u arrestua, ishte pjesëtar i LNDSH-së. U dënua me 7 vjet burg, të cilat i vuajti në Burgun e Nishit, ku u bë i njohur për qëndrimin e tij të papërkulur.

Myderriz Sadri Prestreshi

Myderriz Sadri Prestreshi u lind më 17 tetor 1917, në katundin Mazgit, në rrethin e Prishtinës. Mësimet fillestare i kreu në Obiliq.

Si shumë bashkëkohës të tij të asaj kohe, më 1930 u regjistrua në Medresenë “Pirinaz” të Prishtinës, ku mësoi te myderrizët e njohur, Mulla Hamdi ef. Gërçina dhe Mulla Ahmed ef. Mardoçi.

Pas përfundimit të Medresesë, në vitin 1944, caktohet imam në xhaminë e fshatit Dobrajë e Madhe në rrethin e Lypjanit, kurse më vonë shërbeu edhe si mësues po në të njëjtin fshat.

Në fillim të vitit 1946, kur forcat partizane-çetnike sapo e kishin konsoliduar pushtetin, ndër kohë që ndaj popullit shqiptar silleshin me egërsi, Mulla Sadriu u inkuadrua në organizatën ilegale NDSH, (Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar) që përpiqej për çlirimin e Kosovës e bashkimin me Shqipërinë.

Pasi u zbulua nga oficerët e OZN-ës jugosllave, më 15 prill të vitit 1947, Gjyqi Ushtarak i Divizionit të Prishtinës, pas hetimeve, maltretimeve, e dënoi hoxhën, Mulla Sadriun, me katër vjet burgim.

Burgun e filloi në Prishtinë, për ta vazhduar në Mitrovicë, Nish dhe e përfundoi në Pozharevac.

Pasi lirohet nga burgu u ballafaqua me peripeci të shumta sa i përket punësimit, qoftë si hoxhë apo mësues.

Më vonë u angazhua si mësues në shkollat publike, imam në xhamitë e ndryshme e myderriz në Medrese ku punoi deri në pension. Vdiq më 16 janar të vitit 2002.

Në vend të përfundimit

Pra dashur që të ndalem në paraqitjen e të dhënave biografike dhe komiteteve dhe organizatave ku kanë vepruar, në vazhdim po përmendim vetëm emrat e disa imamëve dhe ulemave tanë, që ishin pjesë e NDSH-së, ndonëse numri i tyre është jashtëzakonisht i madh dhe është vështirë të përfshihet në një

kontribut si ky i yni. Të këtillë ishin: Myderriz Asim Efendi Luzha, Mulla Maliq Baliu nga Prizreni, Mulla Bahtijar Sokol Boshnjaku, sekretar i Vakfit në Ferizaj nga Ferizaj, Mulla Ismail Gashi-Rahovec, Ahmet Hasan Efendi nga Ferizaj, Mulla Ismail Maksuti nga Kaçaniku, Mulla Ramë Muharremi nga fshati Hërtrcicë, Hafëz Hetem Tahiti nga Reçica e Madhe e Tetovës, Mulla Hajdari i Orizares,

Ahmet Efendi nga Shtimja, Mulla Adem Ibrahim Maloku nga Jezerci i Ferizajt, Mulla Rizah Selimi-Poliçka, Mulla Rexhep Hamzë Krasniqi-Arllat, Mulla Asim Luzha nga Gjakova, Mulla Ilmi Ejup Shehu-Kaçanik, Mulla Maliq Gashi-Therandë, Mulla Rrustem Statovci, sekretar i Bashkësisë Islame në Podujevë, Mulla Hysen Statovci dhe shumë e shumë të tjerë.

Si përfundim, mund të themi se numri i imamëve dhe ulemave në radhët e organizatave dhe lëvizjeve nacionale, pra edhe në NDSH, është jashtëzakonisht i madh. Ata jo vetëm që ishin përkrahës dhe anëtarë, por një numër syresh ishin edhe ideatorë e themelues të këtyre lëvizjeve.

Dhe në përmbyllje, duhet thënë se mbetet obligim i studiuesve dhe institucioneve tona përkatëse që të ndriçojnë drejt rolin e këtyre personaliteteve në kauzën tonë kombëtare.

Literatura e konsultuar:

- Dr. Muhamed Pirraku, Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë 1995.
- Sabile Keçmezi -Basha, Lëvizja Ilegale Patriotike Shqiptare në Kosovë 1945-1947, Shkodër 1999.
- Dr. Daut Bislimi, Formacionet politiko ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997.
- Ibrahim Grainca-Cërnilla, Deri në vdekje për atdhe, (përgatiti prof. dr. Muhamet Shatri), Libri Shkollor, Prishtinë 2006.
- Emin Fazlija, Hamid Emini-Brunçaj (19.09.1909 - 16.10.1986) “Doktori” i maleve të lira të Drenicës dardane, Prishtinë 2009.
- Adem Ajvazi, NDSH-ja në Llap (1945-1949), Podujevë 2005.

Revistat:

- Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Formimi dhe veprimtaria e organizatës nacional demokratike shqiptare 1945-1948, Kosova nr.18/19, Prishtinë 1996.
- Dr. Muhamed Shatri, Mbi Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare në Kosovës dhe në viset tjera shqiptare, Kosova, nr. 20-21, Prishtinë 1998/1990, fq. 185.
- Besim Kajtazi, Gjurmë të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar, (X), “Ora”, 19, Prishtinë, 25. IX. 1991, f. 50.

Qasjet estetike në mendimin filozofik mysliman

Msc. Redi Shehu

Abstrakt

Në filozofinë islame, artet në përgjithësi nuk janë parë si çaqe përfundimtare si qëllim në vetvete brenda një rrethi të mbyllur, por si një dritare e drejtë pafundësisë brenda një konteksti intelektual. Ato (artet) janë konsideruar si mjete për të përçuar të vërtetat edhe filozofike drejt perceptimit të masës, pra përmes artit e vërteta filozofike thjeshtëzohen për një kapacitet më të kufizuar perceptimi. Në trajtimin që filozofët myslimanë i bënë së bukurës shihet edhe ndikimi që ato kanë nga konceptet platonike, si dhe nga ndikimi i teorisë së Plotinit mbi të bukurën e përkuptueshme apo të intelektueshme. Monizmi plotinian mbi joqenien si produkt i Qenies pa ndryshuar substancën e saj (Qenies) dhe lidhja e tyre përmes një vije ekzistimi, karshi dualizmit të Platonit për shqisoren dhe mbishqisoren, ishte koncept më afër filozofisë së Qenies si thelb dhe ekzistencë në të njëjtën kohë të mendimit filozofik islam. Filozofët myslimanë avancuan më tej konceptet e së bukurës së përkuptueshme, si dhe ndryshimet me procesin e të ndijuarit të së bukurës.

Një ndër përfaqësuesit eminentë të filozofisë islame ishte edhe Al-Farabi, i cili në shtjellimin e gjerë filozofik të shumë çështjeve të ndryshme përfshiu edhe punimet e tij filozofike mbi të bukurën e intelektueshme, i cili këtë nocion të së bukurës e bashkëngjiti me emrat dhe atributet e Qenies. Vepra e tij më e spikatur në këtë fushë ka qenë e titulluar “Qyteti Virtuoz” (*Al-Medina al-fadila*). Nga perëndimorët është quajtur si babai i Neoplatonizmit islam me gjuhë aristoteliane. Por ndryshimi i madh me Platonin qëndron në faktin se ai u jep një dimension teologjik koncepteve të tij filozofike në ndryshim nga ai politik që ne hasim tek Platoni. Në qendër të argumentimit të Al-Farabit për të

bukurën qëndron fakti se Zoti është më i bukur për arsye se vetë ekzistenca e tij është e përkryer dhe çdo krijesë e tij bëhet më e bukur sa më shumë, që ajo i afrohet perfeksionimit. Ndërsa burimin e bukurisë së Qenies (Zotit) ai e sheh te thelbi i Tij, që është edhe ekzistencë në të njëjtën kohë, e cila ndryshon nga bukuria e krijesave, që është aksidentale dhe me cilësi trupore dhe të panjësuar me thelbin e tyre. Për këtë arsye bukuria e Zotit (Qenies) i tejkalon të gjitha bukuritë e tjera sepse është thelbësore në vetvete dhe jo aksidentale.¹ Për Al-Farabi-un kënaqësia është në pritë të perceptimit, apo kuptimit të së bukurës,

1. Ammar al-Talbi Prospects: “The quarterly review of comparative education” Paris, UNESCO: vol. XXIII, nr. 1/2, 1993:353-372

kështu kënaqësia rritet sa më shumë që rritet gama e perceptimit të së bukurës. Për këtë arsye kënaqësia dhe e bukura janë të puqura me njëra-tjetrën.² Ashtu si Zotit ishte (është) më i bukur i qenieve sepse, dija dhe i dituri janë tërësisht në një, edhe kënaqësia e Tij, ashtu si e bukura qëndron larg perceptimit tonë. Vetë këto shtjellime të Farabiut mbi të bukurën, perceptimin si dhe kënaqësinë përbëjnë elemente estetike më vete.

Një tjetër kolos i mendimit filozofik islam ishte edhe Ibn-Sina, filozofia e të cilit bazohej te realiteti dhe arsyeja e cila nga ana e saj mund të perfeksionohet përmes shkallëve të të kuptuarit që të çonin te e vërteta finale te, Zoti. Për Ibn Sinën imagjinata kishte rolin kryesor në përkujtim, ngase ai krahason dhe ndërton imazhe të cilat hapin rrugë për te universalja te intelekti i pastër i Qenies absolute. Ai ndante thelbin me ekzistencën e gjërave ku thelb, konsideronte natyrën e gjërave, e cila qëndronte e ndarë nga realizimi apo ekzistenca fizike, apo mendore e tyre. Ky dallim i thelbit me ekzistencën ishte nocion për të gjitha gjërat përveç Zotit, i cili konsiderohej si shkaku fillestar e për pasojë thelb dhe ekzistencë në të njëjtën kohë.³ Vepra e tij “Traktati mbi dashurinë” është një trajtesë e zgjeruar mbi bukurinë e përkuptueshme dhe kënaqësisë në të shijuarit e saj, e cila përcakton konceptet e dashurisë dhe të bukurës mbi katër parime.

- Në parimin e parë flitet mbi shpirtin si njësi e vetme substanciale

(thelbësore), që përmbledh në vetvete fuqi të ndryshme ku puqen arsyeja dhe imagjinata.

- Në parimin e dytë flitet për veprime njerëzore, të cilat kanë attribute trupore dhe i afrohen më së shumti instikteve kafshërore. Në këto veprime përmenden ndjesia me anë të të prekurit, dëshirat, seksi, agresiviteti. Megjithëse këto tipare të veprimeve kafshërore për Ibn Sinën mund të administrohen nën presionin e logjikës njerëzore.
- Në parimin e tretë flitet që e mira ndodhet në të gjitha paracaktimet e Zotit në çfarëdo forme ato na shfaqen.
- Kurse formulimin e së bukurës tek Ibn Sina e gjejmë në parimin e katërt të tij, ku ai zbërthen atë në tre përbërës; *Rendi, Përbërja dhe Simetria*.

Për Ibn Sinën dashuria për të bukurën në instinktin kafshëror të shpirtit, është më e prirur drejt natyrores, ndërsa në shpirtin racional dashuria për të bukurën është më e prirur për nga e arsyeshmja.⁴ Pra, duke u bazuar mbi këto katër parime Ibn Sina mbërrin në konkluzionin se ndjenja estetike është e mbjellur në qeniet njerëzore, si krijesa intelektuale. Prandaj çdo gjë e bukur, përfshirë edhe formën e bukurisë njerëzore, zgjon tek njeriu instinktin estetik, i cili vlerëson bukurinë në dy dimensione, të brendshme dhe të jashtme, sepse ndjenja estetike tashmë është e përkufizuar që në krijimin e atij vetë.

2. Black, D. :’*Al-Farabi*’, in S.H. Nasr and O. Leaman:’*History of Islamic Philosophy*’, Kpt.12, London 1996:178

3. Rahman, F.:’*Essence and Existence in Avicenna*’, *Medieval and Renaissance Studies*” 1958 fq.1-16.

4. Ibn Sina (980-1037)’’ *Risala fi al-’ishq*’’ (*Treatise on Love*), përkthyer nga E. Fackenheim, *’A Treatise on Love by Ibn Sina*’, *Mediaeval Studies*, 1945:211.

Al-Gazali, një ndër filozofët, juristët dhe teologët më të mëdhenj myslimanë, qasjen e tij ndaj së bukurës e shpreh përmes librit të tij “Alkimia e Lumturisë”⁵, ku ai e kategorizon në tre lloje të bukurën.

- Lloji i parë është e bukura e jashtme fizike, e cila përbën edhe nivelin më të ulët të së bukurës.
- Lloji i dytë është e bukura morale, e cila thelbin e saj e ka tek karakteri i njeriut.
- Ndërsa lloji i tretë i së bukurës është bukuria shpirtërore, e cila për Gazaliun është bukuria më sublime për shkak të lidhjes direkte, që ajo ka me Krijuesin e së bukurës.

Ndërsa po në të njëjtin libër, Gazaliu e ndan natyrën njerëzore në tre shkallë. Shkalla e parë përfshin natyrën kafshërore, shkalla e dytë natyrën djallëzore dhe shkalla e tretë përfshin natyrën engjëlllore të njeriut. Për Gazaliun dy shkallët e para janë shkakësore, aksidentale dhe shkalla e tretë e natyrës engjëlllore të njeriut është thelbësore. Nëse arti fillon prej këtij niveli engjëllor atëherë ai shkon drejt origjinës së tij, drejt më të Lartit.

Konceptet filozofike për Imagjinatën, Mimesis-in dhe poetikën

Krahas Al-Farabiut dhe Ibn Sinës, gjejmë një tjetër filozof mysliman, Ibn Ruzhdin, i cili së bashku me dy të parët bashkohet në mendimin se imagjinata është baza e aftësive për të prodhuar arte. Al Farabiu në përcaktimin e vet mbi imagjinatën poetike shprehet se

5. Abu Hamid Al-Ghazali: “*The Alchemy of Happiness*” Përkth. Claude Fiel; Botimi i parë 1909, ribotuar 2008, kap. I-rë.

dy janë kapacitetet e deklarimit poetik; i pari mundohet të shpërfaqë subjektin e vet në një nivel më fisnik se sa është në realitet dhe i dyti shpërfaq subjektin e vet në formë më të ulët (poshtëruar) se ç’është në të vërtetë. Të dyja këto tipare të deklarimit poetik ndikojnë tek kapaciteti njohës i audiencës.⁶

Në të njëjtën gjatësi vale Ibn Sina përqendrohet në atë që shfaqje të tilla imagjinatë mund të jenë e kundërta e dijeve tona, por aftësia e imagjinatës për të ndikuar veprimet tona realizohet përmes një konsensusi intelektual të shpirtit njerëzor, i cili sipas filozofëve myslimanë është i lidhur me konceptin e imitimit. Ndërsa Ibn Ruzhd-i e zbërthen termin imitim (*mimesis*) si evokimin e një imazhi.⁷ Në përgjithësi mendimi i përbashkët i tyre lidhur me imitimin konsiston në faktin se ai (imitimi) është përfaqësim imagjinues, ku objekti riprodhohet në formë më të mirë ose më të keqe sesa ai është në të vërtetë. Dhe këtu që të tre filozofët myslimanë janë në linjën e Platonit e sidomos të Aristotelit kur bëhet fjala për *mimesis*-in sepse “sipas Aristotelit mimesisi është më tepër imitim i ideve, mandej edhe i cilësive imanente të artistit, të asaj që ai përjeton, kupton dhe sheh vetë”.⁸

Duke folur për imitimin poetik Al-Farabi, në veprën e tij “Libri mbi Poetikën”, thotë se imitimi poetik vjen

6. Al-Farabi: “*Ihsa’ al-’ulum*” (*The Book of the Enumeration of the Sciences*), botim. U. Amin, Kajro: *Librairie Anglo-Égyptienne*, edicioni i 3-të, 1968.

7. Ibn Rushd: “*Talkhis kitab al-shi’r*” Përkth. C.E.Butterworth, “*Averroes’ Middle Commentary on Aristotle’s Poetics*”, Princeton University Press, 1986.

8. Gërlaç Danko: “*Eestetika: Historia e problemeve filozofike*” Përkth. Fehmi Agani, Prishtinë 1984:46.

9. Al-Farabi: “*Kitab al-shi’r*” (*Book on Poetics*), pwrkth.. A.J. Arberry, ‘*Farabi’s Canons of Poetry*’, *Rivista degli Studi Orientalenr.* nr 17 viti 1938

përmes gjuhës, i cili ka ngjashmëri me imitimin i cili vjen përmes veprimit në të imituarit e diçkaje, ku qëllimi përfundimtar i tij është të shkaktojë imazherinë e objektit të imituar në mënyrë direkte apo indirekte. Ndryshimi mes këtyre dy mënyrave të imitimit përmes veprimit qëndron në faktin se një statujë është imitim i një personi, ndërsa pasqyrimi në pasqyrë i statujës është imitimi i imitimit. I njëjti fenomen për Farabiun ndodh edhe në imitimin gjuhësor në poezi, i cili për disa njerëz sa më i shkuar në kohë të jetë, aq më perfekt dhe më afër artistikes është. Forca imituese e mënyrës së të shprehurit është më e madhe në ndikimin veprues të njeriut. Ibn Ruzhdi përmes veprës së tij “Komentari mbi Poetikën”¹⁰ merr në shqyrtim poetikën e poetëve arabë dhe ashtu si filozofët e tjerë myslimanë, prirja e komentimit është tek fakti se poetika dhe retorika mund të përdoren si në artikullimin politik ashtu edhe në atë religjioz. Po ashtu edhe Farabi në veprën e tij “Libri i letrave”¹¹, si dhe Ibn Ruzhdi në “Traktati Vendimtar”¹², prirjen të argumentojnë se këto arte formojnë bazën shpjeguese të marrëdhënieve mes filozofisë dhe fesë.

Pra kultura e vendeve myslimane kishte nevojë të trajtonte një formë të re arti, e cila ishte unike dhe e përqendruar në postulatit se e bukura më së shumti ishte atribut hyjnor, gjë që kishte nevojë të shprehej në forma të kuptueshme perceptive, duke shprehur substancën përmes teknikash, që nuk cenonin këtë

parim. Subjekti nuk duhej të paraqitej besnikërisht në formën e vet natyrore por duhej të shprehte autonominë e vet, sepse ai ishte substanca, e cila duhej të shfaqej përmes një strukture shprehjeje të kapshme për soditësit. Kjo strukturë e re shprehjeje u identifikua me individualitetin dhe jo me formën e subjektit, i cili përmes artit shfaqej si koncept ose si ide dhe jo si objekt konkret në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kështu u mënjana riprodhimi besnik i krijesave dhe u anua nga prirja për të shfaqur konceptet e tyre për të mos kundërshtuar artistikisht aktin e Krijuesit. Në këtë formë artisti mysliman mundej në të njëjtën kohë të shprehte të brendshmen dhe të jashtmen e artit të tij, duke ngjizur në një vepër si të bukurën aksidentale të krijesave me të bukurën esenciale si tipar i Qenies (Krijuesit).

Konceptet estetike në artet islame

Ndryshueshmëria e materialeve, formave, ngjyrave, si dhe përkujdesja për t'i dhënë artit shpirt përmes evokimit të esencës dhe idesë e jo formës, ka qenë karakteristika e arteve islame në kohëra dhe vende të ndryshme. Pikërisht prej evokimit të substancës, si dhe mesazhit të pafundësisë në veprat e artit, duke mos u kufizuar me përmasat e krijesave, mesazhi artistik islam ka pasur si moto të vetën intelektualizmin në formatin më të intelektueshëm të mundshëm. Kjo e bënte të dallueshëm artin islam përmes fokusimit në formate abstrakte, si e kundërta e krijesave në formatin origjinal të tyre, që shfaqeshin përmes shenjave gjeometrike, të kaligrafisë dhe bimësisë.

fq. 267. Botimi i M. Mahdi, *Shi'r* 3 viti 1959: 91.

10. Ibn Rushd (1174) “*Talkhis kitab al-shi'r: Middle Commentary on the Poetics*”, Përkth. C.E. Butterworth, Princeton University Press, 1986

11. Al-Farabi (c.870-950) “*Kitab al-buruf: The Book of Letters*”. Botim. M. Mahdi, Bejrut: viti 1969.

12. Ibn Rushd (c.1179-80): “*Fasl al-maqal :Decisive Treatise*”. Përkth. G.F. Hourani, Londër, 1961.

Artet pamore

Është e dobishme të përmendim, sidomos formën gjeometrike të arteve islame, e cila pati edhe arsyet e veta se pse mori një zhvillim kaq të madh në të gjithë hapësirën islame. Fakti që kjo mënyrë e të shprehurit nuk konfliktonte me të pikturuarit e krijesave të gjalla ishte ndoshta një ndër arsytet dominonte, se përse u zgjodh si formë shprehjeje, e cila përmes imagjinatës së lirë dhe krijimtarisë artistike mbërriti nivele të larta perfeksioni. Një tjetër mundësi se pse arti gjeometrik mori një zhvillim kaq të madh i atribuohet edhe zhvillimit të papërmbajtshëm të shkencave ekzakte nga myslimanët, të cilët arritën që përmes formave gjeometrike të shpreheshin estetikisht mbi thelbin dhe mesazhin e veprës së artit. Kështu për herë të parë u formuluan teoritë e aplikimit të estetikës gjeometrike në artet pamore. Ky art i një precizioni të rrallë ishte totalisht i abstenuar nga rastësia krijuese, sepse shprehja estetike realizohej përmes përllogaritjesh të sofistikuar matematikore dhe gjeometrike në shprehjen e botës së brendshme të artistit, duke i dhënë si kurrë më parë dimension human shkencave ekzakte. Pikërisht ky perfeksion i formave gjeometrike, duke përfshirë edhe arabeskat, sipas Martin Briggs në veprën e tij “Arkitektura Muhamedane në Egjipt dhe Palestinë”¹³, mahniti Leonardo Da Vinçin i cili u mor për një kohë të gjatë për të riprodhuar modelet e sofistikuar të këtij arti.

13. Briggs, Martin Shaw: “*Muhammadan Architecture in Egypt and Palestine*” Claredon Press, Oxford, 1924, fq. 178.

Kaligrafia përmes formave gjeometrike, duke ruajtur edhe simetrinë, si një ndër elementet thelbësore të së bukurës në arte, ishte përbërësi kryesor në artet dekorative. Mesazhi i kaligrafisë përmes arabeskave, tentonte të shtrihej në hapësirë dhe kohë shpesh duke imponuar një ritëm shumëfishimi, i cili udhëhiqte kah një drejtim pa cak, duke abstraguuar pafundësinë. Përdorimi i gjerë në artet dekorative të shkronjave me nuanca zgjatimesh artistike, lidhej me faktin se ato simbolizonin dijen, e cila përbënte edhe kushtin e parë të mesazhit hyjnor në qasjen e njeriut me botën. Shkrirja e formës, duke shprehur përmbajtjen në të njëjtën kohë me anë të një gjuhe e cila konsiderohej si gjuha me simbolet e së cilës zbriti revelata hyjnore, e zhyt njeriun brenda një pothuaj hipnoze ciklike, e cila përjashtëson çdo kufizim të lidhur me forma konkrete të mbyllura me destinacion të përcaktuar, duke i dhënë imagjinatës rrugë drejt transhendentës. Njihen dy format më të spikatura të kaligrafisë islame, e para është ajo e shkollës së Kufas dhe e dyta është kaligrafia e tipit Naski, e cila gjeti një aplikim shumë më të madh sidomos gjatë Perandorisë Osmane në zbukurimet e objekteve të kultit, por edhe të formave të tjera të artit dekorativ. Grunebawn¹⁴ ka një përkufizim tipik për artin figurativ islam, ku ai formulon idenë se Islami është i vetmi religjion në botë, i cili nuk ka nevojë për artet figurative dhe imazherinë për të shprehur konceptet e veta.

14. Von Grunebawn, G.E.: “*Ideology Muslimane et Esthetique Arabe*” Studia Islamica vol. III Larose, Paris, 1955:6-23.



E gjithë kjo formë e veçantë, unike në llojin e vet, ka pasur influencë në boshtet e tjera qytetërimore dhe kësaj nuk i ka shpëtuar edhe kultura evropiane, e cila përgjatë shekujve XI-të dhe XVI-të ka huazuar shumë nga konceptet abstrakte të arteve islame. Ali Jairazbhoi, një ndër studiuesit më eminentë në botë i shumë fushave të arteve islame, por edhe më gjerë të arteve të antikitetit, në librin e tij “Influenca Orientale në Artet Perëndimore”¹⁵, vërteton tezën se stilet Rokoko dhe Barok të arteve perëndimore gjatë shekujve XVI-të-XVIII-të, ishin të frymëzuara nga arti islam i arabeskave.

15. Jairazbhoy, Rafique Ali: “*Oriental Influence in Western Art*”, Asia Publishing House, London 1965.

Sipas tij stili Rokoko plot dritë dhe me linja harkore me nuanca abstrakte është imitim i dizenjove të arabeskave. Ky stil Rokoko u zhvillua në Francë në shek. e XVIII-të e më vonë u përhap më gjerë në Evropë. Elementët e këtij stili autori i gjen në Pallatin Al-Xhaferia në Spanjën myslimane të shekullit të XI-të. Po ashtu shembuj të tjerë të stilit Rokoko gjenden edhe në xhaminë Tlemcen në Algjeri, e cila u ndërtua në vitin 1136. Jairazbhoi shkon edhe më tej, kur flet për stilin Barok, dhe thotë se fjala “barok” rrjedh nga fjala arabe *burga*, që nënkupton “sipërfaqe e thyer” nga ku buroi terminologjia portugeze pastaj *barocco*, që do të thotë “perlë në trajtë të parregullt”.



Harkatë dekorative në Al-Xhaferia plot me elementë të cilët frymëzuan stilin Barok (Spanjë shekulli XI-të)

Pra, abstenimi i sjelljes në artet islame të krijesave në formatin e tyre natyral, jo vetëm që krijoi një art unik për të gjithë botën, duke stabilizuar edhe rregullat e veta estetike, por mbi të gjitha formuloi një soj arti, i cili po ashtu mbante të njëjtin qëndrim edhe për sa i përket figurave fetare. Kjo asnjësi në pjesëmarrjen artistike, ishte kyçi i penetrimit të lehtë të arteve islame në të gjitha qytetërimet, që u bënë pjesë e

këtij religjioni, por jo vetëm kaq, sepse qëndrimi i qartë artistik dhe pa ekuivok në atributet e vetme të Absolutit, lehtësuan përfaqimin e elementëve të këtij arti edhe nga arti perëndimor.

Muzika

Një ndër elementët përbashkues midis kulturave të ndryshme brenda Islamit, është edhe muzika si një ndër format më të zhvilluara të artit shprehës. Ashtu siç e përmendëm më përpara, ku si filozofia edhe artet në Islam janë të lidhura dhe janë një përçues i së vërtetës hyjnore dhe muzika në këtë kontekst është një ndër format e shprehjes së kësaj të vërtete. Gjatë periudhës së Abasinjve u sollën punime të Greqisë së lashtë të cilat muzikën e kishin trupëzuar brenda zhanreve të shkencave ekzakte, më saktë matematikës. Një ndër figurat e shquara që shkroi rreth muzikës është edhe Al-Kindi nga mesi i shekullit të IX-të, i cili bëri përlogaritjen matematikore të intervaleve dhe aplikoi shkallët muzikore të lahutës, duke i vendosur ndarje prej metali në bishtin e saj. Ai për herë të parë përdori fjalën e arabizuar *musiki*,¹⁶ si dhe ishte i pari që përmes eksperimenteve të tija zbuloi efektet shëruese të muzikës. Është e faktuar që me anë të muzikës ai arriti të shëronte një djalë tetraplegjik. Po ashtu Al-Farabiu shkroi librin e tij “Libri i madh i Muzikës”, ku hulumtoi për shkallët dhe intervalet muzikore, e cila u përkthye në shek. e XII-të në Spanjën myslimane edhe më vonë në latinisht,

16. Farmer, Henry.: ” *Historical facts for the Arabian Musical Influence*”, Georg Olms Verlag, Hildesheim New York 1970:10.

duke ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e muzikës evropiane. Al-Gazaliu në punimet e tij analizoi dobinë e ritmit muzikor, si dhe të këngës në jetën shpirtërore të njeriut me qëllimin, që të arrijë bashkimin shpirtëror me Zotin.


Një tjetër qasje shumë interesante mbi muzikën në artet islame janë edhe disa fakte që studiues të njohur sjellin mbi rolin thelbësor të myslimanëve në themelimin e teorisë muzikore. Për shumë kohë, studiues perëndimore kanë refuzuar një fakt të tillë por sipas mendimit të Jean-Benjamin de Laborde¹⁷, notat muzikore që aktualisht përdoren sot (*do, re, mi, fa, sol, la dhe si*) janë derivat i alfabetit të myslimanëve. Deri më tani mendohej se është Guido d’Arezo (995-1050) formuluesi i notave muzikore më 1026. Mendimin e Laborde e përforcon një tjetër studiues francez, Guillaume-André *Villoteau*¹⁸ në veprën e tij “Përshkrimi i instrumenteve muzikore të orientit”.

Vështrimin më të detajuar mbi këtë çështje e jep Henry George Farmer në monografinë e tij të famshme “Fakte historike për influencën e muzikës arabe”¹⁹, ku ai sjell ngjashmërinë në tingull të alfabetit arab me notat muzikore:

17. de Laborde, Jean-Benjamin: ” *Essai sur la Musique ancienne et moderne*” vd.1780, fq. 8-9, dhe fq. 22.

18. Villoteau, Guillaume-André, (vd.1839): ” *Description des instruments de musique des orientaux*”, fq. 858.

19. Farmer, Henry: ” *Historical Facts For The Arabian Musical Influence*” Kapitulli “The syllables of sofeggio”.



Alfabeti arab

**Mim, Fa, Sad, Lam, Sin, Dal, Ra’
Notat muzikore**

Mi, Fa, Sol, La, Si, Do, Re

Këto nota muzikore u përdorën nga myslimanët që nga shekulli i IX-të dhe i gjejmë në librat e Al-Kindit, Al-Farabiut, Ibn Sinës, Ali Ibn Jahjas, etj. Sigrid Hunke²⁰, studiuesja eminentë gjermane e orientit, për temën në fjalë, pohon se këto nota arabe janë gjetur në shekullin e XI-të, në traktatin muzikor të Monte Casinos, vend i cili kishte pasur praninë e myslimanëve për një kohë të gjatë. Për pasojë jo vetëm teoria muzikore, por edhe instrumentet me të cilat u luajt kjo muzikë, sipas Farmerit, janë transportuar më vonë në vendet perëndimore, ku ai paraqet edhe një tabelë krahasuese të emërtimeve të instrumenteve muzikore të përdorura nga arabët, e që më pas ruajtën ato

20. Hunke, Sigrid 1969, op. cit.

emërtime edhe në terminologjinë e perëndimit²¹.

Instrumenti në gjuhën arabe	Instrumenti në anglisht
U’d	Lute
Rabab	Rebec
Guitarra	Guitar
Naqqara	Naker
A-Duf	Adufe
Al-Buq	Albogon
Al-Nafir	Anafil
Al-Shabbaba	Exabeb
Al-Tabl	a Atabal
Al-Tinba	Atambal
Bandair	Panderet
Zulami	eXelami

U munduam të sillnim disa shembuj mbi influencën e shkollarëve myslimanë në kulturën perëndimore, por edhe më gjerë, për të treguar se si arti dhe në rastin konkret muzika, nuk mund të linte gjurmë kaq të rëndësishme në ndërgjegjen artistike të evropianëve, por edhe më gjerë, nëse në themelet e saja nuk do të qëndronte perceptimi i pastër estetik. E parë si mjet për të transmetuar të bukurën shpirtërore dhe e parë gjithmonë në botëvështrimin mysliman, si mundësi që të afron tek Krijuesi i së bukurës, muzika pësoi një hop të madh zhvillimi inovator.

Arkitektura

Arti islam në përgjithësi ngrihet mbi kufizimet e gjuhëve kulturore të rajoneve të ndryshme, çdo kulturë e gjen veten brenda këtij arti, por në të njëjtën kohë asnjëra prej tyre nuk është dominante, ato shkrihen përmes kohëve dhe hapësirave gjeografike, duke krijuar një lidhje unike, një unitet

21. Farmer, Henry, “Historical facts for the Arabian Musical Influence”, New York 1970:155.

artistik brenda ndryshueshmërisë. Lidhja që dominon në konceptin estetik në këtë art është lidhja e së bukurës me të shenjtën, e cila lartësohet përmes vendeve ku njeriu i drejtohet hyjnore. Të njëjtat karakteristika vërehen edhe në arkitekturën islame të cilat si çdo art tjetër brenda këtij lloji janë të destinuara të merren me pafundësinë dhe zbritjen e hyjnore në perceptimin njerëzor përmes formash induktimi të së bukurës që estetishtë udhëton mes vendesh e historish. Stili arkitekturor islam shpërfaqet më së shumti në objektet e kultit, ku edhe mjeshtëria artistike derdhet në forma krejt të veçanta. Edhe në arkitekturë zotëron i njëjti princip i mungesës së kopjimit të qenieve të gjalla përmes skulpturash, apo trupëzimit të figurave të frymorëve në kolonat, apo harkatat e ndërtimeve, ashtu siç rëndom e gjejmë në arkitekturën perëndimore. E gjitha kjo zëvendësohet me gdhendje artistike, duke respektuar gjithmonë abstrakten, të shprehur në formate gjeometrike, apo edhe gdhendje floreale të bimësisë. Në rastin e arkitekturës, ashtu si edhe në artet e tjera, kaligrafia është prezente, por në formatin tashmë të gdhendur në sipërfaqe guri apo graniti. Ajo që e dallon arkitekturën islame është kubeja të cilën e hasim si në ndërtimet e objekteve të kultit, xhamive ashtu edhe në objektet sociale, duke përfshirë edhe hamamet.



Xhamia e Madhe e Kordobës ndërtuar më 787-ën

Prezenca e kubesë në këto ambiente me ndërthurje harkatash, krijon një hapësirë të bollshme për individin gjatë ritualeve të tij, duke imponuar një dimension vertikal, i cili të udhëheq kah qiellorja, deri në pafundësi të perceptimit. Rol të rëndësishëm në arkitekturën islame luan padyshim koloriti që më së shumti zhvillimin e vet e pati në Andaluzi mes shekullit të IX-të dhe X-të. Ky kolorit u përdor në pllakat dekorative të ndërtimeve të shumta, të cilat në formë të përsëritur renditeshin në të gjithë hapësirën e ndërtimit duke formuar një objekt, i cili mund të ishte floreal, apo gjeometrik ose në miniaturë përbënin një ide, e cila shumëfishohej në pafundësi. Element kyç estetik në këtë model arkitekturor përbën drita,

e cila shfaqet në koloritin e qeramikës, që zbukuronte objektet, ose drita në kuptimin natyral të saj, e cila përmes hapësirash të mëdha e kombinuar me fasada të qelqta, ndërhyjnë në ambientet e ritualeve me sfond madhështor. Në shumë raste të ndërtimeve religjioze drita ka shërbyer edhe si matës i kohëve të lutjeve. Përmes lëvizjes në pjesë të ndryshme të objektit, drita natyrale jo vetëm që ndriçon pjesë të caktuara të ndërtesës, por në vende të ndryshme sinjalizon për ardhjen e kohëve të lutjeve.

Ky stil arkitekturor pati ndikim të madh në Perëndim, sidomos përmes periudhës së Spanjës myslimane. Veprat më të spikatura, të cilat edhe sot e kësaj dite përbëjnë shembull arkitekturor, por edhe estetikisht të admirueshme, janë së pari Pallati Nasridi në Granata, i cili u ndërtua në shekullin e XIII-të, me risi të mëdha arkitekturore për kohën në të cilin përdoren suvatë tip stalaktitesh, ose forma gjeometrike, të cilat përthyhen duke iu bashkëngjitur punimeve në pllakë në formë kaligrafish. Po ashtu “Madina Al-Zahra” u ndërtua më herët në shekullin e X-të në Andaluzi, si pallati i parë i ngritur atje me një kompozim të ndërthurur të arkitekturës së jashtme dhe të brendshme, me tarraca të niveleve të ndryshme, me kopshte, shatërvanë e pishina.

Për fat të keq ky pallat sot është i shkatërruar, por megjithatë përbën një destinacion të fortë studimi arkeologjik. E mirënjohura “Alhambra”, sot përbën destinacionin kryesor turistik të Spanjës, e ndërtuar po ashtu me të njëjtën strukturë arkitekturore të ndërthurur mes kopshtesh, tarracash, shatërvanësh, pishinash dhe bimësisë. Kjo tip arkitekture gjeti zbatim edhe në kolonitë e mëvonshme të Spanjës, të cilat shtrihen deri në pjesën Jugperëndimore të SHBA-ve.



Komunikimi përmes objekteve të kultit islam

Msc. Ferit Lika

Abstrakt

Që nga qytetërimet e lashta e deri në ditët tona, objektet e kultit kanë pasur ndikim të ndjeshëm në komunikimin mes njerëzve. Feja ndikon në forcimin e unitetit të anëtareve të shoqërisë nëpërmjet predikimit dhe kontrollit të zbatimit të vlerave dhe normave të njëjta. Sipas sociologut të famshëm francez Emile Durkheim, ceremonitë dhe ritualet fetare të praktikuar kolektivisht ripohojnë dhe rrisin solidaritetin e grupit shoqëror. Por sa dhe si ndikojnë objektet e kultit në komunikimin mes njerëzve? Në raportin e tyre me shoqërinë dhe në raportin e tyre vertikal me Krijuesin? Si mishërohet komunikimi në botëkuptimin islam? Çfarë përfaqëson ai? Sa dhe si u komunikon feja dhe objektet fetare besimtarëve por jo vetëm, do të jenë disa nga pyetjet që do të synohet t'u jepet përgjigje në këtë studim.

Intelektuali mysliman paralel me njohjen thelbësore të Islamit dhe pikëpamjeve botërore për Islamin, së bashku me elementët e ndërthurura qenësore të tij, duhet të dijë se komunikimi dhe fizionomia e Islamit, një pjesë të madhe i dedikohet objekteve të kultit, nga ku është transmetuar e vazhdon të transmetohet mesazhi i tij. Sipas studiuesit të njohur belg Titus Burchkardt, studimi i artit islam (ku futet edhe arkitektura), apo i çfarë do arti tjetër të shenjtë, mund të çojë drejt një kuptimi pak a shumë më të thellë të realiteteve shpirtërore, që qëndrojnë në rrënjë të një bote të tërë njerëzore dhe kozmike.

Hyrje

Në skenën historike bashkë me njeriun ka lindur edhe feja me rregullat dhe normat e saj. Ballafaqimi i njeriut me të shenjtën, prej fillimit të ekzistencës së tij e deri më sot, ka qenë i vazhdueshëm e i përhershëm në çdo epokë. “Megjithëse vlerat fetare mund të kenë qenë të venitura gjatë dy shekujve të fundit anëmbanë botës, njerëzimi sot është përsëri në kërkim të fesë dhe është edhe njëherë i predispozuar për të.”¹ Ata që

menduan se flakën tutje religjionin dhe shprehën ngritjen e shkencës², duke

2. Disa teologë të krishterë, në gjysmën e parë të këtij shekulli, njoftuan gjithashtu ardhjen e një krize të tillë, e cila quhet shekullarizim. Tashmë, në gjysmën e parë të shekullit 19, filozofi dhe sociologu francez Auguste Comte, shpalli ngritjen e shkencës dhe flakjen e religjionit dhe besonte se, sipas logjikës shekullariste të zhvillimit të filozofisë dhe shkencës perëndimore, shoqëria ishte “duke evoluar” dhe “duke u zhvilluar” nga faza primitive në atë moderne dhe pohoi se, marrë në aspektin evolutiv, metafizika është faza kalimtare e teologjisë në shkencë.

Shekullarizmi përkufizohet si dorëheqja e njeriut pikësëpari nga “kontrolli religjioz e pastaj nga ai metafizik, mbi arsyen dhe të shprehurit e tij.

1. Gylen, F., “Për një qytetërim me dashuri dhe tolerancë”, PRIZMI, Tiranë 2005:326..

e cilësuar religionin si primitiv dhe shkencat si moderne, duket se kanë gabuar rëndë. Religjioni dhe përkatësisht Islami vazhdon të mbetet një nga fetë më me ndikim në botë, në shoqëri dhe në familje.

Islami i cili është përfaqëuar nga mbi një miliard e gjysmë njerëz të kohës së sotme, bazohet në besimin në njësinë e Allahut, në nënshtrimin Atij për zemërsisht dhe në nënshtrim ndaj urdhrave Tij. Po të shfletojmë faqet e historisë së jetës së popujve, nuk ndeshemi në asnjë periudhë ku populli të mos ketë qenë i ushqyer me ndjenja fetare. Gjithmonë feja ka paraqitur një interpretim të ndjenjave shpirtërore të popujve, sepse me të është përmbushur nevoja për besim, sido që të ketë qenë ai; i dërguar nga qielli ose i shpikur nga njerëzit.³ Ky realitet na tregon se feja për njeriun është një nevojë natyrore. Ajo a ekzistuar bashkë me njeriun dhe do të vazhdojë të ekzistojë bashkë me të edhe në të ardhmen.⁴

Çdo fe në vetvete ngrihet mbi të komunikuarit. Nëse do të flisnim me termat e Komunikimit Masiv, Mesazhi Hyjnor është ai që ka audiencën më të madhe, pasi i drejtohet njerëzimit në të gjitha kohërat. Komunikimi përmes kultit, i çfarëdolloji qoftë ai, është shumë i hershëm, madje po aq sa edhe vetë njerëzimi. Komunikimi ka lindur që me krijimin e njeriut të parë Ademit (në Islam), i cili komunikoi me

Zotin, më pas edhe të gjithë profetët e tjerë në një formë a një tjetër kanë komunikuar përmes fesë. Ndërtimi i objekteve të kultit, solli deri diku edhe “institucionalizimin” e komunikimit, por pa u shkëputur nga komunikim i drejtpërdrejtë.

KOMUNIKIMI FIZIK

I OBJEKTIT

1. Arkitektura, gjuha dhe kuptimet

“Arkitektura është streha ku fryma e njeriut, shpirti dhe trupi gjejnë strehim dhe ngushëllim.”⁵

Çdo mysliman kthen fytyrën e tij nga Qabeja për të kryer ritualin e adhurimit ndaj Krijuesit dhe çdo xhami në botë është e ndërtuar sipas këtij drejtimi. Qabeja e cila mbulohet me një mbulesë që ndërrohet çdo vit, e qëndisur me germa të arta në një stil unik, dëshmon njëkohshëm aspektin abstrakt dhe atë misterioz të ngrehinës. “Të veshësh një shtëpi, kësodore, do të thotë ta trajtosh atë si një trup të gjallë, apo si një arkë që mbart pushtet shpirtëror...”⁶ Kjo është shtëpia e parë, që u komunikoi dhe i komunikoi miliona e miliardë njerëzve në të gjithë botën mesazhin e Islamit në të gjitha kohërat.

Një objekt i caktuar, gradaçelë, shtëpi, muze, aq më tepër xhami, flet dhe komunikon me vetë ekzistencën e tij fizike. Komunikimi përmes objekteve të kultit në përgjithësi dhe atij Islam në veçanti, shfaqet dhe realizohet në tre forma kryesore. Forma e parë

El-Attas Sejid Muhammed Nakib, Islami dhe shekullarizmi, LOGOS-A, Shkup 2006, f. 27, 28, 42.

3. Kraja, A., A duhet feja a e pengon bashkimin kombëtar, Botimet KMSH, Tiranë 2010:11.

4. Sarëkçëogllu, E., “Historia e feve prej fillimit deri sot”, LOGOS-A, Shkup 2010:27

5. Ibn Abdun, gjykatës andaluzian i shek. të XII-të.

6. Burchkardt, T., Arti i islamit, gjuha dhe kuptimet, f. 2, LOGOS-A, Shkup 2012.

për nga kontakti, është komunikimi, që realizohet përmes arkitekturës së vetë objektit religjioz; forma e dytë realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përfshin pjesën kur një imam/prijës u komunikon një grupi (*xhemati*), një mesazh të caktuar; ndërsa forma e tretë e këtij komunikimi për nga radha, por jo për nga rëndësia, është ajo shpirtërore, vetë lidhja që individi vendos me Krijuesin Suprem, duke qenë brenda këtyre objekteve, por kjo formë komunikimi mund të realizohet edhe në çdo vend dhe në çdo kohë. Për të kuptuar se si komunikojnë objektet e kultit, ne së pari duhet të ndjekim udhën e një diturie ose njohurie shpirtërore, që fillon me ndjesinë e një ndryshimi të brendshëm të padyshuar, që zbulon menjëherë trajtimet paraprake sipër natyrale, të cilën e bëjnë zemrën e njeriut të priret drejt misterit jetik.⁷ Ajo ç'ka e lidh zemrën e njeriut me një objekt fizik kultit, është komunikimi me transcendenten. Në një farë mënyre mund të themi se këto objekte kultit shërbejnë si ura lidhëse mes krijesës dhe Krijuesit.

Gjuha e artit është gjuha më e vjetër e komunikimit në botë. Arkitektura Islame si pjesa më e përhapur dhe më e zhvilluar e artit islam edhe sot e kësaj dite zhvillohet më tej, përmes stileve, dizajnëve dhe veprave të ndryshme arkitekturale. Arkitektura apo objektet e kultit islam përfaqësohen respektivisht nga xhamitë, që janë mjaft të përhapura dhe më të përpunuara e dizajnuara artistikisht. Xhamitë, me format dhe zbukurimet e shumëllojshme dhe arti

islam në tërësi, paraqet në mënyrë unike kuptimin dhe domethënien shpirtërore të këtij objekti religjioz. Arti islam shpreh atë ç'ka emri i tij tregon. Përmes veprave të artit, Islami mishëron dhe përcjell mesazhin e tij, atë ç'ka është në të vërtetë.

Kryeveprat e artit islam si, Xhamia e Kordobës⁸ në Spanjë, ajo e Ibn Tulun në Kajro⁹, ose Medresetë e Samarkandit apo edhe Taxh Mahali në Indi, Kajravanit në Tunizi ose më në lindje ato të Stambollit e Isfahanit, përfaqësojnë drejtpërsëdrejti, jo vetëm shpirtin e shpalljes islame, por vetë thelbin e atij shpirti dhe në njëfarë kuptimi sigurojnë përgjigjen më të drejtpërdrejtë e të dallueshme ndaj pyetjes, “Çfarë është Islami?” Ato përçojnë madhështinë që mbart në vetvete religjioni, dhe dëshmojnë se nga mesi i dytë i shekullit të dytë të hixhretit¹⁰, arti Islam kishte formuar gjuhën e tij. Arti Islam e shndërroi materialin që huazoi nga qytetërimet e ndryshme në dritën e shpalljes Kur'anore, duke ndërtuar forma shumë të dallueshme artistike, të cilat mund të shihen në viset që shtrihen nga Lindja në Perëndim.

Arti islam siç e paraqet edhe Titus Burchkardt në librin e tij “Arti Islam, gjuha dhe kuptimet”, është një rrjedhim i drejtpërdrejtë i parimeve dhe formës së zbulesës islame dhe jo si rritje historike të shkrira bashkë aksidentalisht, siç na e paraqesin disa historianë arti. Parimet Islame si, Uniteti, Paqja, Njëshmëria, përbëjnë thelbin e këtij arti. Fjala e Shenjtë (Kur'ani) dhe thëniet Profetike,

8. Themeluar më 785.

9. Ndërtuar në vitin 879.

10. Shekulli i dytë i hixhretit: 722-822.

7. Vokopola, F., Thellësirat e fantazisë, parathënie, ribotim 2009.

janë lëvruar në format nga më të larmishme dhe më mahnitëse të artit Islam. Një art i tillë edhe pse abstrakt, në thelb shpreh dukshëm dhe komunikon madhështinë e të Vërtetës Absolute. “Uniteti, mbi të cilin qendërzohet Islami nuk është i shprehshëm në kuptimin e ndonjë imazhi”¹¹, por vazhdimësia e tij na vjen përmes abstraksionit, si mëshirim i asaj se e Mbinatyrshtja nuk mund të përfytyrohet. Ai thekson brishtësinë e botës, përhershmërinë dhe çfarë shtrihet përtej saj. Veprat arkitekturore islame në harmoninë, qartësinë, kthjelltesinë dhe paqen e tyre, kristalizojnë disa prej aspekteve më të rëndësishme të mesazhit islam.

Perspektiva islame e të ndërtuarit mbështetet mbi përmasën e bukurisë në jetë dhe e lidh bukurinë e mirësinë, me vetë natyrën e Krijuesit. Interesi i Islamit për të bukurën pasqyrohet më së miri në theksimin e sjelljes së hijshme dhe pastërtisë në jetën fetare e të përditshme, si dhe urdhëresat e drejtpërdrejta në Librin e Shenjtë (*Kur'anin*) për ta çmuar bukurinë e krijimit dhe të gjitha objekteve të krijuara prej Zotit. Çdonjëri prej grupeve të mëdha etnike të botës islame ka krijuar një art që është dallueshmërisht i tij, si ai persian, turk, egjiptian, afrikano-verior, andaluzian, indomusliman, indonezian, malajzian, etj., por përgjatë të gjitha këtyre traditave të larmishme e të pasura artistike pasqyrohet uniteti i Islamit.

Arkitektura islame për gjatë gjithë historisë dhe kohërave, ka evoluuar duke shkuar drejt perfeksionimit dhe paraqitjes së veprave madhështore dhe

magjepsëse. Mjeshtëria e ndërtimit islam është e famshme për planet e saj, kupolat, minaret, kaligrafinë dhe elemente të tjera të dizajnit të një ndërtese. Ndoshta gjuha e këtij arti njihet shumë pak në krahasim me madhështinë dhe universalitetin e gjithëpërfshirës të tij. “Arkitektura Islame lehtëson, nxit dhe stimulon “ibadetin” (adhurimin), aktivitetet e myslimanëve në çdo moment të jetës së tyre tokësore. Arkitektura Islame vjen në ekzistencë nën patronazhin e perceptimeve islame; të Zotit, njeriut, natyrës, jetës, vdekjes dhe Ahiretut (bota e përtejme). Në këtë mënyrë, kjo arkitekturë është një materializim fizik i mesazhit Islam. Ajo gjithashtu përfaqëson identitetin e kulturës dhe civilizimit Islam.”¹²

Arkitektura apo arti islam në tërësi njihet për karakterin e tij abstragues. Ky proces i ashtuquajtur “abstragim”, “në artin islam nuk është një proces tërësisht njerëzor dhe racionalist, siç ndodh me artin abstrakt modern, por fryt i arsytimit në kuptimin e tij burimor, apo përfytyrim i botës shpirtërore; dhe një fisnikërim i lëndës, duke u mbështetur te parimet që burojnë nga nivelet më të larta të Realitetit Kozmik e përfundimisht Metakozmik.”¹³ Sipas Burchkardt, arti islam është pikërisht kristalizimi tokësor i shpirtit të shpalljes islame, si dhe një pasqyrim i realiteteve qiellore në tokë; pasqyrim me ndihmën e të cilit myslimani realizon udhëtimin

11. Burchkardt, T., *Arti i Shenjtë në Lindje e Perëndim*, kapitulli IV – Themelet e Artit Islam.

12. Williams, H. & D., *Arti Islam*, urë mirëkuptimi (www.dritaislame.al/arti-Islam-urë-mirëkuptimi/)

13. Hossein N., *parathënie, Arti i islamit, gjuha dhe kuptimet*, Titus Burchkardt.

e tij përmes mjedisit të përtokshëm dhe përtej Vetë Pranisë Hyjnore, drejt Realitetit që është Zanafilla dhe Fundi i këtij arti.

Arti oriental me motive islame në tërësi dhe arkitektura në veçanti, ka patur dhe ka një zhvillim të madh brenda saj dhe një ndikim të pakontestueshëm edhe në botën perëndimore. “Kudo në Perëndim shquhet ndikimi i artit islam. Arkitektura islame është imituar shumë në Evropë, në këtë fillimshkull.¹⁴ Mund të thuhet se përmes gjuhës së arkitekturës, Islami po komunikon sot, me perëndimin. Duke qenë se ky art ka privilegjin e të qenurit gjithnjë në përputhje me shpirtin e Islamit, veprat e tij janë gjithmonë të arrira sa nga këndvështrimi estetik aq edhe nga qëllimi i tyre shpirtëror; duke mos shfaqur asnjë mungesë harmonie. Funkzioni i këtij arti në substancën e të cilit është e bukura, që në termat islamë është një cilësi hyjnore, mund të shihet në dy këndvështrime. “*në botë është pamja, është veshja që mbështjell qenien e bukur dhe gjërat e bukura; te Zoti, sakaq, po në vetvete, ajo është bukuri kullueshmërisht e brendshme; është cilësia hyjnore, që mes të gjitha cilësive hyjnore të manifestuara në botë, risjell ndër mend më drejtpërdrejt Qenien e kulluar.*¹⁵ Arti i islam, veçanërisht arkitektura e çuar në kufijtë më të skajshëm të lëvrimin prej mjeshtrave myslimanë në katër anët e botës, ka zënë një vend të veçantë në interpretimit të mesazhit hyjnor dhe ka mrekulluar pafund botën duke u bërë një joshje për shijuesit e së bukurës dhe më gjerë.

14. Williams, H.& D.

15. Burchkardt, T., Arti i islamit, gjuha dhe kuptimet, f. 5 LOGOS-A, Shkup 2012.

Arkitekti islam, nuk i trembet monotonisë. Ai ndërton shtyllë mbi shtyllë dhe harkor mbi harkor dhe rreh të mbysë përsëritjen përmes alternimit ritmik, të përsosjes cilësore të çdo elementi.¹⁶

Tri xhamitë e shenja, (Qabja në Mekë, Xhamia e Profetit në Medine dhe Al Aksa në Jeruzalem)¹⁷, janë simboli i dhe madhësisë së fesë Islame. Ato kanë një rol të madh në komunikimin e mesazhit Islam, pasi ato janë pjesë e ngjarjeve të mëdha. Qabja, pikëfillesa e gjithçkaje, është shtëpia e shenjtë e Zotit, që ndodhet në mes të Xhamisë së Shenjtë të qytetit Mekës, në Arabinë Saudite. Ajo është vend i shenjtë në fenë Islame, e cila shërben si pikë orientimi, është drejtimi, që myslimanët marrin kur i kryejnë ritin e faljes (*Kibla*). Kubi i zi në formë kutie është mjaft i njohur për njerëzit e të gjitha besimeve, ajo është shtëpia e parë mbi tokë dhe ndër vendet që vizitohet më shumë në botë; *Al-Masjid al-nabawi*, shpesh e quajtur Xhamia e Profetit, është një xhami e ndërtuar nga Profeti Muhamed dhe ndodhet në qytetin e Medinës. Ajo është vendi i dytë i shenjtë në Islam (duke qenë i pari Masxhidi Haram në Mekë). Ajo është xhamia e dytë e ndërtuar në historinë e Islamit dhe tani është një nga xhamitë më të mëdha në botë, pas zgjerimeve të vazhdueshme. Xhamia ka shërbyer edhe si një qendër e komunitetit, një gjykatë dhe një shkollë. Xhamia është e vendosur në qendër të Medinës dhe është një vend i madh

16. Po aty, f. 50.

17. Profeti Muhamed thotë: “Nuk bën të ndërmerren udhëtime për qëllim adhurimi veçse drejt tre xhamive: Qabeja, xhamia ime dhe xhamia Aksa në Kuds».

pelegrinazhi dhe shumë njerëz të cilët kryejnë Haxhin shkojnë në Medine, para ose pas Haxhit, për të vizituar xhaminë e Profetit, e cila qëndron e hapur 24 orë për 365 ditë; Al Aksa, është xhamia në qytetin me mur të vjetër të Jeruzalemit, e ndërtuar në vitin 715 nga halifi Velid në pozitën e vendit ku Profeti sipas traditës nisi ngjitjen e tij nëpër Qiej në natën e Ngjitjes (*Lejlet ul-Miraxh*). Myslimanët besojnë se Muhamedi është transportuar nga Xhamia e Shenjtë në Mekë për Al-Aksa gjatë udhëtimit natën. Xhamia Al Aksa është një oaz i paqes dhe qetësisë brenda një qyteti të rrethuar me mure.

Arkitektura e shenjtë e Islamit nuk pasqyron matjen e kohës, duke qenë e orientuar për nga një qendër tokësore. Hapësira, të cilës i komunikon përvojën, është si e rikredhur në gjithëpraninë e çastit aktual; ajo nuk e shënjon syrin në një drejtim të përveçëm; ajo nuk nxit tension apo antonomi ndërmjet të këtushmes dhe të përjetshmes, apo ndërmjet tokës dhe qiellit; ajo gëzon gjithëplotshmërinë e saj në çdo vend. Kjo është veçanërisht e dukshme në të ashtuquajturat xhami “kolonore”, të cilat ndërtohen në modelin e xhamisë së parë në Medine.

Qëllimi i njëmendtë i arkitekturës islame është hapësira si e tillë, në plotshmërinë e saj pa dallim. Vargu madhështor i harqeve, të cilët nuk janë thjeshtë gjysmë rrathë që lartohen butësisht në formën e patkoit është i mjaftueshëm për të shpalosur këtë cilësi. Nuk është rastësi që emri arab *ra'uk* për trarët harkorë është bërë sinonim i së bukurës, të hirshmes dhe të dëlirës. Është botërisht e ditur se arkitektura

islame zhvilloi një larmishmëri formash të harkut, të cilat ishin të dukshme në arkitekturën umejade dhe dy syresh janë më tipikët: *harku gjurmëkali*, shprehja më e përsosur e cilit gjendet në artin magribi dhe *harku i “përmbysur”*, i cili tipizon atë persian. Secili kombinon dy cilësitë e prehjes statike dhe ndriçimin rritës. Harku persian është sa fisnik dhe i hirshëm. Ai ngrihet mjaft lehtë si flaka e patrazuar e një llambe vaji e mbrojtur nga era. Harku magribi, nga ana tjetër dallohet nga gjerësia e hapësirës së tij, që shpesh kufizohet në një konstrukt drejtkëndor, për të prodhuar një sintezë të qëndrueshmërisë dhe begatisë. Në vijimësi, Islami që në gjendje të mbajë një balancë perfekte midis bukurisë (që në vetvete është pasuri) dhe thjeshtësisë.¹⁸

Xhamia është simbol i besimit Islam, besimi në Zotin dhe besimi në Githëpushtetshmërinë e Tij. Kjo hapësirë e shenjtë është një pasqyrim i besimit të thellë në fjalën hyjnore. Ajo është gjithashtu vendi i realizimit të lutjes dhe të të gjitha riteve dhe ritualeve të Islamit. Këtyre elementeve simbolike i shtohen komponentët e hapësirës së shenjtë të xhamisë: minaret, salla e lutjes me mihrabin e saj dhe minberi. Këto objekte, pjesë të xhamisë mbështesin shenjtërinë e saj. Secili prej këtyre elementeve ka funksionin e vet të “shenjtë”. Salla e lutjeve është vendi i devotshmërisë dhe përkushtimit. Minareja dhe minberi përfaqësojnë lartësinë drejt qiellit për thirrjen për lutje ose për «predikim» ritual apo hutbe.¹⁹

18. Po aty, f. 20, 21.

19. With in the mosque, the pulpit maybe considered as an extension of the minaret..., both in virtue of it selevation and because

Mihràbi

Mihràbi është qoshku i faljes, vendi ku qëndron imami për të udhëhequr faljet e përbashkëta. Forma e tij e plotë me kupolën, që përkon me qiellin dhe shtratin me tokën, e bën qoshkun një imazh të përhershëm të “shpellës së botës”. Në kuptimin simbolik shpella e botës është “vendi i shfaqjes” së Hyjnitetit, shpella e shenjtë e zemrës. Mihrabet ndryshojnë në madhësi, dhe në dizejnim. Zakonisht janë dekoruar sipas stilit oriental, duke dhënë përshtypjen e një dere ose harku, ose një pasazhi nga Meka. Elementi më i rëndësishëm në çdo xhami është Mihrabi, i ngrohtë dhe për shkak se ajo funksionon si pikë drejtimi në ritualit të lutjes, dekorimi i saj kërkon një aftësi të madhe dhe përkushtim. Ato përmbajnë mbishkrime në kaligrafi të ndryshme, pllaka me arabeska e forma abstrakte geometrike, sure nga Kur’ani, si dhe thënie të profetit Mumamed a.s. (*hadithe*).²⁰

Minberi, llojet dhe komunikimi

Pjesë e pandashme arkitekturore e një xhamie është edhe minberi. Në fjalorin e arkitekturës islame minberi përkufizohet si një platformë e ngritur në zonën e përparme të një xhamie, nga

it is the domain of truth. ”Lings, Martin, *Symbol and Archetype: A Study of the Meaning of Existence*, Quinta Essentia, 1991, p.123-124. (translator’s addition).

20. Një ndër mihrabet e famshëm për zbukurimet e tij kaligrafike është edhe mihrabi i xhamisë së medreseve në Isfahan, themeluar në vitin 755 pas erës sonë. Web: <http://www.metmuseum.org/toah/works-of-art/39.20>

e cila janë dhënë dhe jepen predikimet apo fjalimet. Minber është gjithashtu një simbol i autoritetit.²¹ Minberi ndihmon në plotësimin e zërit të folësit për t’u dëgjuar zëri tek ata që janë mbledhur aty. Rëndësia e tyre rritet për vetë qëllimin e lartë për të cilin janë ndërtuar, ashtu edhe për misionin e madh për të cilin shërbejnë, sepse në të gjitha minberet përhapet thirrja për në Islam e për udhëzimin në rrugën e Allahut.

Në shekuj, myslimanët kanë përpunuar artin e ndërtimit të minbereve dhe kanë përsosur mjeshtërinë e zbukurimit të tyre, deri në atë shkallë sa ndërtimi i minbereve është bërë njëra nga fushat ku artistët myslimanë kanë demonstruar aftësitë e tyre artistike. Në fillimet e Islamit, minberet kanë qenë tepër të thjeshtë, por shumë shpejt në qytetet kryesore filloi epoka e ndërtimeve të xhamive me përmasa të mëdha, të cilat falë vlerave artistike të papërsëritshme, mahnitën dhe vazhdojnë të mahisin studiues të ndryshëm të arkitekturës islame.²²

Minberet nuk mbetën vetëm podiume predikimi, por shumë shpejt misioni i tyre fillestar u shtri më gjerë; ato simbolizonin integritetin dhe udhëheqjen islame dhe tregues të mirëqenies e të shijes së hollë artistike, u bënë objekte shumë të përshtatshme nga ku dijetarët shprehnin objektivat e qarta të thirrjes, të mendimit dhe të

21. Andrew Petersen, *Dictionary of Islamic architecture*, Routledge, 1996, (Fjalor i arkitekturës islame), f. 191.

22. Shih, Stafa, S., Minberi në rrugëtimin historik të xhamive, gazeta Drita Islame, (<http://www.dritaislame.al/minberi-ne-rrugetimin-historik-xhamive/>) Aksesuar, 8 Maj 2013

jetës.²³ Ndërsa shekujt kalonin u shtua përkujdesi i njerëzve për të ndërtuar dhe zbukuruar minberet me ornamente të ndryshme. Mjeshtrit e ndërtimit të tyre përzgjidhnin drurët dekorative, të fortë dhe të qëndrueshëm dhe filluan të gdhendin në të mozaikë me motive bimore dhe shtylla dekorative, gjithashtu filluan të gdhendin edhe ajete nga Kur'ani, hadithe të Profetit, arabeska, basorelieve, etj. Minberi i ndërtuar me material druri është quajtur zotëria i minbereve të xhamive. Minberet më të famshme janë: minberi i Xhamisë së Kordovës (Spanjë), minberi i xhamisë Al Aksa (Jeruzalem) dhe minberi i xhamisë Sulltan Ahmet (Turqi, Stamboll). Këta objekte artistike konsiderohen të tillë për shkak të zbuçurimeve të rralla me të cilat janë dekoruar, ose edhe për vjetërsinë e kohës së ndërtimit, si dhe për formën e bukur apo edhe për vlerën e rrallë të drurit e të metalit me të cilët janë ndërtuar.

Minberet flasin me forcën e artit të ndërtuesit, shprehin ndjenjat më të larta të artistit ndërtues dhe nxjerr në dukje respektin e tij të thellë për pozitën e veçantë që merr minberi në xhami, veçanërisht në ditën e xhuma (premtë).

Komunikimi përmes minareve

*“Minaret, si pemët, kanë shpirta.”*²⁴ Minarja lartësohet ashtu e hollë dhe e gjatë për të treguar madhështinë apo ngjitjen drejt qiellit drejt mëshirës së Zotit. Minaret janë përshkruar si «porta mes qiellit dhe tokës», dhe si përngjasim i shkronjës arabe Elif (ا), e cila është

një vijë e drejtë vertikale. Minarja është një pjesë e arkitekturës së xhamive, aty komunikohet më besimtarët dhe u kujtohet se ka ardhur koha e lutjes. Aty u komunikohet se njeriu, pavarësisht të gjithave ka nevojë për t'iu lutur Krijuesit të tij. Gjithashtu gjuha me të cilën këndohet, tërheq vëmendjen dhe bëhet e pëlqyeshme pasi ritmi dhe melodia e arabishtes është impresionuese.

Minarja u komunikon gjithsecilit që e sheh, ajo bëhet një mjet identifikimi dhe orientimi për njerëzit. Në qytetet myslimane njerëzit shpesh mbledheshin rreth xhamive për të diskutuar çështje që i shqetësonin, apo për të ndarë gëzimet mes tyre. Në momentin që lihej takimi minarja ishte t'ipari dallues. Udhëtarët shpesh herë e gjejnë veten duke përdorur minaret si monumente orientuese, pasi ata ngihen mbi çdo gjë përreth tyre. Shumë xhami kanë më shumë se një minare dhe janë të zbuçuruara, të pikturuara, e të gdhendura duke i bërë ata vepra arti të jashtëzakonshme.

Roli shpirtëror i Xhamive

Xhamitë janë vende ku përmendet Zoti në mënyrë të vazhdueshme. Vend në të cilin besimtari vendoset përballë mëshirës së Krijuesit. Xhamia e lidh besimtarin me botën tjetër, mes fizikes dhe shpirtërores, një dritë që të udhëheq drejt botës së amshuar. Besimtari lidhjen me Krijuesin e tij mund ta vendosë kurdo në çdo kohë dhe në çdo vend, por xhamia “shtëpia e Zotit” (*beitull-llah* arabisht), është ajo e cila të çon drejt *miraxhit*,²⁵ drejt Zotit. Në këtë botë të rrëmujshme xhamia është si një oaz paqe

23. Po aty.

24. Nizar Qabbani, diplomat, poet, publicist sirian.

25. Miraxh është quajtur udhëtimi (ngjitja) e profetit Muhamed drejt Zotit.

e qetësie, e cila e zhyt besimtarin në një atmosferë devotshmërie, përkujtimi e lutjeje. Zbukurimet kaligrafike, motivet floreale, janë një mjet i jashtëzakonshëm për t'i larguar njeriut stresin e për ta çuar atë drejt qetësisë shpirtërore.

Roli social dhe shoqëror i fesë dhe objektit (Xhamisë)

Roli i fesë dhe i objekteve të kultit në shoqëri, i përket një rëndësie të madhe dhe shumë të domosdoshme. Xhamia ka qenë gjithnjë vatër uniteti e shoqërisë islame. Aty takohen njerëzit, bisedojnë, vëllazërohen, këshillohen njëri me tjetrin e marrin këshilla, për sjellje të veçanta sociale, fetare e kulturore, aty dëgjojnë ligjëratat të ndryshme, etj. Nëpër xhami ekzistojnë klasa ku zhvillohen mësim-besimi dhe kurse të ndryshme. Aty predikohet, feja, paqja, harmonia mes njerëzve, atdhetarizmi dhe gjithçka në dobi të individit dhe shoqërisë. Sociologët e studiuesit e ndryshëm, pohojnë se feja është një rregullator social mirëfilli shumë më efektiv edhe se sa ligjet në fuqi. Ata vënë në dukje se sot kemi një dobësim të madh të humanizmit, zbehje të dukshme të solidaritetit, dobësim të komunitarizmit, prishje të lidhjeve, që kemi pasur dikur, të miqësisë, të fqinjësisë dhe se asnjëherë nuk mund të mohohet roli i shëndoshë i fesë në shoqëri, sidomos tek besimtarët e saj ata paraqesin argumente të cilat i japin përparësi fesë, institucioneve fetare dhe objekteve të kultit në rregullimin e jetës së individit. Besimtari mysliman është i interesuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e harmonisë midis anës shpirtërore dhe anës së jashtme të jetës shoqërore, për

të realizuar një jetë të qetë në shoqëri e më gjerë.²⁶

Arti Islam dhe komunikimi

Në artin dhe arkitekturën islame, artisti mysliman për të shprehur “unitetin e ekzistencës”, apo “unitetin e të vërtetës”, ka në dispozicion tre mjete: *gjeometrinë*, e cila e përkthen unitetin në rendin hapësinor; *ritmin*, i cili e zbulon atë në rendin kohor dhe në hapësirë; dhe *dritën*, e cila është për formimet dukshme çfarë Qenia është. “Zoti është drita e qiejve dhe tokës” (24:35).²⁷

Kaligrafia

“Nëse lëvizjet do të paraqiteshin nëpërmjet shkronjave, dhe nëse shkronjat do t'i konformoheshin lëvizjeve, format e kaligrafisë do të tentojnë kurdoherë përsosjen kulmore.”²⁸

Fakti që Zoti e ka mësuar njeriun të shkruajë me laps ka bërë që në botën islame, lapsit dhe shkrimin t'i kushtohet rëndësi e jashtëzakonshme.²⁹ Kështu, shkrimi si një vegël e fortë e shprehjes nuk mbetet vetëm në libra, por del nëpër veprat monumentale, duke përplotësuar arkitekturën. Ndër funksionet kryesore të shkrimin është paraqitja e verseteve kur'anore, e

26. Balla, Xhemal, Shqiptari dhe myslimani në kontekstin evropian të mijëvjeçarit të ri, web: <http://www.dritaislame.al/shqiptari-dhe-muslimani-ne-kontekstin-evropian-te-mijevjecarit-te-ri/>

27. 24:35, Kur'an, En Nur, “Allahu është Drita e Qiejve dhe Tokës. Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje, në të cilën ndodhet një llambë. Llamba është një kristal, kurse kristali është si një yll i shndritshëm...”.

28. Ebu Hajan el-Teuhidi.

29. “I Cili me anë të penës, ia mësoi njeriut ato që nuk dinte”, Kur'an, El – Alak, 96:4-5.

haditheve dhe fjalive të ngjashme kuptimplota.³⁰ Kaligrafia Islame është arti i shkrimit, i të shkruarit arabisht dhe konsiderohet si arti më i kulluar sa i përket botës islame. Përmes saj, *Fjalës së Shpallur* - Kur'anit, i jepet një formë e dukshme. Ajo është jashtëzakonisht e pasur me forma dhe stile, e cila ndërthur rreptësinë më të skajshme gjeometrike me ritmin melodioz. Dihet botërisht se arti islam është projektim i aspekteve, apo dimensioneve të caktuara të Unitetit Hyjnor. Stilizimi i germave arabe është një lloji abstrakt, pa asnjë rrënjë figurative.

Natyra e shenjtë e Kur'anit, si Fjalë e Zotit dhe prova e Njesisë së Tij (*Teuhidit*), dhanë nxitjen fillestare të shpërthimit të madh krijues të artit dhe kaligrafisë, zanafilla e të cilave shfaqet që në shekullin e shtatë. Në Islam ikonat zëvendësohen nga shkrimi i shenjtë, që është si të thuash, mëshirimi i dukshëm i Fjalës Hyjnore. Kur'ani dhe gjuha e tij e gjithëpranishme në objektet e kultit islam, me dinamizmin e tij, depërton në zemrat e njerëzve, duke lënë gjurmë në ndjenjat e tyre, estetikën dhe artin islam. Komunikimi përmes kaligrafisë është gati hipnotizues për njeriun, pasi Kur'ani për besimtarin është qetësues; një rrezatim i Diellit Hyjnor mbi shkretëtirën njerëzore. Harmonia dhe proporcionet e germave të shkrimit arab, në fakt bazohen mbi parime gjeometrike të qarta të përfutuara nga një rrjetë vijëzimi e përpiktë, duke theksuar edhe një herë harmoninë e mahnitshme që bashkon artin, shkencën dhe fenë Islame.³¹

30. Ajvazoglu, B., Estetika Islame, fq. 72, LOGOS-A, Shkup 2009.

31. Williams, H. & D. Arti Islam, urë mirëkuptimi,

*“Ndryshe nga shkrimet e tjera, shkrimi arabisht nis nga e djathta (që është krabu i veprimt) dhe zhvendoset drejt së majtës (që është hapësira e zemrës). Në këtë formë ai përshkruan një përparim nga e jashtëmja tek e brendshmja.”*³² Kështu edhe ky art i përshfaqet njeriut nga jashtë dhe depërton në thellësi të shpirtit të tij. Arti Islam është shprehje e Kur'anit, në ngjyra, rreshta, lëvizje, formë dhe tinguj, në tre nivele. Niveli i parë përkufizon *“Teuhidin”*³³, në të shprehurit e fjalës Allah në forma dhe skripte të ndryshme në gjuhën arabe. Përsëritja në skicë e fjalës Allah është e ngjashme për nga funksioni me *“dbikrin”*³⁴. Më tej është shprehur me *“Bismilab”* (me emrin e Allahut) dhe *“La illabe il-la Allah”* (nuk ka Zot tjetër veç Allahut). Shprehjet estetike të Teuhidit janë; abstragimi, struktura modulare, kombinimi i njëpasnjëshëm, përsëritja, dinamizmi dhe kompleksiteti, të gjitha këto të shprehura në gjeometrinë e shpirtit. Kur'ani gjithashtu pajisi civilizimin Islam me një ideologji, që të shprehet në art, të jetë manifestuar nga zbukurimi i pjatave, tapeteve, shpatave, qeramikës, orendive, mihrabeve, minareve dhe xhamive. Dekorimi i çdo gjëje me vargje Kur'anore shërben si një mënyrë për t'iu rikujtuar qenieve rreth Krijuesit dhe *“Al-Mussavirit”* (Stiluesit) të vërtetë. Kaligrafia arabe ka një larmishmëri formash, ku secila përbën një art më vete. Stili *kufi* (këndor), *nas'hi* (të rrumbullakëta), *andalusi*, *maghribi*, *talik*, *divani*, *thuluth*, *rika*, *nastalilik*, madje edhe

(<http://www.dritaislame.al/arti-islam-ure-mirekuptimi/>)

32. Burchkardt, fq. 52, Kaligrafia arabe.

33. Njësimi i Allahut.

34. Përmendja e Allahut në të folur (FL.).

sini (në Kinë), të gjithë në mënyrën e tyre shprehin bukurinë e fjalëve të Zotit.

Arabeska

*Arsyeja islame, e cila kërkon njëshmërinë pas të gjitha dukejeve, sekretin e pikës vazhdimisht të lëvizshme, që si dibet as fillimi e as mbarimi, e ka gjetur te format që janë interpretim i idesë së përjetësisë, te arabeska.*³⁵

Arabeska nënkupton zbukurimin në forma bimore të stilizuara në figura gjeometrike të gërshetuara. Lloji i parë forma bimore është gjithë ritëm, apo zbardhje pamore e përsosur e ritmit, e dyta (gjeometria) është kristalor në natyrë. Këtu ne zbulojmë dy polet e të gjithë shprehjes artistike në islam; sensi i ritmit dhe shpirti i gjeometrisë. Arabeska në forma bimore duket se buron nga imazhi i hardhisë, tek të cilat gjethet e mbështjella të gërshetuara dhe të degëve të gjarpëruara rreth vetes i falen mjaft natyrshëm formave të dallgëzuara dhe spirale. Arabeska ndërthur shumë forma të larmishme bimore.³⁶ Arabeska vazhdon të lëvizë drejt pafundësisë. Ajo duke u kthyer prapa, duke u përsëritur dhe duke sulmuar, e rrënjos ndjenjën e përhershmerisë; vizaton komponime tërheqëse dhe shpreh idenë, qëllimi i së cilës është kënaqësia dhe rendi ritmik i makrokozmosit.³⁷

Në dekorimin arkitekturor dhe madje në artin e librave, kaligrafia shkrihet shpesh herë me arabeskën. Ndërthurja e shkrimit me bimësinë e stilizuar risjell analogjinë, që ekziston ndërmjet “Librit të Botës” dhe “Pemës së Botës”, dy simbole të shumënjohura në përshtetshmërinë myslimane.

35. Ajvazoglu, B.

36. Burchkardt, T., fq. 62.

37. Ajvazoglu, B., fq. 70.

E para buron nga Kur’ani, ndërsa e dyta është e përhapur nga tradita të ndryshme aziatike. Universi është një libër i shfaqur dhe një pemë, gjethet dhe degët e së cilës hapen nga i njëjti trung. Germat e librit të shfaqur u ngjasojnë gjetheve të pemës, dhe ashtu siç janë të lidhura gjethet me degët dhe degët me trungun, kështu edhe germat janë të lidhura me fjalët dhe fjalët me fjalitë, që përfundimisht lidhen me tërësinë dhe plotshmërinë e të vërtetës së librit.³⁸ Stili i saj abstrakt, ngritur nga një seri kthesash të ndërkëmbyera është padyshim dukshëm më i lashtë se forma e tij relativisht natyraliste. Ai është gjithmonë një shfaqje e ritmeve kozmike me faza të ndërthurura dhe përplotësuese të rritjes dhe ndërlikimit e zgjerimit dhe tkurrjes³⁹ Gërshetimi gjeometrik, padyshim që përfaqëson formën më të kënaqshme intelektuale, ngase është një shprehje e idesë së unitetit Hyjnor, që qëndron në themel të shumëllojshmërisë së pafund të botës.⁴⁰ Lëndët e stilizimit zgjidhen prej stinës së pranverës, kohë kjo kur bukuria hyjnore shfaqet në pamjen më të shkëlqyer.

Alkimia e Dritës

Nuk ka simbol të unitetit Hyjnor më të përkryer se drita. Artisti mysliman shndërron sipërfaqe të caktuara në relieve të vrimëzuara për të thithur dritën (xhamat). Drita e parë drejtpërdrejt është verbuese; vetëm përmes harmonisë së ngjyrave ne shquajmë natyrën e saj të vërtetë, që bart në vetvete çdo dukuri pamore. Pothuajse në çdo xhami përveç

38. Burchkardt, fq. 57.

39. Po aty, fq. 63.

40. Po aty, fq. 73.

dritareve të zakonshme, ekzistojnë disa xhama shumëngjyrësh, ku nga reflektimi i diellit, ravijëzohen thyetje të ngjyrave të ndryshme të ndezura plotë jetë e gjallëri. Vend kryesor për këtë zë Alhambra në Granada të Spanjë. Domethëniet simbolike të ngjyrave gërshetohen në një masë të konsiderueshme me besimet fetare. Teologët e krishterë i kanë interpretuar ngjyrat si shfaqje të hyjnore. Edhe ndër besimtarët islamë drita ka pak a shumë të njëjtin interpretim simbolik. “Ndër myslimanët ngjyrat me shkëlqim të veçantë, të jashtëzakonshëm, simbolizojnë mrekullitë hyjnore të engjëjve, të Allahut, por nuk identifikohen me Allahun.”⁴¹

E bardha konsiderohet ndër ngjyrat më të mira. Një ngjyrë e tillë pasqyron pastërtinë fizike dhe sidomos atë shpirtërore. Ndër të krishterë e myslimanë e bardha simbolizon, pastërtinë dhe jetën shpirtërore.⁴² Ndër myslimanët ngjyra e artë ose e verdha (ngjyra e floririt), simbolizon pasurinë, suksesin, ngadhënjimin, lavdinë. Ndërsa ngjyrën e gjelbër besimtarët myslimanë e kanë nderuar që nga koha e profetit Muhamed (a.s.), deri në ditët tona, si një ngjyrë që simbolizon fuqinë jetësore, gjelbërimin jetësor të oazit në shkretëtirë.⁴³ Ngjyra e kuqe konsiderohet e veçantë. Për myslimanët trëndafilat me ngjyrë të kuqe shihen si lule, që nxisin dhe simbolizojnë dashurinë.⁴⁴ Përgjithësisht ngjyrat e qarta të shndritshme, shprehin simbolikisht në të shumtën e rasteve kuptime pozitive, modele sjelljesh të formatuara sipas virtyteve morale, etj.

41. Dervishi, Z., Lente të ndërveprimit simbolik, f. 175, EMAL, Tiranë 2008.

42. Bazyuma, B., 2006, 248, 246.

43. Dervishi, Z., fq. 177.

44. Bazyuma, B., 2006:284, 287.

Roli dhe kuptimi i artit islam

Arti islam, i cili ka ndjekur një rrugë zhvillimore prej konkretes drejt abstraktes, duke ia përshtatur pikturën parimeve të veta, arriti të gjenerojë një formë krejtësisht të veçantë të shprehjes, atë të të shkruarit.⁴⁵ Artisti mysliman nuk e drejton shikimin nga bota e jashtme, por nga ajo e brendshme. Teoria e Njësisë ka ndikuar fort te artisti mysliman, që të mos merret me natyrën e jashtme të së vërtetës, por të merret me thelbin dhe fytyrën e brendshme të gjërave, çka shpjegon natyrën abstrakte të këtij arti. Arti i tregon botës ndjesore të njeriut synimin më të lartë të shpirtit dhe depërton në bukuritë e brendshme. Pra, arti është një tablo që i përshkruan njeriut thellësinë e botës së brendshme. Kjo botë madhështore, me faltoret e saj të ngritura, me minaret si gishta dëshmie, që tregojnë botën e përtëjme, dhe me motivet e dizajnet e bekuara në ballë të mermerëve, që konsiderohet secila prej tyre, si një mesazh më vete, me artin e shumëllojshëm të shkrimit është shndërruar në një galeri bukurish, që nuk ngopesh së pari, rrjedhojë kjo e shoqërimit të besimit nga arti.⁴⁶

“Islami kërkon që njerëzit të zbulojnë kreativitetin e tyre”, shpjegon artisti libian Ali Omar Ermes. Në të vërtetë, Islami vë theksin mbi inteligjencën dhe fantazinë e njeriut, si dhuntitë të një natyre të krijimit hyjnor, që edhe ato

45. Ajvazoglu, B., Estetika Islame, f. 45, LOGOS-A, Shkup 2009.

46. Revistë: Arti dhe Kaligrafia e gjuhës arabe, “URA”, nr. 1/1, Vjeshtë-Dimër, Tiranë 2008; Drita Islame, (<http://www.dritaislame.al/arti-dhe-kaligrafia-e-gjuhes-arabe/>), Aksesuar më 04 Prill 2013.

vetë janë një pasqyrim i fuqisë krijuese të Zotit. Në të njëjtën kohë, myslimanët urdhërohen të hulumtojnë përtej paraqitjeve të jashtme dhe të zbulojnë realitetin e brendshëm. Për myslimanët arti, shkenca dhe feja janë të gjitha pjesë e një uniteti kozmik,⁴⁷ ku fjala e shkruar e Kur'anit është mbi gjithçka. Arabishtja origjinale e Kur'anit nuk është ndryshuar, që kur është shkruar për herë të parë rreth 1400 vjet më parë. Në të gjithë globin, dijetarët myslimanë mësojnë arabishten klasike, me qëllim që ta studiojnë Kur'anin në gjuhën e tij origjinale. Është i pamundur për t'u përkthyer, sepse bukuria e gjuhës dhe e vërteta që përçon, si shpallje e vullnetit hyjnor, janë të pandashme.

Arkitektura Islame në Shqipëri

“Nëse shpirti fetar mundi të mbijetojë në Shqipëri, në atë që ishte padyshim një nga regjimet më ateiste e të gjitha regjimeve, ka të ngjarë të mbijetojë kudo dhe në çdo vend”⁴⁸, bashkë me të edhe arkitektura, si pjesë e pandashme e besimit. Në këndvështrimin islam mund të thuhet se arkitektura ka shpirt, sepse në të reflektohet bota shpirtërore e një populli, që i ndërton dhe përfiton të bukurën në formë dhe përmbajtje. Në krye të kësaj arkitekture në Shqipëri, padyshim qëndrojnë objektet e kultit islam, posaçërisht xhamitë, monumente me vlera historike dhe kulturore e artistike. Ndërtimet e kultit mysliman në Shqipëri zënë një vend të rëndësishëm në kuadrin e arkitekturës së Mesjetës së

Vonë shek. XV-XIX. Ato ngrihen në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët gjatë atyre shekujve, duke u bërë dëshmi të qarta të një periudhe të historisë së popullit shqiptar dhe të ndërtimeve në veçanti. Në trevat shqiptare arkitektura islame ka shtrirë “krahët” e saj, duke gjetur hapësirën e përshtatshme gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane dhe fillon të shfaqet në fund të shekullit XIV.⁴⁹ Sot për sot një arkitekturë e tillë është ndër pasuritë kulturore më të çmuara të popullit shqiptar.⁵⁰ Kjo arkitekturë e përhapur gjatë kësaj periudhe cilësohet nga arkitektë e historianë si e përmasave të larta artistike. Ndër monumentet e kultit mysliman, xhamitë zënë vend kryesor për nga numri, vlera dhe përhapja. Ato përbëjnë një dukuri arkitektonike me rëndësi të veçantë. “Në arealin e përgjithshëm të zhvillimit të artit dhe arkitekturës, ky art (ndërtimi i xhamive) ka dominuar që nga shek. XV dhe është më i prezantuar në kohën tonë, nga të gjitha artet tjera monumentale.”⁵¹

Arkitektura e xhamive në trojet shqiptare përfshin edhe pasurinë e madhe artistike të përbërë nga dekoracione me motive floreale, me peizazhe të pikturuara dhe gdhendje druri e guri në kolonat, tavanet, mafilet, etj. Zbukurime me ajete kur'anore dhe me arkade. Xhamitë me kompozicionin

49. P.sh. Sipas kronikanit të njohur turk Evlia Çelebiut, të kësaj periudhe janë: Xhamia e Sulltan Mehmetit II, Elbasan 1466, e ndërtuar në kullën e hyrjes për në kala, si dhe në qytete të tjera, Delvinë, Kaninë, Krujë, Shkodër etj.

50. Shih: Arkitektura e xhamive të Shqipërisë, Aleksandër Meksi, Uegen Tiranë 2007, f. 148 – 156.

51. Ali, A., Arkitektura Islame e Kosovës e zhvilluar gjatë periudhës osmane.

47. Williams, H. & D., Drita Islame, (<http://www.dritaislame.al/arti-islam-ure-mirekuptimi>), aksesuar 4 Prill 2013.

48. Basha, M. Ali, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri, 1912 – 1967, Tiranë 2011.

e vet arkitektonik me volumin dhe jehonën e kupolës thellësisht harmonik, me minaret elegante, që ngjiten lart me finesë e thjeshtësi, duket sikur kërkon të prekë qiellin, me kupolat dhe dekoracionet me ajete, me portik solid e të ëmbël, u komunikojnë gjithsecilit që kalon aty pari madhësinë, që mbart besimi dhe mesazhi, që ato përcjellin bindshëm. Pa dyshim, arkitektura është identiteti solemn i popujve dhe qytetërimeve. Arkitektura është një strukturë unike apo dalluese, që bëhet pikë referimi për një mjedis, monument që simbolizon identitetin, formën dhe tingullin e një shoqërie të caktuar, monument, që në mënyrë kolektive përfaqëson imazhin që një shoqëri mbart.

Objektet e kultit islam janë një kornizë për zbatimin e Islamit. Ato lehtësojnë, nxisin dhe stimulojnë adhurimin, apo dhe aktivitetet e myslimanëve në çdo moment të jetës së tyre tokësore. Arkitektura Islame vjen në ekzistencë nën patronazhin e perceptimeve islame; të Zotit, njeriut, natyrës, jetës, vdekjes dhe Ahiretit. Në këtë mënyrë, kjo arkitekturë është një materializim fizik i mesazhit Islam. Ajo gjithashtu përfaqëson identitetin e kulturës dhe civilizimit islam.

Objektet fetare që përbëjnë trashëgimi të pasur dhe janë pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, që përfaqësojnë vlera të shquara fetare, historike e kulturore e artistike janë: Xhamia Mbret, Berat; Rrënojat e Xhamisë së Kuqe-Lagjja Kala, Berat; Rrënojat e Xhamisë së Bardhë-Lagjja Kala, Berat; Xhamia e Beqarëve, Berat; Xhamia e Plumbit,

Berat; Xhamia e Hysen Pashës, Berat; Xhamia e Telelkave, Berat; Xhamia e Allajbegisë, Dibër; Xhamia e Fatihut, Durrës; Namazgjaja, Elbasan; Xhamia e Kalasë, Lezhë; Xhamia e Pazarit, Krujë; Xhamia me Sahat, Peqin; Kompleksi i Xhemahallës, Delvinë; Xhamia Mbret-Lagjja Kala, Elbasan; Xhamia e Nazareshës, Elbasan; Xhamia e Iljaz bej Mirahorit, Korçë; Xhamia e Gjin Aleksit, Rusanj, Sarandë; Xhamia e Ethem Beut, Tiranë; Xhamia e Muradies, Vlorë; Xhamia e Teqes, Gjirokastrë; Xhamia e Plumbit, Shkodër, etj.

Kaligrafia arabe dhe komunikimi i saj me kulturën materiale shqiptare

Kaligrafia arabe është një shprehje vizuale që lidhet me parimet kozmike dhe shpirtërore të popujve myslimanë. Parimet estetike të kaligrafisë arabe janë të pranishme edhe në kulturën materiale të popullit shqiptar dhe përbëjnë një nga vlerat e spikatura të artit të të shkruarit.⁵² Shembuj të kësaj kaligrafie janë gjetur në xhami e hamame të vjetra shqiptare, shumica e të cilave nuk ekzistojnë më, si: Ish-Xhamia Kubelie (Kapllan Beu) Kavajë, Xhamia e Bukuroces në Kosovë⁵³, Hamami i Ulema Pashës Shkodër, Kopshti arkeologjik i Durrësit, etj. Përmes eliminimit të figurës dhe zhvillimit të artit të të shkruarit, kaligrafia arabe u bë

52. Shih: Zekaj, R., Kaligrafia arabe dhe komunikimi i saj me kulturën materiale shqiptare, Simpozium Ndërkombëtar, Botuar në librin “Qytetërimi islam në Ballkan”, IRCICA, Stamboll 2007:272

53. Behluli, Demir, Arabeska në Xhami të Kosovës Lindore, 1994, Bukuroce është një fshat në Kosovën Lindore.

tepër e vlerësuar, si një art komunikimi i veçantë artistik, që paraqet përmes dekorit dhe estetikës së linjave forma nga më magjepsëset. Llojet e kaligrafisë arabe të përdorura në trojet tona janë ato të stilit: *Kufi*, *Thuluth*, *Talik*, *Divani*. Për arsye të rolit të saj në regjistrimin e tekstit kur'anor dhe fjalës së Zotit, kaligrafia është konsideruar si elementi më i rëndësishëm artistik, njëkohësisht edhe më kulmor në ndërtimin e vlerave të kulturës materiale në trojet shqiptare gjatë shekujve të fundit.⁵⁴

PËRFUNDIME

Domosdoshmëria e objekteve të kultit si mjet komunikimi

Objektet e kultit islam, kanë një rëndësi të madhe në jetën e një individi apo shoqërie, pasi religjioni/ feja shihet e lidhur mjaft ngushtë me njeriun, me botën e tij të brendshme/ shpirtërore. Njeriu besimtar, në sjellje, në marrëdhëniet e tij në shoqëri, në jetën e përditshme, reflekton rregullat dhe përcaktimet kanonike të fesë përkatëse. Rëndësia e objekteve të kultit islam shtohet edhe për faktin se ata ndihmojnë në forcimin e besimit fetar te njerëzit; konsolidimin e lidhjes së besimtarëve me objektin dhe Krijuesin.

Arkitektura islame, kryesisht xhamitë, me format dhe zbukurimet e shumëllojshme dhe arti islam në tërësi, paraqet në mënyrë unikale kuptimin dhe domethënien shpirtërore të këtij objekti religjioz. Xhamia është një hapësirë e shenjtë, është një pasqyrim i besimit të thellë në fjalën hyjnore; simbol i besimit të gjallë Islam, besimi në Zotin dhe besimi në Githëpushtetshmërinë e Tij.

54. Zekaj, Ramiz, f. 274.

Ajo është vendi i realizimit të lutjes dhe të të gjitha riteve dhe ritualeve të Islamit. Komponentët e hapësirës së shenjtë të xhamisë: minaret që thërrasin njerëzit në shpëtim, salla e lutjes me mihrabin e saj dhe minberi. Minberi, podiumi i parë i thirrjes për të udhëzuar gjithë njerëzimin në rrugën e së vërtetës, për t'i komunikuar njerëzimit të Vërtetën Absolute. Aty mbledhen njerëzit dhe komunikojnë me njëri tjetrin, aty ata dëgjojnë se si duhet ta ndërtojnë jetën e tyre, se si duhet të shërbejnë në të mirë të shoqërisë, vetes dhe vendit në të cilin jetojnë.

I tërë Kur'anit me idetë e tij, me vlerat, format e ligjërimit, fjalitë kaligrafike, muzikalitetin, ezanin dhe namazin, me shpirtin e Ramazanit, me mirëpritjen dhe përcjelljen e pelegrinëve, me mësimin përmendësh të Kur'anit, vazhdojnë të theksojnë, të ngjyrosin, të zbukurojnë, të orientojnë dhe t'i japin kuptim jetës së njerëzve. Komunikimi përmes kaligrafisë është gati hipnotizues për njeriun, pasi Kur'anit për besimtarin është qetësues; një rrezatim i Diellit Hyjnor mbi shkretëtirën njerëzore. Harmonia dhe proporcionet e germave të shkrimit arab në fakt bazohen mbi parime gjeometrike të qarta të përfutuara nga një rrjetë vijëzimi e përpiktë, duke theksuar edhe një herë harmoninë e mahnitshme, që bashkon artin, shkencën dhe fenë islame.

Arti islam i tregon botës ndjesore të njeriut synimin më të lartë të shpirtit dhe depërton në bukuritë e brendshme. Pra, arti është një tablo, që i përshkruan njeriut thellësinë e botës së brendshme.

Kjo botë madhështore, me faltoret e saj të ngritura, me minaret si gishta

dëshmie që tregojnë botën e përtëjme, dhe me motivet e dizajnet e bekuara në ballë të mermerëve që konsiderohet secila prej tyre, si një mesazh më vete, me artin e shumëllojshëm të shkrimit është shndërruar në një galeri bukurish, që nuk ngopesh së pari, rrjedhojë kjo e shoqërimit të besimit nga arti.

Në këndvështrimin sociologjik, feja përfaqëson një lidhje të fortë mes individit dhe grupit më të gjerë shoqëror. Këta faktorë përbëjnë bazën e bashkimit dhe janë shprehje e kuptimeve kolektive. E premtja për myslimanët, e njohur ndryshe *xhuma* (nga arabishtja, që do të thotë *dita e tubimit*) është një ditë lutje të përbashkëta, një ditë bashkimi.

Arkitektura islame në Shqipëri është e shquar për domethënien e saj të hapësirës dhe të pastërtisë, ku përveç imagjinatës, motiveve dhe formave arabe, perse e turke, paraqet më së shumti edhe elementin autokton,

duke u komunikuar njerëzve mesazhin universal. Ato u ndërtuan në zemrat e lagjeve të qytetarëve dhe shpesh ato shërbyen për të formuar qendrat, apo bërthamat urbane të qyteteve. Xhamitë i shërbejnë masës së gjerë të qytetarëve ndaj edhe marrin zhvillim të madh arkitektonik.

Pa dyshim, arkitektura është identiteti solemn i popujve dhe qytetërimeve. Ato lehtësojnë, nxisin dhe stimulojnë adhurimin, apo dhe aktivitetet e myslimanëve në çdo moment të jetës së tyre tokësore.

Arkitektura Islame vjen në ekzistencë nën patronazhin e perceptimeve islame; të Zotit, njeriut, natyrës, jetës, vdekjes dhe Ahiretit. Në këtë mënyrë, kjo arkitekturë është një materializim fizik i mesazhit Islam. Ajo gjithashtu përfaqëson identitetin e kulturës dhe civilizimit islam.



Bibliografi në shqip

- Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912 – 1967)*, Tiranë 2011.
- Ali M. Basha, *Nëpër gjurmët e Islamit*, Tiranë 2005.
- Aleksandër Mexi, *Arkitektura e Xhamive të Shqipërisë (shekujt XV-XIX)*, UEGEN, Tiranë 2007.
- Abdulaziz Mustafa, *Përpara se të shkatërrohet Xhamia El-Aksa*.
- Amir B. Ahmeti, *Atlas i botës Islame*, LOGOS-A, Shkup 2009.
- Beshir Ajvazoglu, *Estetika Islame*, Logos-A, Shkup, 2009.
- Ekipi i studimeve Akademike, *Udhërrëfyesi një myslimani (adhurimet)*, PRIZMI 2010.
- Enes Ahmed Kerzun, *Udhërrëfyesi drejt lumturisë dhe suksesit*.
- Ekrem Sarëkçëoglu, *Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi (Isparta 2000) Historia e feve, prej fillimit deri sot*, LOGOS-A, Shkup 2010, Botim i dytë.
- Fethullah Gylen, *Për një qytetërim botëror me dashuri dhe tolerancë*, PRIZMI, Tiranë 2005.
- Faik Luli, *Islam Dizdari, Mevludet në gjuhën shqipe*, CAMAJ - PIPA, Shkodër 2002.
- Halit Muharremi, *Fjalor i Teologjisë*, MIRGREALB, Tiranë 2006.
- Hafiz Ali Kraja, *A duhet feja a e pengon bashkimin kombëtar*, Botimet KMSH, Tiranë 2010.
- Ismail Faruki, *Transhendenca Hyjnore dhe Shprehja e saj*, ERASMUS, Tiranë 2006.
- Isa Memishi, *Fjalor Arabisht Shqip*, Prishtinë 2011.
- Jusuf Kardavi, *Besimi dhe Jeta*, FURKAN, Shkup 2010.
- Jusuf Kardavi, *Kudsi - Çështje e çdo myslimani*.
- Kur'an.
- Lartësimi i Shpirtit, FLLADI, Tiranë 2007.
- Murad Hofman, *Islami*, ACFOC, Tiranë 2011.
- Michiel Chiel, *Arkitektura Osmane në Shqipëri (1385 – 1912)*, AIITC, Tiranë 2012.
- Marshall McLuhan, *Instrumentat e Komunikimit*, IDK.
- Osman Nuri Topbash, *Kur'an ve Sünnet İklîminde, İslâm, İmân, İbadet ERKAM*, Stamboll 2000.
- (Islami, Besimi dhe Adhurimi në Klimën e Kur'anit dhe Sunnetit, ERKAM, Stamboll 2002).
- “Qytetërimi islam në Ballkan”, IRCICA, Stamboll 2007, Punimet e Simpoziumit Ndërkombëtar me të njëjtin emër.
- Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptaret gjatë shekullit XX*, AIITC, Tiranë 2002, Ribotim.
- Rabi Ibn Hadi Umejr El-Med'Halij, *Metodologjia e Pejgamberëve në thirrjen për tek Allahu*, KUMI, Tiranë, 2010.
- Raqaiyyah Waris Maqsood, *Fjalori bazë i islamit*, ACFOC, Tiranë 2008 (A basic dictionary of islam).
- Titus Burchardt, *Art of Islam, World Wisdom*, 2009, Indiana, USA. (Arti i islamit, gjuha dhe kuptimet, LOGOS-A, Shkup 2012.
- Tahir Dizdari, *Fjalor i Orientalizmave në gjuhën shqipe*, AIITC, ISECO, Tiranë, 2005.
- Sejid Muhammed Nakib El-Attas, *Islami dhe shekullarizmi*, LOGOS-A, Shkup 2006.
- Zyhdi Dervishi, *Lente të ndërveprimit simbolik*, EMAL, Tiranë 2008.

Bibliografi në gjuhë të huaj

Ahmed Toufiq, *The Pulpit of an Empire: The Contemporary Political and Religious Environment of the Minbar from the Kutubiyya Mosque*.

Doğan Kuban, *The Mosque and Its Early Development*, Muslim Religious Architecture, Leiden: Brill, p. 3, (1974).

Elmosta Fahbibi, *The Structure and Artistic Composition of the Minbar from the Kutubiyya Mosque*.

George Michell, ed. 1978, *Architecture of the Islamic World*, London, Thames dhe Hudson.

Jonathan M. Bloom, *The Minbar from the Kutubiyya Mosque*.

Jack Soutanian, Antoine M. Wilmering, Mark D. Minor, Andandrew Zawacki, *The Conservation of the Minbar from the Kutubiyya Mosque*.

Mohd Sabrizaa B Abd Rashid, Azizul Azli B Ahmad, *The Form and Symbolism of Minbar Architecture in The Malay World*.

Mircea Eliade, *Dinin Anlam ve sosyal fanksiyonu*.

Martin Lings, *Symbol and Archetype*, Quinta Essentia, 1991.

Muhamed Adnan Bakhit, *Historia e njerëzimit*, UNESCO, 2000.

Naima Chikhaoui, *Minber: Symbol of verticality and Elevation*.

Mohd Sabrizaa B Abd Rashid, Azizul Azli B Ahmad, *The Form and Symbolism of Minbar Architecture in The Malay World*.

Omer Spahic, *Issues in the history and character of the Islamic built environment*. Research Centre. IIUM 2005.

Omer Spahic, *The Prophet Muhammad PBUH and urbanization of Madinah*, Research Centre, IIUM 2005.

Rene Guenon, *Basic symbols, the universal language of sacred science*, Quinta Essentia, Cambridge, 1995.

Robert Hillenbrand, 1994, *Islamic architecture, form and function*. Edinburgh University Press.

Tarek Waly, *In Quest of the Path: To "The One" in Mosque Architecture*, Beit Al Quran. Publications, Bahrain, 1993, (www.walycenter.org/en).

The orientalist literature related to the minbar in Islam reports that the mosque of Samara had a minbar which was 3.90 m high.

Thames and Hudson (1978). *Architecture of the Islamic world*.

The Form and Symbolism of Minbar Architecture in The Malay World .

Salma Samar Damluji, ed. 1998. *Architecture of the Holy Mosque of the Prophet, Al Medine*. Londër: Hazar Publishing.

Stefano Carboni, *The Historical and Artistic Significance of the Minbar from the Kutubiyya Mosque*

Youssef Brugman, ed. "Mosque al Madinah Al Nabi".

I NËMURI I FUNDMË I RILINDJES KOMBËTARE

Prof. Dr. RAHIM OMBASHI
Universiteti Bedër, Fakulteti i Shkencave Humane,
Departamenti i Shkencave të Komunikutimit,
Tiranë

Abstrakt

Viti 1924 dëshmon ngritjen dhe pjekurinë artistike të Hafiz Ali Korçës. Pason me vitin 1925, kur ky autor do të ketë dy botime: Bolshevizma a çkatrrim i njerëzimit dhe Gjylistani (Trëndafilshija), e Sa'adiut, 1925, i ndjekur nga vepra e tij më voluminoze Kur'ani i Madhënueshëm e thelbi tij, 1926. Katër vite më pas boton Rubajjati (Katroret) e Umer Khajjamit, 1930..., tre vite pasi kishte dalë botimi i dytë shqipëruar nga Fan Noli. Në vijim të veprimtarisë atdhetare, fetare, shkencore dhe krijimtarisë letrare, e cila nis në agun e shekullit XX, në vitin 1924 Hafiz Ali Korça boton përmbledhjen poetike me 17 poezi Shtat' ëndrrat e Shqipërisë, e cila shpërfaq aktualitetin politik të atdheut, që do të pasohet nga eseja Bolshevizma a çkatrrim i njerëzimit, Tiranë. Shkrimi e rreshtoi përfundimisht në anë të kundërt me ideologjinë komuniste, e cila u përhap shpejt në vendin tonë, për t'u bërë zotëruese te ne mbas Luftës së II-të Botërore. Vepra u ribotua me kujdesin e imam Vebbi Ismailit me titullin: Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit, Albanian Islamic Center, Harper Woods, Mich. USA, 1993. Botimi i tretë: Bolshevizmi është shkatërrim i njerëzimit, Prishtinë, 2001, është përshtatje dhe i përgatitur për shtyp nga Prof. dr. Feti Mehdii. Madje, te botimi i vitit 2001, në footnotën 15, njoftohet dhe për një botim tjetër të kësaj vepre në vitin 1933: "Bolshevizma... f. 13. Këto citate janë marrë nga botimi i vitit 1933". Vepra e cila parashkroi ardhmërinë politike të atdheut, është bërë së pari objekt i qasjes tekstologjike, strukturës dhe prosodesë së saj, kurse domethëniet rreken të provojnë se çfarë ishte ajo ideologji që i binte ndesh jo vetëm besimit fetar, por edhe tipareve kryesore të identitetit tonë kombëtar. Komb-Fe-Atdhe është trashja, e cila ndih për të kuptuar drejt harrimin që ra mbi personalitetin e kësaj figure të madhe me vlera mëse kombëtare.

Hyrje

Duke përdorur termat e Eqrem Çabejit, forcat centripetale dhe ato centrifugale, të cilat kanë pasur marrëdhëniet e tyre me qendrën, kanë fryrë veçmas mbi Arbëri dikur, duke mos u mpakur më këtej, i japin përparësi kësaj të dytës, duke i prodhuar Shqipërisë, po të përdorim termat e At Zef Pllumit e Sabri Hamitit, një tronditje të përhershme, një lëvizje të humbjes e të kurrjes. Kolonia shqiptare e arbëreshëve të Italisë, pasuar nga ato të arbëreshëve të Dalmacisë e të Greqisë, më pas ato të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes, Egjiptit dhe Amerikës, krijuan diasporën shqiptare. Boshtin e mbetur prej ikjeve pa mbarim imagjinata krijuese e shënjoji si qendër, e cila realisht do të kthehej si e tillë në krye të shekullit XX. Shkëndijat e ideologjisë kombëtare që u ndezën prej Naum Veqilharxhit, u formuluan si doktrinë e krijimit të shtetit dhe e veprimit për realizimin e tij nga Pashko Vasa e Sami Frashëri. Mbi bazën e këtyre themeleve virtualë u ngrit vepra poetike e Naim Frashërit, si konstituim i hieratizuar i ngrehinës sonë shpirtërore.

Pas vitit 1897, si doli revista *Albania* e Faik Konicës, dhe me fillimin e shekullit XX me Fan S. Nolin¹, dallohet një lëvizje binare me romantizmin, zhvillohet rrafshi kritik i brendshëm, i cili si objekt kishte ndërtimin e botës së individit shqiptar, pasi të ishte shpallur shteti i tij i pavarur. Individit me prirje sociale zgjodhi Korçën, siç ka përzgjedhur L. Poradeci, dhe Shkodrën, dy qytetet që u bënë qendra, duke thithur e vlerësuar elitën kulturore në atdhe.

1. Ombashi, R., (2002), *Po vjen Noli...*

Duket forca centripetale, e tulitur në çaste euforie kombëtare, vijoi të lartohet jashtë, apo të dënohet me harrim, pa ndalur, të nëmurit implicitë apo eksplicitë, personalitete të fuqishëm, por dhe intelektualët e pakët, që numëroheshin me gishta.

Ende nuk është shëruar plaga e shkaktuar prej injorancës apo hipokrizisë, duke përjashtuar të gjithë ata, që jo vetëm e deshën, por dhe ditën ta donin deri në tërtherje Atdheun, madje u nëmën dhe u baltosën, duke cenuar deri kodin e paprekshëm të vdekjes.

1. Korça i dhuroi emrin e penës

Shqipëria Juglindore ka një shenjë të spikatur vlerash që quhet Korçë.² Qendër e një rajoni të banuar që në lashtësi, por dhe e një njësie të natyrshme administrative e pa shkëputje, të paktën prej shekullit katërmëdhjetë e këtej, kur rrethanat politike filluan të jenë në ndihmë të saj, arriti t'i ndejë e t'i kuptojë. Rritja e prodhimit të thjeshtë të mallrave në rajon e fuqizoi tregun rajonal, duke shënuar rënien e regjimit klasik ushtarak të timareve dhe duke i çelur rrugë pronës feudale të çifligut. Megjithatë tregu shqiptar mori hov nga forcimi i esnafëve në qytete, ku forcat prodhuese shënuan rritje të shpejtë, ndryshime pozitive u vunë re edhe në fshatrat e rajonit.

Nuk duhet harruar që hiri mbi zjarrin e vatrës mbrojti shpuzën e qytetit, duke siguruar mosshuarjen e Voskopojës, ku fryu fladi i ideologjisë, i cili pasoi humanizmin evropian, që

2. Balli, K., (2008), *Antologji me prozë të shkurtër të Qarkut Korçë*.

si e joshi, e rriti me lëndë të realitetit, iluminizmin, si besim i mendimit të lirë, duke e shpallur si “fe” të re edhe ndër ne, kur shpërtheu me “fenomenin voskopopjar”. I përplotësuar zbriti në Korçë ku u ribë prush. Na e përforcon këtë vijueshmëri At Zef Pllumi te parathënia e *Labuta e Malcis'*, 2010, fq. III, kur përfundon: “Akademia e Voskopojës nuk kje një çfaqje e huej, por thjeshtë kombëtare”. Shkëndija e kësaj vatre drite u mor me vete nga shqiptari i madh Naum Vithkuqari, i njohur si Naum Veqilharxhi, i cili që nga Rumania i lëshoi kombit një kushtrim për bashkim, kulturë e liri. Mbi rajonin e Korçës, në periudhën e Rilindjes Kombëtare, duket, ndikim më të madh luajtë kolonia e Bukureshtit, kurse me fillimin e shekullit XX ajo e Amerikës. Korça rrezatonte qytetari jo thjesht në hapësirën rrethuese të rajonit të saj, por në gjithë vendin.

Ndonëse ishte krijuar si qendër shumë më parë kësaj periudhe, duke pasur si bërthamë kështjellën e Muzakajve, ajo nisi të zhvillohet me shpejtësi pas shkatërrimit të Voskopojës (1769-1779) dhe rënies politiko-ekonomike të Janinës (1822). E mbrothësuar me ndërtesa publike, si: xhamia e Iljas bej Mirahorit (1496), furra dhe imareti, kisha e madhe “Burimi jetëdhënës”, ajo shtohet në këtë kohë edhe me tri ngastrat të banuara: Varoshi, Kasabaja dhe Tregu. Qyteti ra në sy për rregullin e tij, duke u quajtur qendër simpatike, e qeshur dhe e pasur me vila zotërinjsh të ndërtuara prej guri që zbardhnin nga gëlqerja³.

3. Durham, M. E., (1905), *The Burden of Balkans*.

Nevoja për diferencim dhe identifikim e kësaj qendre nxiti krijimin e banesës korçare, si tip i veçantë ndërtimi në kuadrin e banesës qytetare shqiptare, një tip që paraqet shkallën më të lartë dhe më të përsosur të banesës së ndërtuar nga borgjezia qytetare deri në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX.⁴

Dokumentacion mbështetës vjellim te Sami Frashëri me shënimet historike në *Enciklopedinë* e tij si dhe nga ish-drejtori i shkollave të Korçës, Ch. Karmici (H. Karmitses), në librin *Geografia tis Koricas ke tis perioikidos, pros brisin ton katoteron takson* (Gjeografia e Korçës dhe e rrethit)⁵, për t'u përdorur si tekst mësimor. Në këtë libër ai jep një tablo të mirë mbi jetën ekonomike, kulturore, arsimore, mbi ndërtimet kryesore etj, të qytetit dhe të fshatrave.

Si burim të rëndësishëm informacioni, sidomos për dy shekujt e fundit, kemi përdorur *Kodiku i Mitropolitë së Korçës e Selasforit*, përgatitur për botim nga Petraq Pepo, me titullin *Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII fillimi i shek. XX*⁶.

Mesi i shek. XIX e gjeti Korçën një qytet në lulëzim e sipër, që tërhiqte gjithnjë e më tepër banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Në vitin 1859 Korça numëronte 10.000 banorë. Ritmet e shtimit mbas kësaj periudhe bëhen të përsheptuara. Më 1879 qyteti kishte

4. Riza, E-Strazimiri, G., (1972/3), *Vështirim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës*, “Monumentet”; dhe Thomo, P., (1988), *Korça, urbanistika dhe arkitektura*.

5. Karmitses, H., (1888), *Geografia tis Koricas ke tis perioikidos pros brisin ton katoteron takson*.

6. Pepo, P., *Dy dokumente...* Pepo, P., (1972) *Materiale dokumentare për ambientin shoqëror të Varoshit të Korçës*, “St. historike/1”; Pepo, P., (1966), *Një letër e korçarëve e vitit 1845 drejtuar N. Veqilharxhit në Rumani*, “St. Filologjike/1”.

1.500 shtëpi me 13.000 banorë. Po kaq e çmonte dhe Karmici më 1888.⁷ Ecuria mundësoi që më 1923 qyteti arriti të ketë 25.598 banorë dhe të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë.

Korça në fillimet e saj administrative ka qenë Nahije e Manastirit, qendër administrative e krahinës përreth. Më pas, duke u fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht, arrin që më 1827 të bëhet Kajmekamllëk (nënprefekturë), ndërsa më 1870 bëhet Mytesariflëk (prefekturë), që kishte në varësi nënprefekturat e Kosturit, Bilishtit e të Kolonjës.⁸

Qenia e Korçës si qendër administrative dhe pozita e favorshme e saj, i jepte përparësitë e karakterit të një qendre prodhimi dhe këmbimi dhe më pas edhe si qendër arsimore, kulturore dhe patriotike. Në një dokument të vitit 1505 përmenden “meremetçinjtë” (zanatçinjtë) në qendrën shoqërore që ngriti Iljaz bej Mirahori në fshatin Peshkopi.

Rufetet (esnafet) e papuxhinjve, të tabakëve, shajakxhinjve, terzinjve, kasapëve, opingarëve, samarxhinjve, gjymxhinjve, bakejve, qyrkxhinjve etj. që në krye të shekullit XVII dëshmojnë një zhvillim të plotë, çka të jep sigurinë të mendosh për krijimin e tyre më herët. Në fund të shekullit, esnafët e këtij qyteti e kaluan numrin 20. Zhvillimi i zejeve kishte krijuar një shtresë të gjerë të popullsisë, e cila mbizotëronte në qytet dhe luante një rol të dorës së parë në organizimin e jetës së brendshme dhe të tregut, duke përforcuar tiparet e një jete kolektive, e cila u dëshmuo edhe në ndërtimet e qytetit.⁹

7. Frashëri, S., *Kamus V.*

8. N. D. N., (1923), *Korça dhe katundet e qarikut.*

9. Shkodra, Z., (1973), *Esnafet Shqiptare* (Shek.

Duke pasur lidhje më herët me vendet fqinje dhe më gjerë, të cilat në mjaft raste u shërbenin si model, kujdes të veçantë korçarët bënë për shkollimin. Dëshmia e parë për çeljen e shkollës në qytet është e vitit 1724. Në vitin 1738 shtatë esnafët e Varoshit të Korçës morën vendimin për të hapur shkollë që të mësojnë djemtë pa pagesë *cilitdo qofshin*¹⁰. Është kjo frymë e krijuar që e shtyu komunitetin t’i kthente përgjigje Naum Veqilharxhit për letrat *E parthënme. Për mbi djemt e rinj shqiptarë* dhe *Enqiklikë për të pasurit dhe të mësuarit ortodoksë shqiptarë*, botuar atë vit në Ëvetarin e tij, botimi i dytë: “Shpëtuam nga aq vjet përbuzje e cila rridhte prej mungesës së mësimit. Shpresojmë se brenda një kohe të shkurtër mësimi do të shtrihet në të gjithë hapësirën e atdheut tonë dhe në të gjithë kombin...”¹¹

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare në Korçë funksiononin disa shkolla: gjimnazi (1856), dy shkolla qytetëse (1867), shkolla e vajzave (1857), dy foshnjore (1872, 1873), që financoheshin nga Llasoja e Korçës dhe ruzhdia (foshnjore), iptidaje (fillore) dhe idadia (gjimnazi) me fondet e qeverise osmane. Nderi vetjak, apo ai i fisit i përforcuar në këto kushte, veçmas jehona e revolucionit amerikan dhe atij francez, po ndihte në krijimin e sedrës kombëtare, duke arritur në çeljen e shkollës së parë shqipe në Korçë,

XV-XX).

10. Thomo, P., (1988), *Korça, urbanistika dhe arkitektura.*

11. Pepo, P., *Dy dokumente....* Pepo, P., (1972) *Materiale dokumentare për ambientin shoqëror të Varoshit të Korçës*, “St. historike/1”. Pepo, P., (1966), *Një letër e korçarëve e vitit 1845 drejtuar N. Veqilharxhit në Rumani*, “St. Filologjike/1”.

për djemtë dhe disa vite më pas ajo e vashave, nga Gjerasim Qiriazi, ku jepte mësim Sevastia, e motra.

“Rilindja, ajo e bëri Shqipërinë!”- pëlqen të theksojë bardhi i shqipes, Lasgush Poradeci.

“Ku filloi Rilindja? Jashtë Shqipërisë. Në kolonitë shqiptare të Misirit, të Bukureshtit, pastaj në Amerikë”.

“Nga ishin shqiptarët e këtyre kolonive?”

“Përgjithësisht nga Korça ishin.”¹²

Dhe më poshtë:

“Po pse, rastësisht u çel shkolla e parë shqipe në Korçë?”

“Patriotët korçarë ishin ata që jepnin paratë në Bukuresht për të shtypur librat. Korçar ishte Mandi (Dhiamandi) Tërpo që fali shtëpinë për të bërë shkollë. Dhe ishin patriotët korçarë, që dërguan fëmijët në këtë shkollë, prandaj dhe apostulli i Rilindjes, Naim Frashëri, ja vuri Korçës atë kurorën e lavdisë: *Lumja ti moj Korçë, o lule, / Ç'i le pas shoqet e tua, / Si trimi në ball' u sule, / Ta paçim përjetë hua!*”

“Kjo kurorë lavdie, që i vuri Naimi Korçës nuk do të vyshket kurrë!

Çfarë nuk nxori Korça në kohën e Rilindjes!

Luftëtarë? – po! Shkrimtarë? – po! Poetë? – po!”¹³

Në këtë mjedis të tillë entuziast u lind në vitin 1873 Hafiz Aliu. Me emrin e vënë, prindërit shënjuan ëndrrën, që biri të bëhej besimtar i mirë dhe mik i librit të shenjtë. Këtu kreu shkollimin fillor dhe po në këtë qytet mbaroi idadijen, kurse studimet e larta do t'i vijonte në Universitetin e Stambollit.

Hafiz Aliu, atdhetari i Rilindjes sonë Kombëtare dhe i shtetit shqiptar të krijuar pas përfundimit me sukses të kësaj periudhe, demokrati i shquar, që punoi e luftoi për vendosjen e një regjimi kushtetues, republikan, borgjez, islamologu, krijuesi i veprave artistike, përkthyesi mori si titull nderi emrin e qytetit të vet për emër të penës, duke i mbetur si mbiemër. Familja e tij intelektuale fetare në zë banonte në rrugën e lashtë të këtij qyteti, që mbante emrin e mecenit Iljaz Bej Mirahori. Shtëpia e saj ndodhet në krah të kullës së sahatit të ngritur në vitin 1784 nga esnafët e bakejve myslimanë korçarë dhe ortodoksë voskopojarë. Kambana e fuqishme e sahatit i kujtonte të voglit se koha ecte shpejt, ndaj duhej të mos shkonte kot. Mjedisi familjar dhe ai qytetar ndihë në formimin e karakterit të tij, si dhe në ëndrrat që ai projektoi për të ardhmen.

2. Në Stamboll - Qyteti i 77 mileteve

Me emrin e vënë prindërit shënjuan ëndrrën e tyre, por kryeqyteti i Perandorisë Osmane e bëri atë realitet. Metropoli që shtrihej në dy kontinente do të ndikonte në formimin e Hafiz Aliut, po njëherazi në këtë qytet të madh shumëkulturor do të niste një periudhë e re për të, ajo e plotësimit të tij të shumanshëm. Do të përvetësonte gjuhën arabe, perse dhe frënge, ndërkohë perfeksionoi atje gjuhën turke, që e kishte nisur ta mësonte gjatë shkollimit në qytetin e lindjes. Në Stamboll shpejt do të bjerë në kontakt me klasikë arabë, persë, turq dhe kështu krijoi një konsideratë të lartë

12. Kolevica, P., (1992), *Lasgushi më ka thënë...*

13. *Po aty.*

ndaj rektorit të parë të Universitetit të Stambollit, Hoxha Tahsinit. Mjedisi i ndih të bëhet veprimtar i çështjes kombëtare dhe që në atë periudhë filloi të jetonte me interesat e vendit dhe të popullit të vet: *Po mendohesha një natë mbi çështjen e Shqipërisë / Si do bëhet thosha vallë balli i kësaj Perisë / Mjaft ashik i kanë dalë sikush e kërkon për vehte / Sillen si intriga të ndryshme për nënën, që na dha sisë.* (**SHTAT' ËNDRRAT E SHQIPËRISË**)

Periudha e studimeve universitare në kryeqytetin e 77 mileteve, si e antonomizojnë, ku përfaqësoheshin të gjitha kombësitë e perandorisë, që sundonte mbi tre kontinente, përkon me fazën finale të lëvizjes për shtimin e forcimin e sedrës kombëtare të popullit turk. Jehona e deklaratës së famshme të poetit reformist Zija Pasha (1829-1880): “Gjuha jonë nuk është osmane, por është gjuha turke”, si shpallje eksplicite e mbështetjes së Reformave të Tanzimatit (1839-1876), kishte dhënë rezultatet e veta. Zhvillimi i vetëdijes kombëtare, u shoqërua me lindjen e prozës së shkurtër e romanit, themelet e të cilit i hedh romani i parë në turqisht *Dashuria e Talatit me Fitneten*, shkruar në vitin 1872 nga Shemsettin Samiu, siç njihet në Turqi Sami Frashëri.

Lidhjet e ngushta historike me Francën, forcuar gjatë Luftës së Krimesë (1854-1856), përkthimet nga kjo gjuhë, rritën ndikimin mbi letërsinë turke të shekullit XIX-të. Njëherazi, ndikimi i romantizmit francez gjatë periudhës së Tanzimatit mbeti mbizotërues. Poeti Namik Qemal (1840-1888) shkroi romanin *Zgjimi* (1876). Gazetari Ibrahim Shinasiu shkroi në vitin 1860 komedinë me një akt *Martesa e poetit*. Romancieri

Ahmed Mitat Efendiu (1844-1912) ka shkruar romanet *Hasan Detari*; *Misteri*; *Brenda misterit*; *Vetëm 17 vite të vjetra*; *Vërejtjet*.

Shkrimtarët e kësaj periudhe, që janë figurat qendrore të Rilindjes Turke, dëshironin të përhapnin sa më shumë letërsinë e re, me shpresën se jepnin ndihmesë në rivitalizimin e strukturave sociale osmane. Në këtë atmosferë kulturore Hafiz Korça hyri në ndikimin e lëvizjes, që filloi me themelimin më 1891 të revistës *Pasuria shkencore*, ku u mblodhën një grup intelektualësh sipas modelit perëndimor, nën drejtimin e poetit Tefik Fitret (1867-1915), të cilët synonin krijimin e artit të lartë në Turqi. Në poezi ndikoi parnasizmi frëng, ose i ashtuquajtur *Dekadencë*. Proza prirej kah realizmi.

3. Në gjurmët e Hasan Tahsinit¹⁴ (1811-1881)

Asokohe në Stamboll, dhe jo vetëm në të, ndihej vlerësimi ndaj Hasan Tahsinit (Hasan Osman Hoxha), që në Stamboll u quajt Hoxha Hasan Tahsin Efendi, me tre tituj nderi të kohës, pjesëmarrës në *Komitetin e Stambollit*, *Lidhjen e Prizrenit* dhe *Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip*.

Në revistën *Hafta* (Java), që dilte në Stamboll, në numrin 5, i cili doli në verën e vitit 1881, Sami Frashëri nisi botimin e kronologjisë për Hasan Tahsinin, të cilën e përfundon në numrin 6. “Jeta e këtij njeriu është një mësim që ka vazhduar gjysmë shekulli... Për dy gjëra kish më shumë dëshirë dhe zell: e para, të zgjeronte më tepër diturinë e tij për t’u çapitur sa më pranë të vërtetës; dhe

14. Bica, L., (2009), *Profesor Hasan Tahsini*.

e dyta, t'ua mësonte dijet që zotëronte njerëzve, në mënyrë që t'i shërbente kombit dhe atdheut...”

Rektor i universitetit të parë osman më 1869 në Stamboll, fill pas daljes së ligjit mbi arsimin laik trishkallësh në Turqi, në dhjetor 1870 u keqkuptua për një temë fizike dhe u shkarkua nga posti i rektorit. Sami Frashëri dhe Ismail Qemali e kishin për nder që kishin qenë nxënës të tij. Ai botoi në faqet e revistës së vet *Mecmuai Ulum* (Revista e Diturive) *Kanonizimën* e *Shoqërisë së Stambollit*, revistë e cila u bë organ i kësaj shoqërie. Vdiq në shtëpinë e mikut të tij Munif Pashaj, më 4 korrik 1881. U varros në varrezat e xhamisë Sheshi i Ri (Shahrai Xhedid) të lagjes Erenkoy, në Yskydar (Pjesa aziatike e Stambollit). Naim Frashëri i kushtoi një vjershë që e titulloi: *O Hasan Tahsin! O trëndafil qiellor!* Emrin e tij e ka një rrugë “Hoxha Tahsin” në Stamboll. Një e tillë ndodhet në Tiranë. Aty është dhe varri i Sami Frashërit, emrin e të cilit e ka një rrugë dhe një shkollë. Rilindas i shquar, shkencëtar i madh dhe reformator i shquar islam.

Në dy revistat e fetare islame *Zani i Naltë* dhe *Kultura Islame* emrat e tyre janë simbol dhe burim krenarie, aq sa jo njëherë në to thuhet: “Hoxha Tahsinat, Hafiz Ali Korçat...”.

3. 1. Në sop të kurbës së ideologjisë kombëtare

Fushatës së zgjedhjeve për parlamentin e dytë osman patriotët shqiptarë i kushtuan kujdes të veçantë. Megjithëse zgjedhjet qenë indirekte dhe u zhvilluan nën diktatin e valinjve, nën trysinë që vinte nga poshtë dolën deputetë edhe disa personalitete

atdhetare, ndër të cilat ishte edhe Abdyl Frashëri, mik besnik i “çamit të madh Abedin Pashë Dino”, Ministër i Punëve të Jashtme të Turqisë, i cili si shqiptar mendonte që mos u lëshohej sllavëve të zbritur vonë në Ballkan asnjë pëllëmbë e tokës së shqiptarëve.

Çeljen e parlamentit në dhjetor të atij viti patriotët shqiptarë, sidomos anëtarët e *Komitetit të Janinës*, e shfrytëzuan për të organizuar në Stamboll një takim në shkallë kombëtare. Për këtë qëllim, përveç deputetëve të parlamentit, u thirrën në Stamboll edhe personalitete të njohura shqiptare që përfaqësonin pothuajse të gjitha krahinat e Shqipërisë. Në mbledhjen e parë, që u mbajt më 18 dhjetor 1877, u miratua forumi i organizatës atdhetare revolucionare me emrin *Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare*, ose siç u quajt shkurt *Komiteti i Stambollit*. Kryetari i *Komitetit* u zgjodh Abdyl Frashëri. Megjithëse nuk dihet ende përbërja e plotë e këtij *Komiteti*, janë njohur tanimë si anëtarë të tij Pashko Vasa, Jani Vreto, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Sami Frashëri, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Iljaz Dibra, Mehmet Ali Vrioni, Seid Toptani, Mustafa Nuri Vlora, Mane Tahiri etj.

Bie në sy që në këtë Komitet ka përfaqësues prej të gjitha identiteteve fetare, si paradoks shqiptar i trashëguar, i cili kërkonte vëmendje të veçantë në trajtimin e tij. Shqiptarët duhen vlerësuar si populli i parë, që lejua përditësimin e doktrinës së krishterë në Shqipëri, ndërkohë që janë ndër të parët qysh herët rehat në këtë vend edhe bartësit e tjerë të besimit monoteist, hebrenjtë. Kjo mirësi iu shpërblye, sepse krishterimi i



Në mes H. Ali Korça, Agjah Korça, Demir Dërsniku, Dervish Ibrahim, Faslli Çepani, Hajdar Sulejmani, Hambel Zejnuni, Ismail Haki Deveja, Jonus Zëmbaku

hershëm i mbrojti që të mos shuheshin në valët e baticave barbare. Rezultate pozitive u morën në kohët e reja edhe prej konvertimit masiv në besimin islam: “Në kohën moderne ishte Islami ai që i diferencoi shqiptarët nga popullsia për rreth, duke kryer në njëfarë mënyre, si një pritë e padepërtueshme ndaj dyndjes së kulturave të jashtme, funksion kulturor mbrojtës, çka ishte karakteristikë për krishterimin në kohën e lashtë dhe në mesjetë.”¹⁵

Një tjetër studiues, gjermani Peter Bartl, në librin *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare* (2006), e mbështet përfundimin e mësipërm duke vatrëzuar mbi rolin e madh të myslimanëve për pavarësinë e vendit, prej *Komitetit të Stambollit*, si pararendës i *Lidhjes së Prizrenit*, në lëvizjen kombëtare

15. Dela Roka, Maroco R., (1994), *Kombi dhe feja në Shqipëri*, fq. 42.

për shpalljen e pavarësisë, e deri në *Kongresin e Lushnjës*, pas të cilit fillon historia moderne e Shqipërisë.

Fara e mbjellë nga rilindësit, siç kishte ndjellë Naum Veqilharxhi, po jepte frytet e veta. Ndihej shtimi e forcimi i ideologjisë kombëtare në koloninë e Stambollit. Në këto çaste historike, paralelisht me lëvizjet politike të qershorit të vitit 1878, u ndie piskama e ideologut të madh Pashko Vasa, sepse në realitet shqiptarët po jetonin prej shekujsh në një diversitet kulturor dhe besimesh fetare.

Duke mos e penguar në fillimet e veta, në shekujt më pas duke e pranuar Kristianizmin monoteist, shqiptarët vijuan të ruanin lidhjet me besimet popullore pagane, të cilat intuitivisht i ndjenin afër. Raporte të tilla u ndërtuan më vonë edhe me Islamin. Duket

studiesja franceze Nathalie Clayer¹⁶ është më afër zgjidhjes së nyjes në lëmshin e së shkuarës sonë të begatë, kur thotë se është *albanizma*, si njësi nacionale, që arriti të përbashkojë të gjithë përbërësit identitarë në frymën e krijimit të kombit.

Të gjithë ata që nuk ecnin dot në këtë linjë do të qortoheshin qysh në fillimet e lëvizjes. “Të ngresh besimin fetar në parim kombësie dhe të marrësh dogmën për racë apo ritin për atdhe, nuk është aspak e pranueshme”, shkruante Pashko Vasa më 1879. Veç kësaj rilindasit nuk u pajtuan as me konceptin tjetër, që qarkullonte në disa teoricienë të kohës së tyre, sipas të cilëve një popull quhet komb kur ka formuar shtetin. Konceptin filozofik për kombin e formuloi në mënyrë më të plotë Abdyl Frashëri qysh në pragun e themelimit të *Lidhjes*. Në artikujt e tij, të botuar në pranverën e vitit 1878, ai shikonte si përbërës të një kombi gjuhën e përbashkët, territorin e përbashkët, historinë e përbashkët dhe jetën shpirtërore të përbashkët (të cilën ai e kërkonte jo në besimin e përbashkët fetar, por në besimet popullore, në fushën e dokeve, të zakoneve, të krijimtarisë popullore dhe të virtyteve të përbashkëta.

Veç letërsisë politike të botuar në këtë çast të madh të historisë sonë kombëtare, një vend të rëndësishëm në lëvizjen kulturore të viteve të *Lidhjes* zë letërsia popullore dhe artistike shqipe. Në letërsinë popullore një zhvillim shumë të begatshëm pati epika historike. Në qershor të vitit 1878, në ditët e themelimit të *Lidhjes*, u botua në

Aleksandri të Egjiptit vepra madhore e Thimi Mitkos *Bëleta shqiptare*, si thesar shpirtëror i kombit. Bashkë me këtë ngjarje letrare eci dhe krijimtaria artistike singulare.

Poema *Mori Shqypni* e Pashko Vasës dhe himni *Marsejeza* i Thimi Mitkos, u botuan në fletë qarkulluese dhe u shpërndanë në atdhe me anën e veprimtarëve të *Lidhjes së Prizrenit*. Pati gjithashtu krijime letrare, të cilat u përhapën në dorëshkrim midis bashkatdhetarëve, siç ndodhi me poemën *Shqipëria*, të Naimit.

Sipas vendimeve të kuvendit Forcat e Armatosura të *Lidhjes së Prizrent* duhej të ishin diku 190.000 trupa të organizuar në 380 batalione. Paralelisht me lëvizjet ideologjike, politike dhe ushtarake, u ndje më shumë se më parë nevoja e ngutshme për të formuar një shoqëri kulturore, e cila të merrte përsipër barrën e drejtimit e të organizimit të përpjekjeve për të ngritur shkolla shqipe në gjithë vendin dhe për të zhvilluar me ritme më të shpejta letërsinë shqiptare, duke botuar tekste shkollore, vepra letrare, broshura shkencore e organe periodike shqipe. Nismën për zgjidhjet e këtyre dy detyrave e mori drejtpërdrejt *Komiteti i Stambollit*. Për këtë qëllim ai formoi qysh në fillim të vjeshtës së vitit 1878 një komision të gjerë prej 25 vetësh, i cili ngarkoi një komision të ngushtë me 7 anëtarë (Sami Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Hasan Tahsini, Koto Hoxhi, Ibrahim Bërzeshita, Said Toptani), për të zgjidhur çështjen e alfabetit të përbashkët.

Ndërsa i vijuan përpjekjet për formimin e shoqërisë kulturore, atdhetarët u morën me çështjen e

16. Clayer, N., (2007), *Aux origines du nationalisme albanais*.

alfabetit, si gurkyç i qemerit që do ndërtonin. Në fillim të vitit 1879 para *Komisionit të Alfabetit* u paraqitën katër projekte të ndryshme për shkrimin e shqipes, të cilat u diskutuan, duke pasur parasysh kriteret shkencore, politike e praktike, që duheshin për gjuhën shqipe. Prej tyre komisioni miratoi projektin e Sami Frashërit, i cili ishte i ndërtuar sipas parimit fonetik (për çdo tingull një shkronjë) dhe sipas alfabetit latin, të plotësuar për tinguj të veçantë të shqipes me shkronja të huajtura nga alfabeti grek ose të sajuara nga autori. Projektet e tjera nuk u pranuan për arsye të ndryshme, ose pse mbështeteshin vetëm në alfabetin grek (J. Vreto), ose pse nuk i përmbaheshin parimit fonetik (P. Vasa), ose pse për përdorimin e tij duheshin shtypshkronja të posaçme (H. Tahsini).

Më 12 tetor 1879 konferenca vendosi themelimin e shoqërisë kulturore dhe miratoi kanonizimën (statutin) e saj, të cilën e nënshkruan të gjithë pjesëmarrësit. Zyrtarisht organizata u quajt *Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip*, kurse shkurtimisht u bë zakon të thirret *Shoqëria e Shkronjësëve*, ose *Shoqëria e Stambollit*. Kryetar i saj u zgjodh Sami Frashëri, kurse pjesëmarrësit e konferencës formuan *Këshillin Qendror të shoqërisë*. Programi i *Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip* u shpreh në mënyrë të qartë në kanonizimën e saj, të cilën e hartoi Jani Vreto. Ai nisej nga teza e shpallur qysh prej N. Veqilharxhit, se çdo komb që nuk e shkruan gjuhën e tij dhe nuk ka alfabetin e vet kombëtar është një komb i prapambetur. Aforizmi i Lajbnicit: “Më jepni një alfabet të mirë, unë do t’iu jap një gjuhë fort të mirë.

Më jepni mua një gjuhë fort të mirë dhe unë do t’iu jap një qytetërim shumë të mirë...” ishte shumë motivues, sepse qëllimi i shoqërisë ishte ta nxirrte popullin shqiptar nga prapambetja, duke zhvilluar arsimin kombëtar dhe letërsinë shqipe.

Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip nuk pati mundësi ta zhvillonte veprimtarinë e saj kulturore brenda Perandorisë Osmane dhe ca më pak në Shqipëri. Madje ajo u detyrua të kalonte në ilegalitet. Ndjekjeve u shpëtoi vetëm dega e *Shoqërisë së Shkronjësëve*, që u formua më 1880 në Bukuresht, e cila më vonë luajti një rol të rëndësishëm për plotësimin e programit kulturor të *Shoqërisë së Stambollit*.

Në këtë atmosferë kulturore Hafiz Aliu hyri nën ndikimin e lëvizjes, që filloi me themelimin më 1891 të revistës *Pasuria shkencore*, ku u mblodhën një grup intelektualësh sipas modelit perëndimor nën drejtimin e poetit Tefik Fitret (1867-1915), që synonin krijimin e artit të lartë në Turqi.

4. Veprimtaria shumëplanëshe në atdhe

Pas diplomimit, ai kthehet në atdhe për të filluar të kryente detyrat e veprimtarit kombëtar, së pari për të dëshmuar sa më shpejt Shqipërinë politike. Koha nuk priste, por njëherazi edhe për të hedhur baza të shëndosha për formimin më të mirë e më të plotë të bashkatdhetarëve të vet. Është koha kur forcohet roli i shoqërive shqiptare në të katër anët e diasporës, intensifikohet lufta për të mbajtur e përparuar shkollën shqipe, ndonëse qeveria osmane kishte shtuar represionin mbi

veprimtarët kombëtarë. Në gazetën e kohës mësojmë se *Mësonjëtorja e Parë Shqipe e Korçës*, ku punoi si mësues i turqishtes, ishte mbyllur, kurse drejtori i saj Nuçi Naçi, së bashku me të vëllanë e bashkëpunëtorin e vet, Leonidha Naçin, ishin dërguar në burgun e Manastirit. Në një pasus të shkëputur prej gazetës turke *Aksham* mësojmë se: “Si kush e din që Korça është çerdhja e llatinxhinjve. Atje ndodhet një çetë e fortë që prej një kohe të gjatë po merret me propaganda, mundohen për të ringjallur vetëqeverimin kombëtar. Tashti për me i derdh një sqfur në rrënjët e tyre, shkolla shqipe po mbyllet edhe kryetarët e tyre u internuan. Hafiz Aliu u internua në Spartën e Konjës, Orhan beu në Marash, Emin Milka në Urfa, Hysejn Qani Ballanca në Tokat, Sulejman Ohrija në Nigde dhe Thoma Mihal Markoja në Manastir”.

Megjithatë, ai çdo ditë e më tepër formonte fizionominë e vet politike, intelektuale dhe kombëtare. Në çastet e idolatriës turke, që shpalli *Hyrrijetin* (Liria) dhe vendosi *Kushtetutën*, duhej t’i përgjigjej një diplomaci elastike, gjë që Hafiz Aliu diti ta fitonte. Veprimtaria e tij e nxori atë në krye të lëvizjes duke u bërë një figurë me reputacion më shumë se krahinor. Fakt për këtë është propozimi që iu bë prej klubit të qytetit të vet për deputet në parlamentin e Turqisë. Pasi u zgjodh, ai ia delegoi këtë detyrë Shahin Kolonjës.

Veprimtaria e tij shumë e suksesshme e ngriti atë deri në vlerësime të tilla: “... me vepër shumëdimensionale, Hafiz Ali Korça”. Duhet të përmendet për përmbledhjen poetike *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë* (1924) dhe për poemën *Vajtimet*

e atdheut, për të cilat studiuesi Mahmud Hysa shprehet: “Është kjo poezi që për shumëçka lidhet me poezinë patriotike të Naim Frashërit”. Madje e quan “... mund të krahasohet lirisht me atë të Mitrush Kutelit”.

Monografi i Hafiz Ali Korçës, arabologu Ismail Ahmedi, te poema *Vajtimet e atdheut*, që i kushtohet Kosovës, zbulon esencën e domethënies së saj si “tragjedi kombëtare”. Në përfundim shpërshfaq eksplecitivisht motivimin e punimit shkencor: “Hafiz Ali Korça, me veprimtarinë politike, patriotike, iluministe-kulturore, po më tepër me veprimtarinë e pasur apo shumë të pasur letrare e publicistike, islamologjike-përkthyes, pedagogjike-tekstologjike na u imponua për një studim të veçantë në rrafshin makrostrukturor për dy arsye të veçanta:

1. Ai ka qenë një intelektual islam me kulturë dhe me vetëdije shumë të qartë kombëtare, që ka lënë një vepër të madhe dhe interesante, sidomos në fushë të islamologjisë shqiptare;

2. Për arsye se është ndër të rrallët po edhe ndër të vetmit që tërë kohën qëndroi besnik në parimet kombëtare, që gjithë betejën e zhvilloi në Shqipëri në mesin e armiqve dhe kundërshtarëve, po fatkeqësisht edhe ndër të vetmit krijues të fazës së fundit të Rilindjes Kombëtare dhe të letërsisë në mes dy luftërave botërore, vepra e të cilit padrejtësisht e paradoksalisht u anatemua, u përjashtua po edhe u injorua nga studiuesit tanë...”

Objektiviteti shkencor i punimit zbulon këtë dukuri të brendshme që shqetësonte dhe sëmurte shpirtin e Atdheut, virulenca e të cilit veproi jo

vetëm në pragshpalljen e Pavarësisë, pas krijimit të shtetit shqiptar, u plotësua me verbëri, gjatë periudhës në mes dy luftërave botërore, për t'u egërsuar me harrimin eksplicit gjatë periudhës së mbizotërimit të shurdhërimit ideologjik.

Studiuesit theksojnë se *Historia e shenjtë edhe katër halifetë* (1900), shkruar me poezi të rimuar, paraqet interes të madh për historinë islame në veçanti, si dhe për letërsinë shqipe në tërësi. Për ndonjë studiues vepra *Historia e shenjtë edhe katër halifetë* e këtij autori është poema më e gjatë në letërsinë tonë me 75 mijë vargje, duke ia kaluar edhe *Hadikashë* së Dalip Frashërit me 60 mijë vargje. Duhet të theksojmë këtu se "...model ka shërbyer poema *Shabname* e Firdusiut, që është gjithashtu mjaft voluminoze, po jo aq sa kjo e Hafiz Aliut. Bëhen përjasje me *Mevludin* e Hasan Zyko Kamberit, që s'është i plotë në këngë kaside, ndërsa *Mevludi* i Hafiz Ali Korçës ka edhe nota kombëtare. Studiuesit vërejnë mëvetësi në trajtimin e motivit kur'anor, sidomos në fund të poemës të trajtuar nga Kyçyku, Firdusiu dhe El Xhami.

Me përkthimin e dy veprave: *Gjylistani* të Sadiut dhe *Rubajijati* të Khajamit, që doli si ribotim i plotësuar më vete (janar-shkurt 2006), letërsia shqiptare bën të vetat kryeveprat e klasikëve më të mirë persianë. Përkthimet nga persishtja të Khajamit e të Sadiut, autori i ka qasur me shqipërimet e Fan Nolit dhe të Vehxhi Buharashë. Te shqipërimi i *Rubairave* të Fan S. Nolit, Hafiz Aliu vëren disa lëshime në shkrimin dhe leximin e fonemave persiane, dallon që Noli: "...nuk e njeh persishten për arsye se e pat shkruar Rushit në vënt

që duhej të shkruante Khurshid". Është fjala për pseudonimin letrar Rushit Bilbil Gramshi me të cilin Fan S. Noli nënshkruan botimin e dytë të shqipërimet të vet: *Edicje e dytë e ndrequr dhe e plotësuar*, Bruxelles, 1927, në përfundim të introduktës të së cilës pranon: "Rubairat persane nuk kanë shërbyer si bazë për këtë version, se shqipëronjësi nuk e ka shtudiuar persishten veç me një mënyrë pak a shumë të çalë po di ta këndonjë me ndihmën e leksikut për çdo fjalë pothua, dhe kështu ka mundur ta afronjë këtë përkthim më tepër pas tekstit, veçanërisht në *Rubairat*, në të cilat përkthenjësit e ndryshme nuk janë në një mendje sa për kuptimin e tyre. *Rubairat* e këti versionit, dy her' e ca më tepër se ato të versionit të parë, janë radhitur pas methudës Fitzgeraldiane. Shqipëronjësi po shtudion persishten dhe ka shpresë pas nja dy vjetsh, a nofta më shpejt të botonjë një version të tretë të plotësuar dhe më besnik pas tekstit. Pritja entusiastike e versionit të parë dhe lutjet e këndonjësvë e shtrënguan ta botonjë këtë version një mot më parë se sa kishte nër ment. Librasht, Vjeshtë, 1926. R.B.G."

Sidoqoftë, ai vlerëson punën, afnitetin e përkthimeve të Nolit, që i pranon si shqipërime me vlerë, duke qenë i ndërgjegjshëm për aftësitë krijuese të Nolit edhe në këtë plan të krijimtarisë së tij, por shton. "Zoti Rushit mund të ketë zotësi të ligjërojë si bilbili e ca më bukur se bilbili, si në shqipet edhe në disa gjuhëra tjera, porse në persishtet nuk mundet të ligjërojë aspak".

Pohimi i sinqertë i dhënë para treçerek shekulli të ngacmon edhe tani në përjasjen e dy personaliteteve...

Për veprimtarinë e dalluar kombëtare, arsimore, si teknokrat i drejtimit dhe përparimit të shkollës shqipe, po edhe si burokrat konsekuent për zbatimin e ideve të reja në lëmin e mësimdhënies, e antonomaziuan *Hoxha Tahsini i Ri*.

Ai zë vend të merituar në Lëvizjen Kombëtare, në historinë e arsimit tonë, të gjuhës, islamistikës, kulturës, publicistikës duke u dëshmuar si një personalitet i shquar.

4. 1. Kur nis mallkimi i madh

Cilësimi i historisë sonë si histori ekzistenciale ka dhe përbërësin e vet tragjik, sidomos në vlerësimin e veprimtarëve të vet kombëtarë, të cilët esencën e fisnikërisë shqiptare, burrërinë, sintezë e trimërisë me urtinë, e shfaqën si veti qenësore e jetësore kryekrejtet e fisit arbëror.

Fan S. Noli ka shpërfaqur të vërtetën që nuk vjetrohet, duke shënjuar fatin e mjerë e të njëjtë të tre heronjve: Skënderbeu, heroit që vdiq në shtrat, por pas fatkeqësisë familja e shoqëruar nga fisnikëria shqiptare dhe më pas edhe nga masat e gjera morën arratinë, Luigj Gurakuqi, e Bajram Curri; të tre shkrinë jetën për ideal dhe mbaruan, duke mos i parë realizimet e dëshiruara, për të paralajmëruar se do të vijonte të ndodhë. Poeti, thotë Ernest Koliqi, qan me lot burrërinë orëzesh shqiptare, duke ia nisur vajtimin që vijoi për gjysmë mileniumi. Lajtmotivi i thekshëm i jepte sinjale qiellit, sepse vajtonte ajo e pavdekshmja, nanlokja për Luigj Gurakuqin: “...*Nëno moj, mbaj zji për vllan, / Me tre plumba na i ran...* / ...*Se të deshte kur s’ të deshnin, / Se të qante kur të qeshnin / Se të veshte kur të çveshnin. / Nëno moj të*

ra dëshmor... / *Nëno moj ç’është përpjekur, / Gojë mjal’t e zëmër- hekur, / Syrgjyn gjall’ e syrgjyn-vdekur, / Ky vigan liberator”* dhe për Bajram Currin? “...*O Bajram bajrak i gjallë, / More nam me gjak në ballë, / Te një shpell’ e Dragobis. / Yll i rrall’ i burrëris...* / *Me zjarr Shenjt u ndrit kejo shpell, / Gjer në qiell u ngrit Kështjell / Për çlirimin e Shqipëris / Katakomb i Dragobis”*.

Mallkimi foli pa pra gjithkund gjatë, sa gjatë, ndaj të nëmurit dergjen!

Formimi i tij human, fetar e kombëtar, e vuri Hafiz Korçën në ballë të luftës kundër përhapjes së ideve bolshevike në vendin tonë në periudhën e viteve 1920-1930, pasojat e së cilës do t’i vuante pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në veprën *Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit*, konceptet e tij për ideologjinë marksiste-leniniste janë vizionare, sepse qysh herët hetoi rrezikun e përhapjes së kësaj ideologjie në Shqipëri dhe në tërë Evropën.

Analiza e tij lidhur me parimet njerëzore, të drejtat dhe liritë e njeriut, luftën e klasave, të drejtën për punë, vintë në piskamë gjenezën e komunizmit, karakteristikat dhe praninë e tij. Kjo vepër që shënon fazën e pjekurisë politike të Hafiz Korçës u kërkon bashkatdhetarëve që të shpëtojnë vetveten prej një indoktrinimi të rëndë. Të paktën ai vetë me ndërgjegje e boton këtë vepër, sepse: «Si çdo atdhetar dëshiron që shtetit dhe kombit të vetë t’i shërbejë sipas fuqisë që të ketë».

Në Stambollin multikulturor e multi-etnik, rryma internacionaliste, si degëzim i iluminizmit, nuk pati përhapje të gjerë. Më tepër u dëgjua atje rryma nacionaliste. Krejt ndryshe ndodhi në Shqipërinë e pas vitit 1920, ku gjeti

terren, mbiu e u shtri bolshevizmi, si derivat i iluminizmit, i sajuar nga shoqëritë masone. Shumë herët e kuptoi se bolshevizmi do të jetë rrezik për shoqërinë njerëzore në përgjithësi, për Shqipërinë dhe në veçanti për shqiptarin, që si tipar karakteristik ka individualizmin e tejskajshëm, i cili i bie ndesh mendësisë kolektivistë, sepse identifikon fisin me kombin, prandaj kësaj teme do t'i kushtojë një vepër të veçantë, e cila ka disa botime. *Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit*, Tiranë, 1925, botim i parë; *Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit*, Albanian Islamic Center, Harper Woods, Mich. USA, 1993, nën kujdesin e imam Vehbi Ismailit, botim i dytë; *Bolshevizmi është shkëputur i njerëzimit*, përshtati dhe e përgatiti për shtyp Prof. dr. Feti Mehdiu, Prishtinë, 2001, botim i tretë.

Qysh në hyrje të punimit autori ndërthur një litotë e një hiperbolë, duke marrë një situatë të pazakonshme dhe ku mrekullia ndodh si një rëndomësi: “Mizën e dheut e pyetën, ku po shkon? Ajo u përgjegy: -Në Qabe. I thanë: -A me këto këmbë të holla do të shkosh? Ajo u përgjegy: -A jam nisur me këtë qëllim të mirë, edhe në mos arrifsha deri atje, sevapi i haxhillëkut më shkruhet”. Dëshmohej mes këtij dialogu tipari bazë i letërsisë fantastike, duke u futur në hullinë e shenjzimit te realës. Përdorimi i figurës stilistike të hiperbolës jo vetëm në krijimet artistike, por dhe në të folurit bisedor, bëhet mënyrë komunikimi, duke shënuar hapje kah legjendarizimi në të folur, i cili arrin deri të prekë gjithë një diskurs.

Legjendarizimi ka prekur diskursin e esesë *Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit*, që bëri aq bujë në atë periudhë historike,

kur botoheshin njëherazi si letërsi gojore ashtu edhe ajo e shkruar me mëtime krijuese singulare, po të përdorim termat e E. Çabejt. Kjo dukuri dëshmon për përmasat ireale të komunikimit publik, përkundrajt një përmase më reale në komunikimin intim.

Për t'u bërë i pakontestueshëm, autori i vë përballë Ajetit nga sureja Shura, ku flitet për shtresat me diferencime shoqërore, të cilat e motivojnë njeriun të garojë për të fituar dhe shtuar pasurinë, falsitetin e ideologjisë së barazisë materiale të propaganduar nga doktrina komuniste. Themelet e saj autori ia kushton Karl Marksit, si figurë e shkrimit, që humb shenjat e reales, sepse është internacionaliste, pa vend konkret dhe përditësohet në kohë utopike. Duke qenë e feksur prej autorit, Karl Marksi merr vlerësimin negativ maksimal, sepse ai kishte përgatitur *kejajmetin e madh*, shkëputimin.

Vihen këtu përballë dy besimet e mëdha monoteiste, besimi fetar hebre dhe ai islam, që janë në pole të kundërta. Në nivele të tilla të vlerësimit negativ paraqitet edhe Lenini.

Bolshevizmi, sipas autorit, do t'i marrë individit lirinë parake për të pasur pronë, duke i mohuar fenë dhe moralin. Legjendarizimi ideologjik i vjen në ndihmë autorit për të treguar se kjo doktrinë agresive është ateiste dhe madje imorale: “Ka edhe disa çështje të fëlliqura prej të cilave penda turpërohet e dridhet”, - mbyll mendimin e vet autori.

Në kapitullin *Shkatërrim i Bolshevizmit*, kalon në përmase më reale kur përdor faktet, duke iu shmangur legjendarizimit, për t'iu kthyer hiperbolës në vargun:

Me lot prej gjaku vëllezër qani!

Aq shumë e vë në funksion mënyrën e komunikimit legjendarizues sa duke e vënë në themel mbizotërimin e vetëdijes islame si besim kolektiv, e lë pa e peshuar mendimin vetjak, kur krijon pyetjen retorike: *Tufanit të bolshevizmit veç fesë kush i bën ballë?* Fundi i shkrimit përsëri i kthehet situatës së pazakontë e mrekullisë, ku çudia përcillet si realitet i jetuar mijëra vite më parë, kur u përditësua kjo doktrinë antifetare e antihumane, por që përfundoi si një fantazi.¹⁷ Eseja ishte ajo që italianët e thërrasin *Canto del cigno* ose kënga e mjellmës, e cila para se të mbarojë jetën e vet këndon melodinë më të bukur.

I lidhur pazgjidhshmërisht me Korçën, kur e ndjeu se kishte kryer diçka të vlefshme, u mbiquajt Hafiz Ali Korça, siç kishin bërë më parë vëllezërit Frashëri apo Shahin Tekiu (Kolonja). E nënshkruan kësioj edhe veprën e vet eseistike *Bolshevizma çkatërrim i njerëzimit*, që e boton në vitin 1925 te shtypshkronja *Mbrothësia* e Kristo Luarasis, e cila asokohe kishte kaluar në Tiranë.

Vuajtjet, persekutimi, shkretime, qëndresa, madje edhe vdekja e tij janë një mit modern. Balta e hedhur mbi të padrejtësisht, prej sfinksit që shtirej si Zeus politeist, ndërsa dëshmohej monoteist fanatik i idesë shurdhake, u la prej shirave të pastër qiellorë. U varros, së paku, në Shqipërinë e vet, së cilës i kushtoi tërë jetën. Kjo nuk është pak, kur kujtojmë historinë tonë të dhimbshme kombëtare.

5. Dheu që nuk fle pret t'u dhurojë prehjen e përjetshme

I dënuar nga fanatikët, i urryer nga përkrahësit e tyre Hasan Tahsini vdiq në mjerim e shkreti, në skamje dhe tuberkular. Vendi i huaj, të cilit i kishte dhënë universitetin e parë, i fali një varr. Shkrimtarë të rinj turq edhe sot e vajtojnë fatin e tij duke shkruar: *Evladë Ajalden ve kimsesiz ollarak vefat eti* (Vdiq në vetmi pa pasur as bir as bijë).

I këndojnë në vendlindje, ndërsa varri në Stamboll, me gjithë interesimin e familjarëve, nuk po i gjendet ende. Na ka paralajmëruar për këtë gjëmë në një shkrim të vetin Lumo Skëndoja, botuar në fletoren *Lirija* në vitin 1910: “Në këto varre (i them shokut që kam pranë), kemi dy shqiptarë: Hoxhë Tahsinin dhe Sami Beun. Të parit për fat të keq, nuk dimë ku i dergjen eshtrat...”.

Është mallkim i rëndë kur dëgjon: “I humbtë varri!”

Hafiz Korça i dëbuar nga Korça prej fanatikëve, i dënuar prej masonizmit ateist, dergjet në Kavajë dhe jo në vendlindje, në Korçë.

Dantja, si i pari i Rilindjes italiane, u dënuar të mos kishte varr në Firencën e tij të ndritur. E pati këtë fat Ravena aty pranë. Hafiz Korça, si i fundmi i Rilindjes sonë dhe me aq shumë kontribute në periudhën e krijimit të shtetit shqiptar, dergjet në Kavajë. Sipas një riti të lashtë të krahinës së Korçës, kur dikush nisej për në kurbet, i jepnin me vete një qese me dhe, që t'ia hidhnin në arkëmort, përndryshe mbetej i patretur. Të jetë tretur vallë në qytetin që i dha bukë e paqe në pleqërinë e rëndë edhe Hafiz Korça? Qyteti ynë i ka borxh Birit të vet dinjitar, që i solli

17. Hamiti, S., (2010), *Poetika Shqipe*.

atdheut vepra me *vlera të larta politike, patriotike, edukative, arsimore, letrare, gjubësore, përkthyes, historike, publicistike, kulturore, islamistike etj.*, - të gjitha këto në shërbim të shoqërisë njerëzore përgjithësisht dhe të shoqërisë shqiptare veçanërisht.

Të dyja këto figura të mëdha i kemi parë në vështrimin virtual, se çfarë bënë ata për t'i shërbyer ideologjisë së Rilindjes sonë Kombëtare. Hafiz Korça vijoi shërbimin e vet kombëtar edhe në periudhën e shtetit shqiptar, për të marrë në fund të jetës së vet nëmën diktatoriale. Realiteti sot kërkon të dëshmojë se çfarë duhet të bëjë Atdheu për ta. Detyrimi është i shenjtë.

Korça e përkundi dhe e rriti, e formoi dhe e nisi në udhën e Lirisë. Si peng nderimi lypset t'i falë prehjen e amshuar.

Përfundime

1. Në fillim të viteve '80, ndërkohë që punoja disertacionin mbi historikun e romanit shqiptar, ku një rol nismëtar kishte Foqion Postoli, akademiku Jorgo Bullo më sugjeroi që paralelisht të mblidhja të dhëna në publicistikën e kohës, edhe mbi Hafiz Ali Korçën. Emri i tij dilte aq shpesh deri me mbarimin e Luftës II Botërore. Pas fillonte heshtimi vrashtar. E dija se si e cilët e përdornin atë mjet të lashtë, ndaj m'u duk se diçka nuk shkonte. Gjatë hulumtimit në bibliotekën e Korçës, më e vjetra në Shqipëri, pasi iu riktheva përimtimit, zbulova edhe më shumë për të, madje në shumë çaste historike më dilte të kishte bashkëpunuar me Foqion Postolin, eshtrat e të cilit prehen në varrezat e dëshmorëve të atdheut në Korçë, të dërguarin e Fan S. Nolit

për përditësimin e Kishës Autoqefale Shqiptare në Atdhe. Gjeta shtëpinë ku kishte lindur dhe ishte rritur, bashkëbisedova me disa pasardhës të tij, mësova nga fqinj të moshuar që kishte vdekur i nëmur në Kavajë, ndërsa herë pas here, bashkëqytetarë prej familjeve të nderuara më sillnin libra të tij, të cilat ishin ruajtur me kujdes e dashuri. Në vigjilje të *anno miraculum* që i shënjoji fundin ateizmit shtetëror, munda të gjej *Ervebenë* e M. Kyçyikut, ribotim i shtypshkronjës *Mbrothësia* në Selenik, *Jusufi dhe Zelihaja* të Hafiz Korçës dhe esenë *Bolshevizma çkatrrim i njerëzimit*.

Atdheu i marrakotë dhe kombi, asokohe, do të niste leximin kuptimor të maksimës së Faik Konicës. Armiku më i madh i shqiptarëve, shkaktari, ishte në njëjës, madje i individualizuar e legjendarizuar. I kishte bërë gjëmën, siç këndon Gj. Fishta: *Kurr të keqen pa ia da:/ rribe, e mos e len me keja: / me i u dhimhtë, po, minit n'mur,/ me i u dhimhtë gjarpnit nen gur!* (LAHUTA E MALCIS, Kanga e parë: *Cubat*)

2. Në krye të viteve '90, nisa të botoj për Hafiz Korçën në gazeta, revista dhe të kumtoj në simpoziume shkencore, madje t'i çel një hapësirë prej rreth 15 faqesh në tekstin universitar *Letërsia e Vjetër dhe e Re Shqipe*, redaktor i të cilit është Koçi Petriti. Si kryetar i Komisionit të *Arsim-Kulturës dhe Sportit* të këshillit bashkiak të qytetit Korçë propozova rivlerësimin e figurës së tij. Më pas gjeta monografinë e Dr. Ismail Ahmedit: *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, Logos-A, Shkup, 1999. Madje, miq të nderuar nga Tetova e Shkupi më informuan asokohe se po punohej për veprën e plotë të Hafiz Korçës, një provë e fortë kombëtare e

fetare se Shqipëria politike është vetëm një pjesë e Shqipërisë kulturore.

E sollli rasti apo u punua për ta pritur atë, e rëndësishme është të feksohet që akademiku Jorgo Bullo, pasardhës i Çajupit, dhe profesori Ismail Ahmedi, nga Tetova, kryeqendra e Gegërisë lindore, të takohen në vendlindjen e Hafiz Ali Korçës, në universitetin *Fan S. Noli* të qytetit të Korçës, me rastin e

kësaj ngjarjeje kulturore, patriotike dhe humane, në vitin e uruar të 100 vjetorit të Pavarësisë.

Nderi ju ndjekë Ju që përkujtoni e ndieni për detyrë të përkuleni në shenjë respekti të pamasë në birin dinjitar të qytetit të Mësonjëtores së Parë Shqipe, dhe jo vetëm në Atë!

Paçi bekimin dhe marçi uratën e Atdheut!

Bibliografia

- 1 Balli, K., (2008), *Antologji me prozë të shkurtër të Qarkut Korçë*.
- 2 Bica, L., (2009), *Profesor Hasan Tahsini*.
- 3 Camaj, M., (1994).... Toena, Tiranë, f. 75.
- 4 Clayer, N., (2007), *Aux origines du nationalisme albanais*.
- 5 Dela, Roka, Maroco R., (1994), *Kombi dhe feja në Shqipëri*, fq. 42.
- 6 Durham, M. E., (1905), *The Burden of Balkans*.
- 7 Frashëri, S., *Kamus V*.
- 8 Gjergji, A., (2002), *Mënyra e jetesës në shekujt XII – XX*.
- 9 Hamiti, S., (2010), *Poetika Shqipe*.
- 10 Jorganaxhi, Zh., (2005), *Gaqo Jorganaxhi dhe grupi "Lira"*.
- 12 Karmitses, H., (1888), *Geografia tis Koricas ke tis perioikidos pros brisin ton katoteron takson*.
- 13 Kodiku, dok. 71.
- 14 Kolevica, P., (1992), *Lasgushi më ka thënë...*
- 15 Mile, L., (2001), *Zejtaria fshatare shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare*.
- 16 Mitko, Th., (1834), *Topografia e Korçës*, "Fiamuri i Arbërit", Nr. 9.
- Mitko, Th., (1923), Vepër. cit., f. 548; N. D. N., Vepër cit.
- 17 N. D. N., (1923), *Korça dhe katundet e qarkut*.
- 18 Ombashi, R., (2002), *Po vjen Noli...*
- 19 Pellegrini, B., (1906), *Verso la Guerra? Il dissidio fra l'Italia e l'Austria*.
- 20 Pepo, P., *Dy dokumente...* Pepo, P., (1972) *Materiale dokumentare për ambientin shoqëror të Varoshit të Korçës*, "St. historike/1".
- Pepo, P., (1966), *Një letër e korçarëve e vitit 1845 drejtuar N. Veçilbarxhit në Rumani*, "St. Filologjike/1".
- 21 Riza, E-Strazimiri, G., (1972/3), *Vështirim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës*, "Monumentet".
- 22 Shkodra, Z., (1973), *Esnafet Shqiptare* (Shek. XV-XX).
- Shkodra, Z., (1984), *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*.
- 23 Thomo, P., (1988), *Korça, urbanistika dhe arkitektura*.
- 24 Zoi, N., (2001), *Një faqe historie*.

Një shqiptar në shërbim të njerëzimit: Mehmet Akif Ersoj

MA. Eduard Caka

Abstrakt

Në këtë shkrim synohet të prezantohet tek lexuesi shqiptar mendimtari, poeti dhe aktivisti i madh turk me origjinë shqiptare Mehmet Akif Ersoj. Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin që, Mehmet Akifi është dëshmitar i shekullit më të gjatë të perandorisë Osmane i mbushur me dhimbje e vuajtje për të gjithë kombet që e formonin atë. Vetë poeti është dëshmitar dhe vuajtës i kësaj periudhe të vështirë, aspekt i cili e bën të rëndësishëm studimin e tij. Duke patur parasysh faktin që publiku i gjerë shqiptar nuk ka shumë dijeni rreth Mehmet Akifit këtu është trajtuar në vija të përgjithshme, pa u thelluar e pa bërë analiza të hollësishme jeta, krijimtaria e sistemi i mendimit të tij.

a. Koha e Akifit

Mesi i shek. XIX karakterizohet nga një vazhdë ngjarjesh të mëdha brenda Perandorisë Osmane, të cilat do e arrijnë kulmin me luftën ballkanike, shpërbërjen e kësaj Perandorie dhe si përfundim i këtij procesi shpalljen e republikës Turke. Në aspektin politik e administrativ mund të thuhet që revolucioni Grek, lufta Ruso-Osmane, e më vonë formimi i Aleancës Ballkanike ishin faktorë kritikë që çuan në dobësimin ushtarak të Perandorisë. Lëvizjet nacionaliste dobësuan në mënyrë ekstreme fuqinë administrative e ushtarake të perandorisë, e cila përballej deri me një pushtim të vetë qendrës së saj. Mjafton të kujtojmë që u pushtua pothuajse e gjithë Turqia e sotme nga fuqitë e ndryshme, madje

edhe Bursa që ishte kryeqyteti i parë i perandorisë me një distancë rreth 200 km larg Stambollit. Në anën tjetër dalja në skenën politike ndërkombëtare e fuqive të tjera të mëdha (duke patur parasysh që deri atëherë në Ballkan sundonte vetëm Perandoria Osmane), e në veçanti Perandoria Austro-Hungareze dhe Rusia (të cilat kishin interesa të drejtpërdrejta), do të krijonin një ekuilibër të ri të politik në gadishullin e Ballkanit. Thënë në një mënyrë tjetër, ekuilibri dhe sistemi politik e administrativ brenda Perandorisë Osmane dhe veçanërisht në Ballkan nuk ekzistonte më. Për më tepër suksesi i revolucionit francez dhe i republikës si formë qeverisjeje, vinte në pikëpyetje dhe monarkinë si formë shteti, që për një pjesë të mirë tanimë ishte *de mode*. Vetëdija që ndezi revolucionin francez krijoi konfuzitet në përbërjen shumëkombëtare që formonte shoqërinë osmane. Veçanërisht shtetet ballkanike u vunë në pararojë të kësaj lëvizje me pasojë shpërbërjen e vetë perandorisë. Për më tepër dhe vetë kasta intelektuale e perandorisë ishte pesimiste në nevojshmërinë e vazhdimësisë së perandorisë.

Në aspektin ekonomik gjendja e perandorisë dhe e kombeve, që e formonin atë ishte tepër e vështirë. Zhvillimi i rrugëve detare ishte një goditje e madhe ekonomike për perandorinë, e cila ishte një urë lidhëse mes lindjes e perëndimit, e që Turqia përfitonte shuma të konsiderueshme vetëm nga doganat. Tashmë ky sistem nuk funksiononte më. Modernizimi dhe zhvillimi ushtarak i perëndimit dhe prapambetja e perandorisë në këta dy

fusha, që kishin në themel ekonominë, e bënte të domosdoshme një reformë të gjerë në Perandorinë Osmane. Industrializimi, i cili i dha një hov të madh ekonomisë evropiane në Perandorinë Osmane nuk ndodhi dhe pse perandoria bëri përpjekje të rëndësishme siç ishte vetë Tanzimati. Sistemi i Tanzimatit ishte përpjekja e fundit me konsensusin e intelektualëve osmanë, për të ndërtuar një ekuilibër të qëndrueshëm në gjendjen e dobët ekonomiko-politike, në të cilën perandoria gjendej. Lindja e burimeve të largëta ose kolonizimeve pati një impakt të madh në pasurimin e zhvillimin ekonomik të fuqive të mëdha, e në anën tjetër një varfërim të ekonomisë Osmane, e cila deri atëherë ishte tregu furnizues i fuqive të tjera. Një faktor tjetër tepër kryesor në varfërimin e perandorisë ishte dhe angazhimi në shumë luftëra, apo aksione ushtarake brenda dhe jashtë perandorisë, të cilat përbënin fatura tepër të mëdha për buxhetin e Perandorisë Osmane.

Një përbërës tjetër shumë i rëndësishëm i jetës sociale brenda perandorisë Osmane, që ishte në një moment krize ishte dhe elementi kulturor. Duke patur parasysh modernizimin dhe përparimin në aspektin ekonomik e kulturor të shoqërisë perëndimore, një pjesë e mirë e intelektualëve osmanë, pësuan një panik, i cili u pasua me një krizë identiteti. Sidomos në fillim të viteve 1900, kjo krizë pësoi rritje tek intelektualët, ku në popull do të pasqyrohej me një imitim apo dhe adhurim të kulturës perëndimore. Kultura e salloneve, veshjeve, të folurit e frëngjishtes, muzika e shumë elemente të tjerë, ishin moda e kohës, e cila depërtoi deri brenda Portës së Lartë. Në këtë

kontekst, edhe grupi i intelektualëve me konservatorë do të karakterizohet nga momente mëdyshjesh. Edhe vetë tek Akifi, apo tek kategoria e mendimtarëve të ngjashëm me të, vihen re luhatje, apo mëdyshje në vijën e mendimit apo shkrimet e tyre. Kjo mëdyshje, asnjëherë nuk duhet kuptuar në ndryshim, apo mëdyshje qëllimi, apo bindjeje, por në luhatje të përkohshme ndoshta edhe me karakter emocional. Duke parë ndryshueshmërinë mes përkatësisë fetare të perëndimit e asaj të Osmanëve, e cila përbënte dhe identitetin kryesor të përkatësisë brenda perandorisë, një pjesë e mirë e intelektualëve nisën të pëshpërisin më tepër madje dhe të debatonin disa elemente, që deri atëherë ishin tabu. Qasja e shteteve të reja evropiane kundrejt kishës dhe vendosja e laicizmit e prangosja e fesë, si një element mes personit dhe Perëndisë, si një prej shtyllave kryesore të shteteve perëndimore ishte një tjetër shkak debatesh të mëdha tek intelektualët osmanë.

Ja pra, Mehmet Akif Ersoj lindi në një periudhë të vështirë ekonomike, politike e kulturore për shoqërinë, perandorinë e qytetërimin të cilit i përkiste. Padyshim, që këta elemente do të ndikojnë thellësisht në jetesën, në formimin intelektual, për pasojë dhe në poezinë e tij. Si një person aktiv dhe i ndjeshëm ndaj problemeve të shoqërisë, shkrimi, mendimi, aktiviteti dhe përpjekjet e Mehmet Akif Ersojit duhet të trajtohen në këtë kontekst.

b. Një jetë plot përpjekje

Sipas të dhënave, Mehmet Akif Ersoj lindi në lagjen Fatih të Stambollit, në muajin Shevval të vitit 1290 Hixhri

(Nëntor ose Dhjetor 1873) dhe ndërroi jetë më 27 Dhjetor 1936 po në Stamboll. Babai i tij Tahir efendiu ishte i biri i Nuredin Agait nga fshati Shushicë e Pejës dhe njëri ndër mendimtarët e kohës. Në të njëjtën kohë ai ishte dhe mësues në medresenë e Fatihut në Stamboll. Siç shprehet dhe vetë Akifi, mësimet e para dhe në veçanti leximin e Kur'anit dhe gjuhën arabe i ka mësuar nga babai i tij. Ndërsa e ëma e Mehmet Akifit ishte zonja Emine Sherife me origjinë nga Buharaja.¹ Po të vihet re familja e tij është një shembull tipik i shoqërisë osmane; babai nga perëndimi, nëna nga lindja, që jetojnë në metropolin e botës, në Stamboll. Këtë aspekt e thekson dhe njëri ndër poetët më të mëdhenj turq Sezai Karakoç, i cili shprehet që, si në anën biologjike, ashtu dhe në atë intelektuale, Mehmet Akif Ersoji përbën një sintezë mes Lindjes dhe Perëndimit.

Për sa i përket jetës së tij familjare dimë që Mehmet Akifi është martuar në moshën 25 vjeçare me zonjën Ismete. Edhe pse patën një jetë të vështirë në aspektin ekonomik, duke patur parasysh faktin, që Mehmet Akifi i harxhonte të ardhurat për idealet e tij, mësojmë që patën një jetë të lumtur familjare. Këtë aspekt Mehmet Akifi e thekson dhe në një poezi, të cilën ai i dedikon bashkëshortes së tij. Nga martesë e tyre mësojmë që patën 6 fëmijë, emrat e të cilëve ishin Xhemile, Feride, Suat, Ibrahim Naim, Emin dhe Tahir.

1. Ersoj, Mehmet Akif, *Safabat*, Akvaryum Yayinevi, İstanbul 2006, s. XIII; Për të dhëna më të detajueshme rreth jetës, shkrimeve dhe veprimtarisë së Mehmet Akif Ersojit shiko dhe përkthimin Shqip të Safahatit: Ersoj, Mehmet Akif, *Fletët*, Përkth. Mithat Hoxha, Logos-A, Shkup 2006:66.

Në lidhje me karakterin, jetën dhe veprimtarinë e tij na kanë ardhur shumë dokumente, ku më të rëndësishmet janë kujtimet e shokëve e miqve të shumtë të tij. Madje dhe vetë djali i Akifit ka shkruar në lidhje me jetën e të atit, duke prekur deri te anët më private të familjes, gjë që e bën më të thjeshtë dokumentimin dhe shkrimin e jetës së Akifit. Sipas kujtimeve të miqve të tij mësojmë që, përveç anës zyrtare të Akifit, në të cilën ai njihet si tepër serioz, madje dhe i vazhdë në jetën personale por me miqtë na paraqitet shumë i gjallë. Ai kishte një interes dhe dije të hollësishme rreth muzikës lindore e perëndimore, merrej me sporte të ndryshme, si hedhjen e gjyles, mundjen dhe ecjen në distanca të gjata. Ai ishte gazmor në biseda, madje bënte edhe shaka e batuta me miqtë e tij. Sipas kujtimeve të shumta, del në pah se bisedat apo takimet me miqtë e tij, karakterizoheshin nga recitimi i poezive, këndimi i ilahive e këngëve të ndryshme.² Ai ishte shumë korrekt dhe i përpiktë në marrëdhëniet me miqtë dhe njerëzit e tjerë që e rrethonin. Nga kujtimet rreth tij, mësojmë që kjo anë përbënte njërin ndër virtytet më të rëndësishme që e karakterizonin atë.

Ai kishte mbaruar shkollën e veterinarisë, por gjatë jetës së tij përveç shkrimit do të ushtronte punë e detyra të ndryshme si: mësues i gjuhës turke në shkollë të ndryshme, punonjës i shtetit, mësues letërsie, deputet, pjesëmarrës në luftë, drejtues fetar, shkruar për revista, pjesëmarrës dhe drejtues në organizata të ndryshme, si dhe ka

2. Çantay, Hasan Basri, "Anılarda Akif", *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özal Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:541.

udhëtuar si i ngarkuar nga shteti në vende të ndryshme, si Berlin, Egjipt, Liban, Arabi, Shqipëri etj.³ Në ditët e sotme nxirret në pah vetëm ana poetike e Mehmet Akif Ersojit, ose më mirë vjersha, që ai shkroi e që u zgjodh si himni i Turqisë. Por edhe ana aktiviste e tij ishte tepër e rëndësishme. Mjafton të përmendet fakti që, ai dhe pse ishte i angazhuar në punë nuk mund të rrinte duarlidhur dhe mori pjesë në luftën e Çanakkalasë. Pas lufte ai do të marrë pjesë në parlament, duke mbrojtur të drejtat e qytetarëve të vendit të tij. Kur e kërkon nevoja ai do të lëvizë çdo cep të vendit për t'i udhëzuar ose për t'u transmetuar atyre dijet fetare. Po me vendim parlamenti dhe me propozim të Bashkësisë së Punëve Fetare ai u caktua të bëjë përkthimin e Kur'anit më 21 Shkurt 1925.⁴ Do të bashkëpunojë dhe në një revistë të rëndësishme për kohën si *Sebilürreşad*, ku në shumicën e rasteve do të përkthejë dhe dijetarët e kohës në gjuhën turke për t'i prezantuar mendimet e tyre rreth problemeve të kohës. Pra veprimtaria e tij është e lidhur ngushtë me të gjitha problemet e nevojat e kohës.

Karakterit dhe virtytet e tij ishin të qarta e të pastra. Ata ishin stolisur me besimin e tij, Islamit. Nga kujtimet për të del në pah se faktori më kryesor i karakterit të tij ishte besa ndaj vendit, shoqërisë e miqve të tij. Poezitë e tij janë shkruar gjithmonë për të tjerët. Të gjithë

3. Për të dhëna më të detajuara rreth jetës së Mehmet Akifit shiko: Kara, Mustafa, *İstiklalimizin Büllülü Mehmet Akif Ersoy*, Özal Matbaası, İstanbul 2012:11-39.

4. Okay, M. Orhan, Düzdağ, M. Ertuğrul, "Mehmet Akif Ersoy Maddesi", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXVIII, Ankara, s. 433.

miqve të tij ai iu ka dedikuar poezi. Të gjithë shokët e tij flasin për bujarinë e madhe që e karakterizonte Mehmet Akif Ersojin. Duke patur parasysh se kur ishte në moshën 14 vjeçare i ishte djegur shtëpia dhe të gjithë jetën e kishte kaluar në shtëpi me qira, ai ishte shumë bujar me të tjerët. Ja çfarë transmeton një mik i tij: “Një natë na pati ftuar për çaj në shtëpinë e tij. Teksa po bëheshim gati të shkonim, ai po vinte me shpejtësi drejt nesh dhe tha: sonte çajin do e pimë te ju. Padyshim që u gëzova por dëshiroja të dija dhe arsyen. Kur e pyeta m’u përgjigj duke qeshur: qilimin e dhomës sonë ia kishin dhënë një të varfëri.”⁵

Akifi kishte një jetë tepër të vështirë dhe shumë herë me pengesa, por të gjitha këta nuk përbënin asnjë pengesë për të sepse ai kishte një mision tepër të qartë. Në aspektin ekonomik ai pati një jetë të vështirë për arsye se kur ishte në moshë të re atij iu dogj shtëpia dhe paskëtaj të gjithë jetën do e kalonte me qira, sepse të gjitha të ardhurat e veta do t’i harxhonte në shërbim të idealeve të tij. Edhe vdekja atë e gjeti në shtëpinë e njërit ndër miqtë e tij më të afërt, Said Halim Pashës, i cili ishte nipi i Mehmet Aliut të Egjiptit, pra me origjinë shqiptare.⁶ Tek ai nuk ka nënshtrim. Akifi nuk hesht kundrejt padrejtësive. Këtë e shohim në poezinë e tij, por dhe në jetën e tij. Transmetohet që, kur ai ishte nëndrejtor në një shkollë dhe në një rast kur drejtori i shkollës pezullohet nga puna në një mënyrë të padrejtë Mehmet Akifi jep menjëherë dorëheqje si reagim kundrejt kësaj padrejtësie.⁷

5. Çantay, s. 527-528.

6. Özalp, N. Ahmet, *Said Halim Paşa: Tüm Eserleri*, Anka Yay., s. 7.

7. Çağın, Sabahattin, “Akifin Kişiliğine Dair”,

Ai i njihte nga afër problemet e kohës dhe pikërisht kjo arsye e shtynte atë të ishte tepër i ndjeshëm kundrejt këtyre problemeve. Vetëm në këtë kontekst mund të shpjegohet veprimtaria, poezia dhe jeta e Mehmet Akifit.

Për të kuptuar dhe një herë karakterin e Mehmet Akif Ersojit mjafton të shihet dhe mënyra e shkrimit të Himnit të Flamurit. Nevoja për një himn u zyrtarizua me një shpallje gare nga parlamenti më 7 nëntor 1920 dhe u caktua një shumë prej 500 lirash, si shpërblim për fituesin e konkursit. Hasan Basri Çantaji rrëfen se propozimeve për pjesëmarrje Akifi i refuzonte, duke thënë se pas kësaj moshe nuk futej në garë e të merrte dhe para për diçka tepër të rëndësishme siç ishte himni. Dhe pse pranë parlamentit u dorëzuan mbi 700 vjersha të ndryshme, asnjëra nga ata nuk u pa në lartësinë e duhur për t’u bërë himn kombëtar. Dhe pse i ishte shkruar një kërkesë zyrtare për të marrë pjesë në konkurs, Akifi e kishte refuzuar atë. Me një “lojë” të mikut të tij Hasan Basri Çantajit, sikur i kishte dhënë fjalë në emër të Akifit zyrtarëve për shkrimin e himnit me kusht që të anullohej kushti i shpërblimit për fituesin, u bë e mundur që Mehmet Akif Ersoj të ndërmarrë hapin për shkrimin e himnit, të cilin e mbaroi në dy ditë dhe që u pranua njëherazi nga parlamenti me 12 Mars 1921.⁸ Poezinë e himnit ai e ka lënë jashtë librit të tij Safahatit, duke thënë që atë e ka lënë në zemrën e kombit turk.

Ai bëri një jetë tepër aktive, sepse Akifi ishte i vetëdijshëm, që në rrethanat në të cilat gjendej qytetërimi

Karakter Abidesi ve Bir Çağlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:618.

8. Okay, Düzdağ, s. 433.

i tij, nuk kishte kohë për të humbur. Ai do të kontribuonte me jetën, pasurinë, mendimin, poezinë e shpirtin e tij, deri në frymën e fundit për idealet që ai mbartte. Kontributi dhe veprat e tij duhen trajtuar në mënyrë tepër të kujdesshme, sepse kjo ishte periudha kur një perandori qindra vjeçare do të kthehej në një republikë. Në këtë proces detyra më e rëndësishme binte mbi intelektualët, të cilët me shkrimet, konferencat apo ligjëratat e sjelljen e tyre, duhet të motivonin një shoqëri të dobët psikologjikisht e materialisht. Në këtë kontekst duhet të shihet dhe veprimtaria e tij, e cila pasqyronte karakterin e poetit të madh.⁹

c. Një stil i veçantë shkrimi

Para se të trajtojmë anën teknike të shkrimeve të Mehmet Akif Ersojit, le të hedhim një sy mbi shkrimet e tij në përgjithësi. Ai ka nisur të shkruajë që në moshën dymbëdhjetë vjeçare dhe poezitë e tij janë botuar në revista të ndryshme, qëkur ai ishte në shkollë. Një pjesë e mirë e shkrimeve të tij u botuan në revista të ndryshme si *Resimli Gazete*, *Serveti Fünun*, e që nuk janë brenda *Safahatit*. Mendimet e tij politike kryesisht janë në formën e shkrimeve, kritikave, apo dhe përkthimeve të ndryshme të botuara në revistat *Sırat-ı Müstakim* dhe *Sebilü'r-Reşad* në të cilat ka qenë aktiv.¹⁰ Vepra më kryesore e tij *Safahati* përbëhet nga shtatë libra të

botuara veç kur ishte ai gjallë dhe të përmbledhura në një vëllim të vetëm pas vdekjes së tij. Ai ka 11.240 strofa.¹¹ Përveç anës poetike Mehmet Akif Ersoj ka qenë shumë frytdhënës edhe në shumë fusha të tjera duke lënë pas një korpus të larmishëm. Shkrimet e tij mund të përmbledhen në kategori të ndryshme si; shkrime rreth personave të ndryshëm, shkrime mbi fenë e atdheun, shkrime mbi gjuhën, vlerësime ose kritika rreth librave të ndryshëm, shkrime mbi poezinë, mbi letërsinë dhe rregullat e shkrimit, shkrime rreth edukimit dhe dijes, përralla e fabula, përkthime të ndryshme nga dijetarë të kohës etj.¹²

Poezia e Akifit është shumë e qartë sepse ajo mbart një mision përbrenda. Për këtë arsye shkrimi i tij mund të konsiderohet si i veçantë në krahasim me shkrimet apo poezinë që lexojmë te poetët e tjerë në përgjithësi. Safahati nuk është një libër me poezi në të cilat ka një brendësi të lartë artistike, pasi ai nuk ka si qëllim këtë, duke qenë se ai duhet ta përçojë sa më parë mesazhin tek lexuesi. Problemi i tij parësor janë prapambetja, varfëria, vuajtja, pushtimi, shpëtimi i shoqërisë dhe për këtë arsye aspekti artistik e humbet rëndësinë.¹³ Përmbajtja e shkrimeve të tij përputhet në mënyrën më të qartë me realitetin, gjendjen emocionale dhe mendore të Mehmet Akifit dhe personazheve të tij. Për këtë arsye çdo gjë që ai ka shkruar i dedikohen diçkaje, të gjitha fjalët

9. Hece Dergisi, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Sy. 133, Ankara 2008:4.

10. Erol, Murat, "Sath-ı Vatan ya da Mehmet Akif Ersoy'un Makaleleri", *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:182.

11. Okay, Düздаğ, s. 436.

12. Për të dhëna me të detajuara rreth tematikës së shkrimit të Mehmet Akif Ersojit shiko: Erol, s. 183-194; Gjithashtu për bibliografinë e shkrimeve, përkthimeve shiko: Kara, s. 41.

13. Taşdelen, s. 149.

që ai përdor shkojnë në një adresë të mirëmenduar e të saktë. Këtë aspekt ai e pohon edhe vetë duke u shprehur: “Qëkur e pashë veten time para popullit tim, desha të mendoj shoqërinë para artit tim”.¹⁴ Të gjithë librat e *Safabatit* janë shkruar në kontekst të ngjarjeve historike të kohës së Akifit dhe përçojnë tek lexuesi brengën e tij, qëndrimin dhe zgjidhjen që Akifi i jep problemit të trajtuar. Akademikët e shumtë që kanë bërë studime mbi veprat e tij e cilësojnë *Safabatit*, si argumentin dhe dëshminë më të gjallë të rënies së perandorisë.¹⁵

Për këtë arsye mënyrën e të shkruarit të tij mund ta vëmë re edhe te disa poetë, apo shkrimtarë, të cilët përçonin të njëjtat mesazhe me Akifin. Kjo ngjashmëri formohet në kontekstin ideologjik, pasi janë mendimet e ndjenjat e përbashkëta të këtyre poetëve, të cilët mbartin të njëjtat brenga në lidhje me gjendjen e perandorisë. Ndërsa në këndvështrimin artistik mund të thuhet që nga studimet që janë bërë mbi veprat e tij, vihet re që Mehmet Akif Ersoji është ndikuar nga disa poetë të kohës. Ky aspekt vihet re në poezitë e para që Akifi kishte botuar në revista të ndryshme në rininë e tij dhe në poezitë e para të *Safabatit*. Të gjithë kritikët e pohojnë faktin që në një pjesë të poezive të tij Mehmet Akifi është ndikuar nga Zija Pasha, Mualim Naxhiu dhe Abdulhak Hamidi. Sipas kritikëve, poezitë e tij të hershme

karakterizohen nga një mëdyshje apo kërkim strukturor, ndërsa në aspektin e përmbajtjes qëndron lart teza që ai është ndikuar nga Zija Pashai dhe Abdulhak Hamidi.¹⁶

Nga analizat që kritikët letrarë kanë bërë mbi poezinë e Akifit e *Safabatit* në veçanti, një pjesë e mirë e kritikëve shprehen që poezia e tij më tepër se mjeshtrinë artistike mbart një mision. Si një shembull i kësaj teze përmendet fakti që në poezitë e Mehmet Akifit ka një dendësi të madhe fjalësh. Sipas kritikëve është e vërtetë që poezia shkruhet me fjalë, por fjalët duhen kursyer. Do të thotë që poezia e mirë është të përçarit e mesazhit me sa më pak fjalë. Si pasojë mund të thuhet që poezia e Akifit më tepër se një vepër artistike është funksionale. Duke patur parasysh faktin që fjalët në poezinë e tij e kanë gjithnjë një adresë, atëherë teza e poezisë funksionale merr rëndësi.¹⁷ Në këtë kontekst mund të thuhet që poezia e Mehmet Akif Ersojit është edukuese. Përmes problemeve, dialogjeve, ndjenjave që trajtohen në shkrimet e tij, Akifi mundohet ta përçojë mendimin dhe zgjidhjen, që ai i jep problemit të trajtuar në poezi. Në këtë rast lexuesi bëhet vetë pjesë e ndjenjave që përçohen me anë të poezisë, por në të njëjtën kohë kalon edhe një proces edukimi përmes poezisë së Akifit.

Tematika e shkrimeve të tij është e lidhur ngushtë me sistemin e mendimit të tij dhe me problematikat e shoqërisë. Pikërisht këtu fshihet dhe një lidhje

14. Okay, Orhan, “Mehmet Akif’in Karakteri ve Sanatı”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:9.

15. Ayçıl, Ali, “Dördüncü Kitap (Fatih Kürsüsünde) İçin Dolaylı Bir Şerh”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:288.

16. Okay, Düzdağ, s. 436.

17. Taşdelen, Vefa, “Safahat’ın Eğitim İmalan”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:149.

emocionale mes lexuesit shqiptar dhe Mehmet Akif Ersojit. Ai e shpreh në këtë mënyrë shqetësimin për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej atdheu:

“Për shkak të hallit të tre të patruve,
një popull tre milion
Pa shih si grihet! Ngrihu, ati im nga
varri ku po pushon!
Të gjallët s’vrapuan në ndihmë, të
paktën ti u shko...
Shqipëria digjet.... Dhe, kësaj radhe,
për tmerr!”¹⁸

Po në librin e katërt të Safahatit ai jep shembullin e Shqiptarëve për tragjedinë që përjetonte shoqëria e kohës së tij:

“Ndërsa keni për shembull
shqiptarët, ç’është ende
Kjo politikë e ngatërruar, kjo
çështje pa kuptim?
Më duket se biri juaj nuk e njeh
rrugën kah kalon...
Përzejeni, më në fund, hajdutin që
ju udhëzon!
Dëgjomëni mua që po, jam
shqiptar....
S’kam tjetër ç’them... Vendi im i
mjerë!”¹⁹

d. Sistemi i mendimit të Akifit

Në aspektin ideologjik, Mehmet Akif Ersoji është shumë i qartë dhe mendimi i tij përputhet plotësisht me personalitetin dhe veprimtarinë e vetë poetit. Kjo varet edhe nga përgatitja e shëndoshë mendore, që ai kishte kaluar. Përveç njohjes shumë të mirë të gjuhëve dhe shkencave orientale e fetare,

Mehmet Akifi kishte dijeni shumë të detajuar dhe të mendimit dhe figurave kryesore perëndimore. Që në rininë e tij Akifi ishte njohur dhe kishte lexuar Shekspirin, Hygoïn, Lamartinin, Rusoin, Renanin, Zolan e shumë mendimtarë të tjerë perëndimorë.²⁰ Në këtë kontekst bëhet më i kuptueshëm koncepti i mendimit të Akifit. Sistemi i mendimit të tij bazohet në një ideologji të kristaltë, e cila pasqyrohet në veprimtarinë dhe shkrimet e tij. Nisur nga shkrimet dhe veprimtaria e tij mund të thuhet që mendimi i Mehmet Akif Ersojit është i përmbledhur një fjali të famshme tijën: “Ta marrim frymëzimin drejtpërdrejt nga Kur’ani; e ta shprehim Islamit sipas konceptimit të kohës”.²¹

Nuk ka dyshim që mendimi i Mehmet Akif Ersojit pasqyrohet qartazi në veprën e tij “Safahat”. Libri i gjashtë i Safahatit me titull Asimi, flet për një djalosh me emrin Asim, i cili jetonte në Stamboll. Asimi na paraqitet si një njeri i fuqishëm, me trup të bëshëm, i cili në të njëjtën kohë merret dhe me sportin e mundjes. Përveç anës sportive Asimi është shumë i suksesshëm edhe në mësim dhe veçanërisht në shkencat ekzakte. Ndërsa në aspektin shpirtëror, ai është një besimtar i mirë dhe respektues e mbartës i vlerave. Me anë të këtij libri Mehmet Akif Ersoji i paraqet lexuesit të riun e tij ideal, i cili është fizikisht i fuqishëm, zotëruar dhe zhvillimeve më të fundit të shkencës, por edhe praktikues fetar e mbartës i vlerave pozitive për shoqërinë. Në realitet Asimi është vetë dëshira e Mehmet Akif Ersojit për rininë e shoqërisë në të cilën ai jetoj

18. Ersoj, f. 281.

19. Ersoj, f. 284.

20. Okay, Düzdağ, s. 434.

21. Erol, s. 184.

dhe dha kontributin e tij. Në fakt ky shembull e shpjegon më së miri edhe thënien e tij që shembull duhet të jetë Kur'ani, por ai duhet transmetuar tek të tjerët me gjuhën e kohës apo rrethanave në të cilën ndodhet individi.

Në një këndvështrim më të gjerë mund të thuhet që mendimi i Akifit nuk është unik. Ai është formuar në raport me gjendjen politike, ekonomike e kulturore të qytetërimit të cilit i përkiste. Ashtu si ka njerëz, të cilët kanë ndjenja e mendime të përbashkëta edhe qytetërimet mbartin të njëjtat elemente. Në këtë kontekst është normale që Akifi dhe misioni e shkrimet e tij, të kenë "shokë të tjerë" në Turqi, Lindje të Mesme apo në botën Arabe. Muhammed Abduh, Xhemaleddin Afgani, Musa Xharullah dhe Reshid Riza, janë disa nga këta dijetarë, me të cilët Akifi tregon ngjashmëri në mendimet dhe shkrimet e tij.²² Nga studimet e bëra vihen re paralelizma të mëdha mes shkrimeve të Mehmet Akif Ersojit me ata të dijetarit dhe aktivistit të madh Muhammed İkbali. Që të dy mbartin të njëjtat brenga, të njëjtat ideale e mendime dhe recetat që i japin shoqërisë janë të ngjashme.²³ Brenga e tyre nuk kishte lidhje me një grup, shoqëri apo komb. Ata i shihnin dhe i trajtonin çështjet në prizmin e qytetërimit. Këtë aspekt e shohim qartë në Safahatin e Akifit, ku ai shkruan për problemet e shoqërisë duke filluar

22. Özdenören, Rasim, "Müslüman Bir Düşünür Olarak Mehmet Akif'in Çelişkileri", *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:73.

23. Şahin, Mustafa, "Mehmet Akif/ Muhammed İkbali Ümmet-i Muhammedin Mahzun İki Zileri", *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:56.

nga Lindja e largët, deri në Ballkanin e Andaluzinë mesdhetare. Akifi në Turqi e İkbali në Indi përjetonin me zemra të plagosura gjendjen e vështirë në të cilën gjendeshin vendet e tyre. Ata ishin dy bilbilë, që vajtonin fatin e dhimbshëm të popujve të tyre. Përveç të qënurit aktiv në jetën sociale, ata të dy e dhanë luftën e tyre me poezitë e shkrimet që ata nxorën, tematika e të cilave ishin rrugëzgjdhjet për problemet e shoqërisë pjesë e së cilës ishin.

Nuk ka dyshim, që boshti i mendimit të tij është këndvështrimi Islam i sistemit të mendimit në tërësi. Mehmet Akif Ersoj është njëri ndër figurat më kryesore të mendimit Islam në fillimet e shekullit të XX. në Turqi. Për këtë arsye Mehmet Akif Ersoji është konsideruar si figurë model në zhvillimin e mendimit dhe ideologjisë Islame të kohëve moderne. Në citatin e mësipërm, në të cilin është përmbledhur e gjithë filozofia e Mehmet Akif Ersojit, janë dy pika kryesore që për Akifin janë gurë kilometrikë në zgjidhjen e problemeve në të cilat gjendej qytetërimi të cilit i përkiste. Pika e parë konsiston në aspektin që për zgjidhjen e problemeve dhe dobësive që tregonte shteti e shoqëria osmane ekzistonte vetëm një recetë shërimi, i cili ishte Kur'ani. Pra ideologët, administrata, qeverisësit dhe kasta udhërrëfyese e shoqërisë osmane, duhet të mbështeteshin tek principet Kur'anore për të dalë nga gjendja e mjerueshme në të cilën gjendej perandoria. Ndërsa pika e dytë konsistonte në aplikimin e këtyre principeve në përputhje me gjuhën, metodat dhe nevojat e kohës.

Përfundim

Si përfundim mund të themi që, kombi shqiptar përgjatë shekujve i ka dhënë shumë bij njerëzimit. Është e vërtetë që ne si komb nuk i kemi dhënë një qytetërim njerëzimit, por bijtë e këtij kombi kanë shkëlqyer në përparimin e njerëzimit. Shqiptarët kanë dhënë kontribute të mëdha si perandorive të qytetërimit perëndimor, ashtu dhe atyre lindore. Njëri ndër këta njerëz të mëdhenj që i kanë shërbyer njerëzimit, pa dyshim është dhe Mehmet Akif Ersoj. Ky njeri vlerash me origjinë nga fshati Shushicë i Pejës, është shkruesi i himnit të flamurit turk, por dhe njëri ndër mendimtarët dhe aktivistët më të mëdhenj turq të shekullit të kaluar.

Mehmet Akifi na del përpara, si një njeri idealist, si në mendime, ashtu edhe në shkrimet dhe veprimtarinë e tij. I gjendur përballë vështirësive të mëdha në të cilat po kalonte qytetërimi të cilit i përkiste por dhe e gjithë bota, ai e ndiente shumë thellë hidhërimin dhe dhimbjen e shkaktuar në shoqëri. Si një idealist që ishte, Mehmet Akif Ersoji ka kontribuar fizikisht, shpirtërisht e materialisht në plotësimin e idealeve të tij dhe orientimin e shoqërisë drejt vlerave njerëzore. Ai është një bilbil që vajton dhimbjen që ndiente shoqëria të cilës i përkiste. Dy nga shtatë librat që formojnë librin e tij *Safahatin*, i janë dedikuar veçanërisht luftës ballkanike në të cilën humbën jetën me miliona njerëz të pafajshëm, u shkatërrua e u varfërua i gjithë gadishulli ballkanik. Ai ndien dhimbje e vuajtje për problemet në të cilat gjenden bashkëkombësit e tij, aspekt të cilin e shpreh në poezi të ndryshme

kushtuar Kosovës. Problemet e ndarjes së Shqipërisë e trojeve shqiptare dhe sulmet që iu bëheshin këtyre trojeve, zënë një vend të veçantë në botën e tij shpirtërore dhe pasqyrohen gjithashtu edhe në veprën e tij.

Për fat të mirë sot vepra e tij *Safahati* gjendet e përkthyer dhe në gjuhën e origjinës së Akifit, pra në shqip. Duhet falenderuar përkthyesit por duhet inkurajuar dhe lexuesi ta lexojë vetë Mehmet Akif Ersojin. Rreth tij janë shkruar shumë, por mes tyre ia vlen të theksohen disa më kryesoret. Një ndër punimet më kryesore rreth Mehmet Akif Ersojit është libri *Mehmet Akif Hayati*, Eserleri ve Yetmiş Muharririn Yazıları i botuar në Stamboll në dy vëllime i vitit 1939 ku kanë kontribuar dijetarët e intelektualët më të mëdhenj turq të shekullit XX. Në të vërtetë vetëm ky punim është mëse i mjaftueshëm për të treguar figurën shumë-dimensionale dhe karakterin e mendimit të Mehmet Akif Ersojit. Në Turqi çdo vit organizohen konferenca, panele shkencore, sipoziume e mbrëmje letrare në nder të kësaj figure të madhe. Dhe nëse në Turqi rreth tij janë shkruaj mbi dyqind libra e me mijëra ese për fat të keq në Shqipëri ai nuk njihet shumë. Por edhe pse kanë kaluar mbi njëqind vjet nga shkrimet e tij, vërejmë që tematika dhe problemet e trajtuara në ata shkrime, janë shumë koherente me problemet e ditëve të sotme në këtë gjeografi. Kjo tregon madhështinë e Mehmet Akifit, por edhe nevojën e hulumtimit të mëtejshëm e të vazhdueshëm të veprave të tij.

Referenca

- Ayçil, Ali, “Dördüncü Kitap (Fatih Kürsüsünde) İçin Dolaylı Bir Şerh”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Çağın, Sabahattin, “Akifin Kişiliğine Dair”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Çantay, Hasan Basri, “Anılarda Akif”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Erol, Murat, “Sath-ı Vatan ya da Mehmet Akif Ersoy’un Makaleleri”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Ersoj, Mehmet Akif, *Fletët*, Përkth. Mithat Hoxha, Logos-A, Shkup 2006.
- Ersoy, Mehmet Akif, *Safahat*, AkvaryumYayınevi, İstanbul 2006.
- Hece Dergisi, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Sy. 133, Ankara 2008.
- Kara, Mustafa, *İstiklalimizin Bülbülü Mehmet Akif Ersoy*, Özal Matbaası, İstanbul 2012.
- Okay, Orhan, “Mehmet Akif’in Karakteri ve Sanatı”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Okay, M. Orhan, Düzdağ, M. Ertuğrul, “Mehmet Akif Ersoy Maddesi”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXVIII, Ankara.
- Özalp, N. Ahmet, *Said Halim Paşa: Tüm Eserleri*, Anka Yayınları.
- Özdenören, Rasim, “Müslüman Bir Düşünür Olarak Mehmet Akif’in Çelişkileri”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Şahin, Mustafa, “Mehmet Akif/ Muhammed İkbâl Ümmet-i Muhammedin Mahzun İkiizleri”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.
- Taşdelen, Vefa, “Safahat’ın Eğitim İmaları”, *Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı*, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.

Promovohet “Zani i Naltë”, revistë shkencore e kulturore



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ka promovuar revistën shkencore “Zani i Naltë”, numri i parë i së cilës doli në tetor 2012, si vazhdim i revistës me të njëjtin emër, e themeluar në vitin 1923.

Promovimi i kësaj reviste u zhvillua në ambientet e Universitetit Bedër më 21 shkurt 2013, ceremoni në të cilën morën pjesë një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës i kryesuar nga Myftiu H. Naim Tërnavë, përfaqësuesi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, At Andon Merdani, përfaqësues të Komunitetit Shtetëror për Kultet, përfaqësues të institucioneve shtetërore, kulturore e akademike, myftinj, studentë e të ftuar të tjerë.

Aktivitetin e hapi kryeredaktori dhe drejtori i revistës “Zani i Naltë”, Genti Kruja. Në fjalën e tij z. Kruja theksoi se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë historikisht ka qenë promotor në promovimin e vlerave të larta islame dhe atdhetare.

“Në datat 24 shkurt-12 mars 1923 - tha ai, - u mbajt Kongresi i Parë Mysliman, që do të themelonte edhe Komunitetin Mysliman Shqiptar, duke ngritur një institucion administrativ dhe organizativ të të gjitha punëve dhe çështjeve të islamit në trojet shqiptare, në vazhdimësi të trashëgimisë shekullore të Islamit në trojet tona. Në këtë kongres u vendos që të dilte edhe periodiku dhe organi i vetëm zyrtar i KMSH-së, revista “Zani i Naltë.”

“Ajo çfarë të bën përshtypje - vijoi ai më tej, - është se që në numrin e parë të revistës, në kopertinë shkruhej: “Zani i Naltë”, revistë fetare, merret edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare, sociologji, gjë që tregon për nivelin e lartë të përmbajtjes së saj në shumë fusha studimi. Në vitin 2012 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me rastin edhe të 100 vjetorit të shtetit shqiptar, vendosi rithemelimin dhe vazhdimin e botimit të revistës “Zani i Naltë”, në një periodik 3-mujor, duke treguar edhe një herë se mundohet të jetë në ndjekje të gjurmëve të personaliteteve të shquara islame shqiptare të atyre viteve.”

Në fund, ai falënderoi në emër të Komunitetit Mysliman dhe të redaksisë të gjithë ata që kanë sjellë shkrime për dy numrat e revistës, që kanë parë dritën e botimit.

Pas tij përshëndeti Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit ndër të tjera u shpreh: “Revista “Zani i Naltë” e themeluar menjëherë pas ngritjes së Komunitetit Mysliman, ka qenë një pasqyrë e vërtetë e vlerave të inteligjencës myslimane të asaj kohe krizash, mendimesh e ideologjish. Gjatë gjithë periodikut të saj vërehen tonet patriotike dhe atdhetare të shkruesve, të cilët lanë gjurmë të pashlyera me anë të shkrimeve dhe mendimeve të tyre.”

“Shpresojmë që kjo revistë, tashmë e rikthyer, të zërë një vend të merituar në mesin e intelektualëve, studiuesve dhe lexuesve në Shqipëri dhe jashtë saj”, përmbylli fjalën e tij z. Muça.

Përshëndetje bënë edhe Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myfti Naim Tërnavë dhe dekani i Fakultetit

të Studimeve Islame në Prishtinë, Prof. dr. Qazim Qazimi. Ata vlerësuan lart kontributin e kësaj reviste për kohën kur doli në qarkullim dhe u shprehën me urimet më të mira që ajo të vazhdojë rrugëtimin e saj në shërbim të edukimit të shoqërisë me vlerat e moralit dhe të edukatës islame.

Nga panelistët fillimisht e mori fjalën Prof. dr. Ferit Duka. Historiani Duka, theksoi se revista e Komunitetit Mysliman Shqiptar, që jo vetëm një organ institucional, por një botim i mirëfilltë shkencor, që trajtonte problematikën dhe sfidat me të cilat përballëj Islami dhe shoqëria e asaj kohe. “Revista trajtonte jo vetëm probleme me karakter teologjik, filozofik e kulturor, por edhe probleme sociale të kohës. Ajo dallohej për përmbajtjen e pasur dhe spektrin tematik të standardeve të larta.”

Z. Duka u shpreh i lumtur për rikthimin e kësaj tribune mendimi, duke shprehur bindjen, se ajo do të ndjekë gjurmët e paraardhësës së saj.

Më pas fjalën e mori shkrimtari Besnik Mustafaj. Pasi uroi Komunitetin Mysliman për këtë nismë të bukur, ai theksoi se kjo revistë ka një rëndësi të madhe, sepse lindi në fillim të shtetit shqiptar dhe rikthehet sot pas një shekulli për të treguar se veprat e mira nuk vdesin kurrë. “Sot jemi mbledhur këtu, jo vetëm për të promovuar këtë nismë të re të Komunitetit Mysliman, po për të kujtuar me respekt e nderim kontributin e madh të atyre personaliteteve fetare e kombëtare, që e themeluan, shkruan dhe kontribuan për vazhdimësinë e kësaj reviste.”

Ndërsa më tej z. Mustafaj shtoi: “Ringjallja e kësaj reviste, është tregues i asaj se Komuniteti Mysliman ka forcën

intelektuale të bollshme për të mbajtur një revistë me nivelin që kërkon koha, duke qenë një forcë vitale e konkrete nisur nga tradita e saj e shkëlqyer. “Zani i Naltë” është një revistë që ka një dimension ekumenik. Duke qenë e tillë kjo revistë do vazhdojë të japë një kontribut të madh për paraqitjen e vlerave reale të islamit dhe zhvillimin e dialogut me të tjerët në shërbim të kohezionit dhe paqes sociale, pra do vazhdojë të justifikojë definicionin që ka qysh në origjinën e saj”, tha z. Mustafaj.

Fjalën e mori edhe publicisti Dr. Agron Tufa, i cili pasi përgëzoi Komunitetin Mysliman për këtë nismë kurajoze, theksoi se rikthimi i kësaj tribune të rëndësishme, duhet të na gëzojë të gjithëve, pasi ka në thelb ringjalljen e një tradite, e cila hodhi themelet e dashurisë për besimin, kulturën dhe dijen në përgjithësi.

“Rikthimi i Zanit të Naltë, - tha z. Tufa, - është një përgjigje, që na jep shpresë pas një katastrofe gjysmë shekullore. Ne duhet të njohim ato vlera me të cilat na kanë ndarë për gjysmë shekulli dhe të cilat do të bënin, që fjet tona të lidheshin sërish, në mënyrë që të kuptonim se nga çfarë faze pati filluar të hidhte shtat besimi në vendin tonë.” Ai përmendi gjithashtu se kjo revistë duhet të shërbejë si lajmëse që na bën të njohur tendencat për atë që do të vijë më vonë nëpërmjet botimeve më të kualifikuara. “Zani i Naltë lindi në një kohë kur njeriu gjendej përballë një krize identiteti, duke e ndihmuar të kalojë simptomat e kësaj krize nëpërmjet forcës së besimit dhe vlerave shpirtërore. Këtë qëllim duhet të ketë edhe sot, pikërisht rindërtimin e njeriut me vlerat e besimit dhe me shije”, tha z. Tufa.



Foto nga promovimi
i revistës “Zani i Naltë”



**Të nderuar të ftuar,
Motra dhe vëllezër,
Të dashur studentë
dhe pedagogë!
Të nderuar panelistë!**

Në emër të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ju uroj mirëseardhjen në këtë promovim të revistës shkencore dhe kulturore Zani i Naltë, organ i KMSH-së.

Revista **“Zani i Naltë”** ishte revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, themeluar në vitin 1923 menjëherë pas ngritjes së institucionit të Komunitetit Mysliman, pas Kongresit të parë Mysliman Shqiptar. Botimi i saj ka zgjatur nga viti 1923, deri më 1939, kur Shqipëria hyri në një fazë tjetër historike, atë të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë revistë, gjatë gjithë periodikut të saj vërehen tonet patriotike dhe atdhetare të shkruesve, të cilët lanë gjurmë të pashlyera me anë të shkrimeve të tyre.

Gjatë 16 viteve të jetës së saj, ajo botoi një sërë artikujsh, që dëshmojnë një pasuri të tërë kulturore, nëpërmjet së cilës pasqyrohet dhe niveli i mendimit teologjik shqiptar, gjatë periudhës së paspavarësisë.

Kjo revistë pati një rëndësi shumë të madhe jo vetëm për edukimin fetar islam të popullatës shqiptare, por ajo zgjoi edhe ndjenjat e patriotizmit dhe të ngritjes kulturore e arsimore të popullit shqiptar.

Në revistën **“Zani i Naltë”** bashkëpunuan personalitete të shquara si H. Vehbi Dibra, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Ali Korça, Jonuz Bulej, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, e të tjerë, duke përfshirë këtu edhe emra të njohur të letërsisë shqiptare si p.sh. Mit’hat Frashëri. Më pas kanë dalë në shtyp revista «Kultura Islame» dhe «Njeriu», organe të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Këto botime me standarde shumë të larta, kanë qenë një pasqyrë e vërtetë e vlerave të inteligjencës myslimane të asaj kohe krize mendimesh e ideologjish.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me rikrijimin e vet në 1990, pas disa kohësh nxori gazetën **“Drita Islame”**, ku për 20 vite, ajo u bë e pandarë nga dashamirët dhe lexuesit e vet të shumtë. Viti 2012, ashtu si edhe për të gjithë shqiptarët, edhe për institucionin tonë, ishte një vit plot aktivitete, konferenca dhe botime të rëndësishme. Kështu në janar 2012 gazeta Drita Islame u kthye në një revistë kulturore-mujore, si dhe në tetor 2012 pas 73 vitesh ndërprerje u rikthye edhe revista shkencore dhe kulturore Zani i Naltë, si një periodik 3 mujor. Këto botime të rëndësishme u pasuan edhe me botimin e enciklopedisë së parë të KMSH-së **“100 personalitete shqiptare të kulturës islame”**, si dhe botime të tjera.

Unë i uroj suksese Zanit të Naltë dhe i ftoj të gjithë studiuesit dhe akademikët që t’i bashkëngjiten kësaj tribune të dijes.

Ju faleminderit!



Prof. Dr. Ferit Duka

Së pari unë dëshiroj të përshëndes të gjithë të pranishmit duke filluar nga të nderuarit drejtues të bashkësive islame të Shqipërisë dhe Kosovës, përfaqësuesin e komunitetit ortodoks, pedagogët, studentët dhe të gjithë auditorin e nderuar.

Është një kënaqësi e veçantë që sot ne asistojmë në një ceremoni të përtëritjes së një tradite të fuqishme intelektuale të Bashkësisë Islame Shqiptare, një përtëritje të një organi, “Zani i Naltë”, një organi i cili në vitet 20 – 30 të shekullit të kaluar u bë një tribunë e fuqishme e shprehjes së mendimit teologjik, filozofik, sociologjik, u kthye në një tribunë të fuqishme ku gjetën shprehje problematikat e kohës, qoftë të Islamit, qoftë të shoqërisë shqiptare, pra përtej Islamit.

Në këtë revistë, të cilën unë kam pasur fatin që vite më parë edhe për interesat e punës sonë studimore ta konsultoj, kam gjetur artikuj që janë një manifestim i

shkëlqyer i një performace intelektuale të lartë të elitës së asaj kohe të Bashkësisë Islame, mendimtarë të cilët nëpërmjet këtij organi gjetën rastin të trajtojnë probleme me karakter jo vetëm, siç e thashë teologjik, por edhe filozofik, sociologjik të bëjnë që në revistë të zënë vend shqetësimet e kohës. Arritën të bëjnë që kjo revistë të kthehej në një organ i cili do të tentojë, që me sukses, që Islamit “shqiptar” ta përshtaste me rrjedhat bashkëkohore, të kuptonte ose të bënte që të kuptoheshin qartë marrëdhëniet, sfidat që kishte Islami me shoqërinë e atëhershme dhe unë, për fat të mirë, vë re që edhe sot, pavarësisht se ndoshta jemi pak me vonesë por ama përsëri është një gjë e mirëseardhur, unë vë re që ekipi i sotëm botues i revistës “Zani i Naltë” ka mbajtur parasysh ose është i vetëdijshëm që revista duhet tashmë të ketë një standard të lartë jo vetëm krahasuar me parametrat e kohës sonë por edhe me parametrat dhe standardet që ka vendosur “Zani i Naltë” në kohën që ai doli dhe për fat të mirë këtu në botimet e para (numra e parë) që ka bërë ekipi botues, fatmirësisht qoftë nga pikëpamja e spektrit tematik qoftë nga pikëpamja e shtjellimit të problematikës që trajtohet mendoj që na jep neve shpresën dhe bindjen që revista e përtërirë sot jo vetëm që do të ndjekë gjurmët e lavdishme që ka lënë paraardhësja e saj me të njëjtin emër, por do të dijë ta qojë edhe më përpara këtë emër të nderuar duke vendosur kështu piketa shumë të rëndësishme në zhvillimin e shtypit shqiptar të sotëm në përgjithësi ashtu edhe në zhvillimin e mendimit Islam në veçanti. Unë edhe njëherë jo vetëm

që dëshiroj tu ftoj të bëjmë një homazh të gjithë atyre mendimtarëve të Islamit “shqiptar”, të shoqërisë shqiptare në tërësi, sepse në këtë revistë kontribuuan jo vetëm mendimtarë brenda rrezes së Bashkësisë Islame por edhe mendimtarë jashtë kësaj rrezeje, unë pra e quaj veten të nderuar që të jem pjesë e juaj që tu bëjmë homazh këtyre për këtë traditë të shkëlqyer që ata lanë dhe të uroj gjithashtu që revista sot të eci përpara, të shënojë sukses pas suksesi dhe sigurisht sot në një botë kur sfidat, vështirësitë, keqkuptimet që ekzistojnë në lidhje me fetë, me marrëdhëniet ndërjetare, revista “Zani i Naltë” të bëhet një revistë e cila vazhdimisht të kthjellojë problematikat

Besnik Mustafaj

I nderuar Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Selim Muça, i nderuar Myfti i Kosovës, i nderuar At Andoni, i nderuar Dr. Genti Kruja, drejtor i revistës “Zani i Naltë”, të nderuar miq, studentë, pedagogë, dashamirës.

Unë vlerësoj se një moment si ky, është një moment veçanërisht i



dhe të trajtojë me sukses të gjitha ato ç’ka imponon koha e sotme, qoftë edhe në vështrim të problematikës së Islamit në veçanti.

Më lejoni që së fundmi edhe një herë tu shpreh urime ekipit botues, t’u shpreh urime Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për këtë nismë kaq të bukur dhe shpresoj që kjo do të bëhet një garante e zhvillimit të fuqishëm të mendimit teorik, filozofik në kuadër të zhvillimeve të sotme të cilat janë me të vërtetë të një natyre komplekse.

Ju faleminderit shumë për durimin që treguat edhe një herë me urimet më të mira për këtë nismë kaq të bukur.

rëndësishëm dhe i bukur, sepse jemi mbledhur për të promovuar një revistë, e cila nuk lind sot, por rilind sot dhe në këtë kuptim është një moment shumë i rëndësishëm për të gjithë, sepse shpreh disa aspekte të rëndësishme për ne, për mendimin shqiptar, për mendimin islam në mënyrë të posaçme, por edhe për gjithë shoqërinë shqiptare. Pra, kjo është një ngjarje e gëzueshme në radhë të parë për të gjithë myslimanët shqiptarë, sepse do të kenë përsëri në dorë një revistë, e cila ka lindur në fillimet e shtetit shqiptar dhe do të vazhdojë në periudhën e modernizimit të shtetit shqiptar. Është një moment i gëzueshëm për të gjithë shqiptarët, mendoj unë, sepse do të gjejnë në këtë revistë, kudo që janë shqiptarët, një tribunë të rëndësishme shkencore dhe kulturore, informative dhe analitike, por është një moment i gëzueshëm edhe për botën intelektuale shqiptare në përgjithësi. Çfarë tregon rilindja e kësaj reviste?

Në radhë të parë tregon se veprat e mira nuk vdesin. Janë përdorur të gjitha mënyrat për “ta vdekur” edhe këtë revistë, si për të vdekur shumë gjëra të çmuara të botës shpirtërore, intelektuale, apo edhe në përgjithësi të botës shqiptare, por nuk kanë arritur, nuk ka arritur politika, nuk ka arritur policia, nuk ka arritur dhuna t’i vdesë, dhe rilindja e kësaj reviste tani, tregon se veprat e mira nuk vdesin dhe këtu kam parasysh veprat e mira të atyre, që e themeluan këtë revistë, të atyre që shkruan gjatë 16 viteve në këtë revistë dhe që ne sot i trashëgojmë për të vazhduar në njëfarë mënyre punën e tyre.

Dalja e kësaj reviste tregon se demokracia dhe liria, të rikthyera para 22 vitesh në Shqipëri janë pjekur. Kjo revistë nuk mund të lindte në vitet ’90 as në ’91, do të rilindte pra përsëri pasi të piquej vetë liria dhe demokracia dhe kur gjërat do të ishin të pakthyeshme për keq mbarsht.

Po ashtu rilindja e kësaj reviste tregon se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka forca intelektuale të bollshme dhe të një niveli intelektual shumë të lartë për të mbajtur një revistë periodike shkencore dhe kulturore, se të gjithë ata që e dinë se ç’është një revistë, e kuptojnë sa e vështirë është të nxjerrësh 4 numra në vit të një reviste të tillë me nivelin, që kërkon një revistë e kësaj natyre. Pra është një tregues i gëzueshëm për të gjithë shqiptarët, fakti se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ka potenciale të tilla intelektuale, të pjekura, të shkolluara mirë, të një mendjeje të hapur dhe të gatshëm të shprehen përpara gjithë shoqërisë, sepse revista është botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, por i drejtohet gjithë shoqërisë shqiptare. Kështu që në këtë kuptim, pra, unë ndjehem i gëzuar.

Kjo revistë, jam i bindur, ashtu si në fillimet e saj, në të njëjtën traditë, me të njëjtën filozofi, do të shërbejë, në radhë të parë, për të rritur besimin e myslimanëve shqiptarë te feja e tyre dhe kjo është shumë e rëndësishme, është një nga sfidat, që ka përpara në radhë të parë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, por që ka përpara në përgjithësi bota. Do të shërbejë kjo revistë, jam i bindur, edhe nisur nga tradita e 16 viteve të para luftës, por edhe nga 2 numrat e parë që tashmë ne i kemi në dorë, kjo revistë pra do të shërbejë për të treguar fytyrën e vërtetë të Islamit “shqiptar”, si një Islam modern, si një Islam integrues përkundër të gjitha përpjekjeve të islamofobisë, të cilat përpiqen ta dezinformojnë opinionin publik, përpiqen ta diskreditojnë Islamin në përgjithësi dhe Islamin “shqiptar” në veçanti. Pra unë jam i gëzuar se edhe në këtë aspekt kjo revistë do të luajë një rol shumë të madh, sepse është një dokument skriptament thoshte Latini, pra e shkruara mbetet dhe kjo ka një rëndësi shumë të veçantë dhe unë duke e njohur Dr. Krujën, duke njohur disa nga personalitetet, që kanë punuar për numrin e parë dhe të dytë, duke njohur frymën që zotëron në Komunitetin Mysliman Shqiptar, jam i bindur se do të vazhdojë të luajë shumë mirë këtë rol kundër islamofobisë.

Në traditën e vet kjo revistë, nuk e them vetëm si urim, por e them si bindje, jam i bindur se do të ndihmojë në rrënjosjen e dashurisë për atdheun te shqiptarët në përgjithësi, te myslimanët në veçanti dhe kjo nuk është pak, sepse në një kohë si kjo që jetojmë, kohë kozmopolite, në një kohë kur atdheu jo gjithmonë ka vendin, që do të duhej që të kishte në mendjen dhe në zemrën e njeriut, atëherë duhet të punojmë të gjithë për të rrënjosur këtë dashuri për

atdheun dhe kjo revistë është një forcë konkrete, një forcë mendoj unë vitale, për t'i shërbyer këtij qëllimi, të cilin e ka si qëllim, që në themelimin e saj në vitin 1923.

Unë jam i bindur se kjo revistë do të shërbejë, nisur edhe nga tradita e saj, për të vendosur mbi një bazë edhe më të strukturuar, e më intelektuale, dialogun e Islamit me besimet e tjera, në emër të interesave të përbashkëta, që janë kohezioni i shoqërisë shqiptare dhe uniteti kombëtar. Në qoftë se kjo do të bëhej një revistë sektare, atëherë nuk do të kishte vlerë, do të bëhej e dëmshme, por kjo revistë vjen si një revistë pikërisht në këtë qëllim, për t'i shërbyer hapjes së mendimit të Islamit "shqiptar" dhe të Islamit universal sigurisht, sepse Islami "shqiptar" nuk është jashtë Islamit universal edhe ndaj dialogut me të tjerët, si një mënyrë për të siguruar paqen sociale, për të rritur kohezionin e shoqërisë shqiptare dhe unitetin e kombit tonë në përgjithësi.

Unë, në vazhdim të kësaj që po them, besoj se kjo revistë, do të ketë një dimension ekumenik të padiskutueshëm, do të ketë një dimension ekumenik intelektualist të pranueshëm për të gjithë, që do të thotë se, do të thithet aty mendimi i njerëzve më të shquar shqiptarë sigurisht, por edhe të mbarë botës, që nuk janë myslimanë doemos, pra duke qenë një revistë ekumenike, ajo do të justifikojë edhe më mirë definicionin, përcaktimin që ka, që në origjinën e saj si një revistë shkencore dhe kulturore. Pra duke qenë një revistë ekumenike, ashtu siç është jeta e shqiptarit ekumenike, që e pranon tjetrin pa i imponuar besimin e tij, atëherë kjo me idetë dhe analizat e saja humaniste, do mund të përbëjë një kontribut për kulturën shqiptare, por edhe për njerëzimin në përgjithësi.

Unë sigurisht që i shpreh urimet më të sinqerta kësaj reviste, që të bëjë jetë të gjatë, të ruajë nivelin e saj, të përcillet te brezat e ardhshëm, për fat drejtori aktual është i ri, por kjo nuk do të thotë, që edhe të rinjtë të mos mendojnë t'u përcjellin brezave të ardhshëm një trashëgimi, ashtu siç ne krenohemi me trashëgiminë e atyre që e kanë themeluar para 70 e disa viteve. Po ashtu i shpreh përgëzimet e mia Komunitetit Mysliman, Kryetarit të këtij Komuniteti për përkushtimin, sepse një revistë kushton dhe gjetja e mundësive financiare për ta mbajtur, për ta rilindur këtë revistë dhe për ta mbajtur, që të ecë përpara është një kontribut që Komuniteti Mysliman si strukturë, si organizatë jep për gjithë shoqërinë shqiptare dhe unë i shpreh përgëzimet e mia më të sinqerta.

Unë besoj se Komuniteti Mysliman në Kosovë, Komuniteti Mysliman në Maqedoni, që patëm rastin të dëgjojmë telegramin, gjithashtu do të gjejnë në këtë revistë tribunën e mendimit intelektual, tribunën e mendimit të kualifikuar, të hapur dhe modern për anëtarët e këtyre komuniteteve, por gjithashtu edhe për anëtarët në përgjithësi të shoqërive të tyre, në mënyrë që ashtu si në aktin e vet themelues edhe në aktin e vet rilindës "Zani i Naltë", të jetë një revistë përmbi ndarjet kufitare, shtetërore, përmbi ndarjet, që nuk kanë ardhur nga dëshirat e vetë shqiptarëve dhe të sigurojë një imazh të përgjithshëm, modern dhe të mirë edhe përpara miqve të Shqipërisë, të ndihmojë për t'i shtuar miqtë shqiptarëve kudo që janë në botë. Ne jemi në një periudhë, që kemi nevojë të kemi sa më shumë miq dhe miqtë bëhen me vepra konkrete.

Ju faleminderit edhe një herë dhe ju uroj gjithë të mirat.



Dr. Agron Tufa

I nderuar Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Selim Muça, i nderuar Myftiu i Kosovës z. Tërnavë, i nderuar At Andoni, të nderuar kolegë, pedagogë, studentë.

Promovimet e revistave janë shumë të rëndësishme dhe në radhë të parë janë të rëndësishme sepse ato janë tribuna të mendimit, janë forume shkencore, akademike qofshin ku paralajmërohet se botës intelektuale i hapet një pistë, një perspektivë e re ku do të kontribuohet për çështje të caktuara. Çdo revistë është e domosdoshme në çdo lloj sferë qoftë sepse ajo në radhë të parë krijon një peizazh të plotë me anë të kapjeve, tendencave, ideve fizionominë e një sferë të caktuar, qoftë kjo nga kultura, nga shkenca apo nga filozofia. Në rastin konkret, domethënia e revistës “Zani i Naltë”, si gjest, është i shumëfishhtë sepse realizon disa detyra, ndryshe po themi nga revistat e natyrës laike, domethënë intelektuale qofshin, kjo është një përgjigje e asaj nevojë të madhe shpirtërore, ringjallëse që

ndjehet në Shqipëri pas një katastrofe gjysmë shekullore vlerash shpirtërore e morale. Dhe ringjallja, siç e dimë ne mirë, vjen pas ndërprerjes së të gjitha lidhjeve të traditave me traditat, të kohërave me kohërat, të brezave me brezat, të çdo lloj konstrukti moral që qe formuar deri atëherë pas një shkatërrimi dhe ploje të llahtarshme që ndodhi në jetën shpirtërore të shqiptarëve gjatë diktaturës komuniste dhe kjo ndodhi fatkeqësisht në një lloj për të gjitha besimet fetare në Shqipëri.

Sigurisht, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, besimtarët myslimanë, patën edhe ata pjesën e rëndë e të hidhur të kësaj ndërprerjeje dhe të përpunimit e shkatërrimit të njeriut me të gjitha metodat që kishte në dispozicion varianti më i keq i marksizmit – stalinizmit.

Unë do të thoja që gjesti i parë që duhet të na gëzojë është se ringjallet një traditë vërtetë e lavdishme për tu respektuar, një traditë që hodhi themelet e edukimit shpirtëror, patriotik, intelektual dhe letrar në Shqipëri, siç ishte pra “Zani i Naltë” bashkë me revistat e tjera të këtij komuniteti “Njeriu” apo “Drita Islame”.

Lidhja me traditën e kësaj reviste në radhë të parë nënkupton ringjalljen e saj nga hiri, risjelljen edhe njëherë në vëmendjen tonë në kodin tonë kulturor – shpirtëror të figurave që qenë edukatorët e parë, qenë pionierët e parë, qenë reformatorët e jetës shpirtërore, arsimore e kulturore në Shqipëri. Ne i dimë kontributet, e shumë prej jush i njihni e i keni lexuar e i keni studiuar, tashmë po bëhet dalëngadalë realitet edhe rikthimi i veprës së tyre për komunikimin me publikun e gjerë,

rikthimi i veprës së plotë siç ka qenë me një botim luksoz të Hafiz Ali Korçës, do t'i kemi të gjithë veprat e atyre studiuesve, intelektualëve, përkthyesve siç ka qenë për shembull Ferit Vokopola, apo të teologëve të mirëfilltë sikundër se ka pasur, ne duhet t'i njohim, e kam fjalën të gjitha këto vlera prej të cilave na ndanë dhunshëm për një gjysmë shekulli apo më shumë. Ne duhet të njohim madje edhe përpjekjet për përkthimin e Kur'anit në vitin 1937, një përkthim me një gjuhë të lëvdueshme, me një gjuhë të mrekullueshme, nëse s'gaboju nuk ka qenë një përkthim i plotë, por ka qenë një përkthim mbresëlënës me një gegërishte të ëmbël e të lehtë; do të thoja rikthimi i gjithë këtyre vlerave në panteon do të kompaktësonte, do të bënte që dijet tona të lidheshin dhe të shihnin se nga çfarë pike vërtetë intelektuale, tolerante dhe nga çfarë kuote humaniste pati filluar fondamenti, shtrati i edukimit i asaj ngrehine të besimit dhe të edukimit në Shqipëri.

Ne e dimë që sot revistat përmbushin, përveç rrafshit të thjeshtë informativ edhe një njohje të një peizazhi kaleidoskopik, do ta quaja, të jetës së besimtarëve. Realizimi i asaj detyre që quhet teologjike, diskursi teologjik për çështje të ndryshme, sepse sigurisht është e nevojshme që gjithçka të restaurohet dhe të mund të ripërtërihet për të ecur në frymën e kohës, për të pasur një ide të qartë, domethënë jo vetëm të doktrinës së besimit dhe sharteve të tij, por për ta interpretuar atë në një mënyrë, me një taktikë sa më të thjeshtë, të prekshme, të kuptueshme dhe këtë gjë zakonisht e bëjnë revistat përpara se atë ta bëjnë

volumet e rëndësishme e bibliotekat e tëra. Në këtë kuptim revista gjithmonë është në pararojë, është lajmëse e asaj çka po ndodh, e asaj tendence të re të mënyrave të ndryshme të studimit por edhe të kërkimit. Informacioni dhe tendenca gjithmonë bëhet e mundur nëpërmjet revistave përpara sesa të studiohet në universitet. Për shembull shumë prej jush edhe kanë studiuar në mënyrë të përqendruar teologjinë, por jo të gjithë shqiptarët, aq më tepër kur sindroma ateiste ka qenë e stimuluar intensivisht, për më shumë se sa gjysmë shekulli, të gjithë kanë nevojë të dinë dhe gjëja më e shpejtë, më e saktë, më e mirë, më e ëmbël dmth. është komunikimi nëpërmjet mediave të specializuara dhe këtë e bëjnë mediat periodike siç është dhe "Zani i Naltë". Tradita jonë ka qenë e artë, në fakt në të gjitha aspektet vitet '20, '30, '40 kanë qenë kulmi i lulëzimit të revistave si për Komunitetin Mysliman, si për atë Katolik, ndoshta edhe për atë ortodoks për të cilin nuk kam shumë informacion kështu që të më ndjeni, por kulmimi i këtyre mediave, revistave krijoi një sferë të begatë dhe njeriu nuk gjendej përballë një krize identiteti shpirtëror, nuk gjendej përballë dilemave të sotme për shembull. Të gjithë kontribuuan dhe patën një gjë të mrekullueshme përveç edukimit fetar, patën edukimin patriotik. Kjo ka qenë unison për të tre komunitetet çka është edhe për tu marrë shembull.


Ndërsa unë do të thoja që revista "Zani i Naltë", që siç e përmenda vjen e ringritur nga hiri, duhet të dëshmojë, pavarësisht dy numrave të parë, që është zgjedhur me mjaft strategji përbërja,

menyja e revistës, por duhet të na ofrojë në të ardhmen, si një detyrë e një grupi të specializuar por një detyrë mbarë shoqërore për ta informuar atë që s'ka pasur mundësi të njohë sferën, ta lajmërojë dhe të kryejë një funksion edukativ nëpërmjet sjelljes në këtë revistë, herë pas here, të profileve të veçanta të këtyre reformatoreve të edukimit shpirtëror e fetar siç kanë qenë Vehbi Dibra, Hafiz Ali Kraja, Hafiz Ali Korça dhe pafundësisht është një pasuri e madhe që nuk duhet të krijojmë distancë, por duhet t'i risjellim dhe të njihemi me kontributet e tyre, me veprat e tyre jo vetëm fetare por edhe veprat e tyre kulturore, letrare, filozofike të gjitha këto përbëjnë atë vatrën e ngrohtë e të nxehtë të besimit, edukimit, të mendimit dhe të gjitha këto gjëra ka shanse për t'i bërë një revistë për të cilën unë nuk kam pikë diskutimi do ta kryejë misionin e vet, rreth së cilës ofrohen elita më e mirë që tashmë ka pasur kohë të kualifikohet, të studiojë, të njohë risitë jo vetëm doktrinare të Islamit por edhe kulturore. Pra jemi përpara një domosdoshmërie për të luftuar atë situatë të rëndë që na ngeli historikisht në derën tonë pra shkatërrimin e njeriut, rindërtimin nga e para të njeriut me vlera të vërteta, me vlerat morale, estetike, me vlerat e besimit por edhe me shije.

Sfidat e sotme ne i dimë se janë të frikshme herë pas here, një lloj katastrofe e ka përfshirë si gjendje shoqërinë shqiptare nëpërmjet gjeleve që ne informohemi nga media, ato nuk janë veçse simptomat e një krize të thellë identiteti të besimit dhe edukimit moral vetëvrasjet, vrasjet, motivet, ka rënë shumë ulët pikëpamja për jetën e

njeriut në veçanti dhe për jetën e njeriut si pjesë e pandashme e shoqërisë, të njeriut si një qenie e naltë që ka një destinacion për të përmbushur jetën e tij, të njeriut si element thelbësor të familjes. Në të gjitha këto, dmth. revista “Zani i Naltë” por edhe revista të tjera, të Komunitetit Mysliman, madje dhe të gjitha feve të tjera, duhet që më së pari të ujitet ideja e Zotit, se ka një Zot, se gjërat nuk janë thjesht të rastësishme dhe nuk janë në dorën e njeriut dhe se ne duhet ta meritojmë duke pasur një nderim për rolin e padiskutueshëm të Krijuesit, rolin jo vetëm si Mirëbërës dhe Mëshirues, por si Kurajdhënës në radhë të parë për të përmbushur detyrat tona thelbësore të paktën në jetën prej tokësori, gjë të cilën unë mendoj se pak nga pak duke krijuar atë traditë, madje duke vazhduar gjatë do ta sjellë mes nesh dhe ne duhet t'i japim asaj kuptim duke kontribuar secili madje duke menduar se si kjo të mund të funksionojë, të bëhet tribunë e vërtetë e mendimit intelektual islam, patriotik, kombëtar por edhe letrar e filozofik. Këtë pjesë unë e kam të veçantë dhe me shumë merak; risjellja qoftë e traditës por edhe kontributi konkret i bashkëkohësve të sotëm dmth. pjesën diskursive, filozofike dhe letrare duhet ta evidentojë sepse e ka pasur shumë mirë gjatë viteve ’30.

Unë shpresoj dhe jam plot besim për këtë ndërmarrje se ky forum, kjo revistë, ky medium intelektual që u konfirmua shumë bindshëm në vitet para Luftës së II-të Botërore, do ta realizojë qëllimin e vet për të qenë vërtetë përcjellëse e “Zanit të Naltë”, e asaj që neve të gjithëve na lartëson.



Problemi fetar dhe filozofija

Prof. Vexhi S. DEMIRAJ

II

(vijon nga numri i kaluar)

Si përgjegje të kësaj pyetje paraqiten dy hipoteza: a) Ase do të jenë ndjesitë fetare të krijuara për një herësh dhe në mënyrë të veçantë; b) Ase do të jenë krijuar gradualisht, simbas zhvillimit të zakonshëm të sendeve. Në pranofshim hipotezën e parë, e cila ka qënë pranuar prej filozofëve më të mëdhenj të botës, prej shumë dijetarësh dhe prej shumicës së njerzisë, atëhere ky problem zgjidhet fare lehtë, në mënyrë që ndjenjat fetare janë të krijuara prej një Krijuesi tejvështrues dhe në konformitet me drejtimet e Tij.

Po të pranojmë hipotezën e dytë, që përmbledhet në doktrinën e Evoluëjonizmit, e cila pretendon se fuqit njerzore janë përfundimi i ndryshimevet të shumta, që ka bërë njeriu gjer më sot, si rrjedhje e përshtypjevet të jashtme, atëhere konstatojmë, edhe në këtë rast, se kanë eksistuar disa rrethana të ndryshme, të cilat kanë shkaktuar krijimin dhe mbëkamjen e ndjenjave fetare. Po qe se asht i vërtetë pretendimi i kësaj doktrine se qëllimi, rreth të cilit sillet çdo ndryshim në fushën e qytetnimit, asht pregatitja e njerzimit për plotsimin e nevojave të saj, në këtë rast shofim se ndjenjat fetare, në çdo kohë dhe në çdo rast, kanë qënë një nga shkaqet kryesore të lumtërisë së njeriut. Sidoqoftë, në dasht të jetë krijimi i ndjenjave fetare për njëherësh ase gradualisht, përfundimi i të dy hipotezave vërteton eksistencën e ndjesive fetare.

Sa do që të zgjanohet rrethi i shkencës, prap se prap ajo nuk mundet m'e shue etjen e mendjes së njeriut dhe tendencën e saj për dije dhe njohuni të sybjektevet të ndryshëm. Shkenca, sa do që të triumfojë në shpikje dhe drejtime të reja shkencore, pyetjet: «ç'ka gjendet mbas kësaj bote? Ku vete gjith kjo mizëri dhe nuk këthehet më?», të tilla pyetje mbeten gjithmonë të pazgjidhura prej saj.

Që të mos zgjatemi edhe më tepër mbi këtë pikë, po e përsërisim se eksistenca e mendimevet fetare në të gjithë popujt e botës, zhvillimi i tyre krejt independent prej njani tjetrit, gjallnija e tyre e vazhdueshme në shoqërinë njerzore, eksistenca e ndjesive fetare, sido që të jetë burimi i tyre, si edhe

tendenca e fuqisë mendore për me kuptue sende jashta botës landore, të gjitha këto janë fakte që vërtetojnë më së miri se në fetë, përgjithsisht, ekzistojnë baza të shëndosha, që e drejtojnë njerinë kah realizimet e vlefshme për dinjitetin e tij njerzuer. Të gjitha këto janë fakte që lejojnë me kuptue realitetin themeluer, mbi të cilin janë bazue të gjitha fetë dhe që asht: udhëheqja e njerzisë kah fusha e lumtërisë së përhershme.

Po të ndërmarim me tregue një histori të plotë të problemit fetaro-filozofik, kjo do të thotë se kemi vendosur me përmëndë të gjith historinë e filozofisë, por një gjë e tillë asht krejt e pamundëshme që të përmblihet në një artikull ose në një seri të kufizuar artikujsh. Prandaj kësaj here do të flasim shkurtësisht mbi katër doktrinat filozofike më të përmëndura, që janë marrë me shqyrtimin e problemit fetaro-filozofik, tue përmëndë edhe disa prej filozofëve që kanë diskutue ase pranue njanën ose tjetrën doktrinë.

Doktrina atomiste asht një doktrinë filozofike e themeluar prej filozofit Leucippe dhe e vazhduar prej nshanësit të tij Democrite-it. Me ardhjen e filozofit Anaxagore, doktrina atomiste pësoi një modifikim rranjësuer, pse ay ishte i pari që pretendojë se për rregullimin dhe harmoninë e kësaj botet nevojitet, pa tjetër, një fuqi rregulluese, e cila asht shkaku kryesuer i mbarëvajtjes së kësaj bote. Për këtë arësy, Anaxagore-i ishte i mendimit se ekziston një faktor me randësi, i cili zotnon fuqi, gjallni, mëndje, liri dhe vetëveprim; Ay asht burimi i kësaj bote, i gjallnisë dhe i lëvizjes së saj. Këtë fuqi, që zotnon cilësitë e naltëpërmëndura, Anaxagore-i e quente

me emrin «Nous» që don me thanë «mëndje». Kjo «mëndje» asht shpirti, që, prej kaosit ka nxjerrë harmoninë që shofim dhe asht lëvizësi i landës. Do të shofim, më vonë, kur të diskutojmë këto doktrina mbasi të mbarojmë paraqitjen e mbrendisë së tyre, se si atomismi, që, në kohët moderne ka marrë emrin materializmë, asht një doktrinë me baza krejt të gabueshme dhe se si filozofët materialistë kanë kundrështue njani tjetrin në paraqitjen e doktrinës së tyre.

Krejtë në kundrështim me doktrinën atomiste gjejmë në Filozofi Doktrinën Theiste, e cila parashef se Zoti asht ay që ka krijue landën prej asgjasë. Kjo ide asht baza e të gjitha besimevet fetare. Eksistenca e një Zotit të vetëm ka qënë boshiti, rreth të cilit sillen besimet e të gjith njerzëvet që prej atyre që nuk kanë bërë pjesë të konsiderueshme të qytetnimit të sotshëm dhe deri te besimi i filozofit Scheilermacher. Doktrina theiste ka qënë ndjekur rigorozisht prej filozofvet Platon, Aristo, Leibniz dhe Kant. Të gjith këta kanë besue dhe kanë qënë të një mendimi se Zoti asht shkaku kryesuer i eksistencës së kësaj bote.

Një doktrinë tjetër filozofike asht edhe racionalisme-i, doktrinë e cila pranon eksistencën e një Zotit të plotfuqishëm, i cili din çdo gjë që ngjet në natyrë. Tue pranue këtë thezë, racionalisme-i ngulmon në kotsinë e idesë së atheistëve dhe vërteton eksistencën hyjnore. Filozofët racionalistë janë të mendimit se vetëm mëndja, pa ndihmën e revelacionit dhe të mrekullivet, asht në gjëndje që të njohë Zotin e Plotfuqishëm ase Shkakun e të gjith shkaqevet dhe se kjo Fuqi nuk ka nevojë për stabilizimin e sistemevet të veçanta, të cilat

zhduken n'oceandin e pafund hyjnuer. Rationalisme-i nga një anë përqafton disa mendime t'Atomistit, si ajo që i përket rregullimit të landës, dhe nga ana tjetër pranon disa ide të Pantheistit. Theismi dhe Rationalismi bashkohen në pranimin e një Zoti të Plotfuqishëm sipër natyrës, që e sundon botën prej së naltë, ndër filozofët theistë shkojnë edhe më tutje, tue besue se e mira dhe e keqja janë në fuqi të Tij, i shpërblen dhe i ndeshkon njerzit në bazë të veprave të tyre dhe se veprat e Zotit janë aq të nalta, sa që nuk mund të kuptohen me ndërmjeksi të mëndjeve t'ona.

Një doktrinë, krejtë ndryshe prej të parave, asht Doktrina Pantheiste, e cila ngulmon n'idenë se Fuqija Hyjnore ndodhet në këtë botë dhe se Ajo asht dominuese e çdo gjaje. Pantheismi nuk e pranon eksistencën hyjnore në formë independente dhe jashtë krijesave, por Zoti dhe fuqija e mbrendëshme e kësaj bote janë të njëjshme. Në të vërtetë, asht shumë e vështirë përkufizimi i doktrinës pantheiste, sa që Goethe thotë: «Gjër më sot nuk kam parë as një njeri që të kuptojë, në një mënyrë të përsosur, përmbajtjen e fjalës së Pantheistit». Megjithatë, kjo fjalë tregon se Doktrina Pantheiste beson se Zoti asht çdo gjë dhe se çdo gjë bën pjesë të fuqisë së Zotit. Perëndija dhe rrozullimi nuk janë të ndarë prej njëri tjetrit, por përmbajnë një tanësi të vetme. Pantheismi nuk pranon idenë se Zoti qëndron në vehte dhe krejtë i veçuar prej botës, ashtu sikur se besojnë doktrinën theiste dhe rationaliste, por ajo e dliërë Zotin prej të gjitha cilsivet njerzore dhe refuson trupëzimin e Tij. Pantheismi beson se Zoti asht Krijuesi


i gjith botnavet, Shkaku veprues dhe rregullues i përhershëm. Ay asht shpirti dhe bota mendimi i Tij, sepse po të eksistonte ndonjë gjasend për veç Zotit, ajo do t'ishte e kufizuar dhe nuk do të ndodhesh në çdo vënd dhe se fuqija e saj nuk do të ishte dominuese e çdo sendi. Pantheistët shkojnë edhe më larg; ata besojnë se Zoti ndodhet në çdo atomë të botës, në çdo bimë të fushave dhe në çdo gjethe të pemëve si edhe në çdo shtazë përgjithsisht.

Poeti angles, Shelley (1772 – 1822), i drejtohet Zotit në këtë mënyrë: «Nuk asht vetëm fleta më e vogël, e lëvizun prej fladit, një pjesë e Juaja; Jo kurrë, por edhe krymbi më i vogël, që ushqehet ndër vorreza, bën pjesë në jetën Tuaj të ngahershme».

Mbasandaj, poeti në fjalë shton edhe këtë frazë: «Me ndërmjeksi të këtij Shpirti që ndodhet në çdo vënd, çdo kreatyrë përfiton gjallninë e saj dhe ky Shpirtë asht vetë kreatyra».

Poeti gjerman, Heine (1799 – 1856) në librin e tij të vlefshëm: «Feja dhe Filozofija në Gjermani» e përkufizon Pantheismën në këtë mënyrë: «Pantheismi përmbledhet n'idenë se Zoti asht vetë bota. Mbassi Heine tregon të çfaqurit e Perëndisë në natyrë, thotë më në fund se Zoti i asht shfaqur njeriut në një mënyrë më të plotë, shfaqje, q'ë bën atë të ndjejë dhe të gjykojë. Pra, të shfaqurit e Perëndisë në njerinë asht në një formë më të përsosur, q'ë bën jo vetëm çdo individ, por gjith gjininë njerzore të kuptojë eksistencën e saj. Prandaj na lejohet me thanë se Perëndija asht personifikuar në gjininë njerzore».

Kjo asht me pak fjalë një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së katër



doktrinave filozofike që janë marrë me diskutimin e problemeve fetare. Tue gjurmue realitetin e fevet, një problemë shoqruer shumë i randësishëm na paraqitet përpara: asht distanca shumë e largët që ekziston në mes njerzëvet dhe të realiteti fetar. Disa t'ashtuquajtur intelektualë, si edhe disa të tjerë që kanë nevojë për kohë të gjatë me iu afrue oqeanit të pafundë të shkencës, e konsiderojnë fenë si një fantomë që tmeron njerzinë dhe pengon aspiratat e njeriut për të përfitue nga begatit dhe dhuratat e natyrës, që janë krijuar prej të Plotfuqishmit për lartësimin dhe

lumtërinë e njeriut. Jo vetëm këta, por edhe një pjesë tjetër, pak a shumë e konsiderueshme, ka nxjerrë prej realitetit fetar vetëm konkluzionin që përfaqshohet në shërbimet fetare, tue mos ia afrue, sadopak, essencës së fesë, që kulminohet në sinthezën e të gjithë virtytevet, t'adoptuar jo vetëm prej fevet, por edhe prej të gjithë sestemevet filozofike, morale dhe shoqruore. Këtë realitet të pakontestueshëm të fevet përgjithsisht, dhe sidomos begatit e Islamizmit, do të mundohemi, nëpërmjet të shtyllave të kësaj Reviste, në bashkëpunim të shokvet dhe të dashamirësve, me i a paraqitë të gjithë atyreve që iu intereson lumtëria kolektive e këtij

populli dhe sidomos sot që Fashizmi asht stabilizue në të gjithë aktivitetet e Shoqnisë Shqiptare. Në se Fashizmi, doktrinë realiste, ka triumfuar dhe ka për të triumfuar gjithmonë edhe më tepër, kjo varet jo vetëm për meritë të përplotësisë së saj objektive dhe doktrinale, por edhe për konsideratën e çmueshme që e quan fenë një nga shtyllat më kryesore të mbarëvajtjes dhe të qytetnimit njerzuer.¹

1. Marrë nga revista "Kultura Islame", Viti I, dhjetor 1939 (Dhil Kade 1358), Nr. 4, fq. 139 – 143.

Pasqyrat e fletoreve dhe e rivistave qi janë botuar prej vitit 1882 deri në fund të vitit 1927 nga Teki Selenica¹

Autori në këtë libër, është përpjekur të pasqyrojë botimet e fletoreve dhe revistave të ndryshme të botuara nga viti 1882 e deri në fund të vitit 1927 dhe disa prej të cilave e vazhduan aktivitetin e tyre botues edhe në vitet e mëvonshme.

Koha e botimit dhe e pushimit	Titulli	Drejtori	Vendi	Gjuha e përdoruese
1882 – 83	Drita (1883=Ditura)	Shoqëria e Stambollit	Stamboll	Shqip
1883 – 87	Flamuri i Arberit	De Rada	Itali	Shqip – italisht
1887	Arberi i ri	Petta e Schirò	Palermo	Shqip – italisht
1888 – 96	Shqipetari (Albanesul)	Nikoll Naço	Bukuresht	Shqip – rumanisht
1896 – 1909	Albania	Faik Konica	(deri në 1902: Bruxelles (mbas 1902: London	Shqip – frëngjisht herë herë edhe tyrqisht
1896	Ili i Arberéshevë	–	?.. n'Itali	–
1898 – 1902	Yll'i i Shqipërise	Dh. Ilio	Bukuresht	Shqip – greqisht – rumanisht
1899 – 1902	Albania e vogël	Faik Konica	Bruxelles	Shqip
1899	Zeni i Shqiperise	Mehmet Frashëri e Dervish Hima	Roma	Shqip – frëngjisht
1901	Drita	Shahin Kolonja	Sofia	Shqip – greqisht
1904	Bésa	Abrami e Dutshi	Kairo	Shqip – frëngjisht – greqisht – tyrqisht
1904	Flamuri i Shqiperis	Schirò	Napoli	–
1904	Laimtari i Shqypenis	–	Roma	Shqip – italisht
1905	L'Albanie	D. Hima	Bruxelles	Frëngjisht – shqip
1905 – 1907	Shpnesa e Shqypenis	Nik. Ivanaj	Dubrovnik	Shqip – italisht – kroatisht
1905 – 1907	Kombi	Sotir Péci	Boston	Shqip – frëngjisht
1907	Shqiperija	Nikolla Lesho	Sofje	Shqip
1907	Dashamiri	–	Trieste	Shqip
1908	Besa	M. Frashëri	Stamboll	Shqip – tyrqisht
1908	Bashkimi	M. Shahi	Stamboll	Shqip – tyrqisht
1908 – 1910	Bashkimi i kombit	Fehmi Zavalani	Manastir	Shqip – tyrqisht
1908 – 1910	Liria	Lumo Skendo	Selanik	Shqip
1908 – 1910	Korça	Sami Pojani	Korçë	Shqip – tyrqisht
1909	Shqipetari	D. Hima	Stamboll	Shqip – tyrqisht
1909	Diturija	Lumo Skendo	Selanik	Shqip
1909	Shkumbini	H. Delvina	Stamboll	Shqip – tyrqisht
1909 vazhdon	Dielli	Faik Konica	Boston	Shqip
1910 – 1912	Drita	Ali Panariti	Manastir	Shqip – tyrqisht
1910 – 1926	Koha	Mihal Grameno	Korçë	Shqip
1910	Zgjimi	Shoqëria Bashkimi	Janinë	Shqip – tyrqisht
1909 – 1910	Lidhja Orthodhokse	Mihal Grameno	Korçë	Shqip

1. Selenica, Teki; “Shqipnia më 1927”, Tiranë, 1928.

Zani i Naltë

Koha e botimit dhe e pushimit	Titulli	Drejtori	Vendi	Gjuha e përdoruese
1910	E Verteta	Leonidhe Frashëri	Stamboll	Shqip
1910 – 1911	Tomori	Lef Nosi	Elbasan	Shqip
1910	Bashkimi	D. Ndoc Nikaj	Shkodër	Shqip
1910 - 1915	Liri e Shqipërisë	Kristo Luarasi	Sofia	Shqip
1912	Atdheu	Jaon N. Mihail Lehova	Shkodër	Shqip
1910 – 1915 1920 – 1921	Taraboshi	Terenc Toçi	Shkodër	Shqip – italisht
1913	Përlindja Shqiptare	D. Berati	Vlorë	Shqip
1913	Besa Shqyptare	D. Ndoc Nikaj	Shkodër	Shqip
1913	Zgjimi	Dhori Kotti	Korçë	Shqip
1914	Populli	Mustafa Qulli	Vlorë	Shqip
1914	Zana	Zonja Lulo Malësori	Durrës	Shqip
1914	Trumpeta e Krues	L. Naçi	Durrës	Shqip
1914	Ushtrim i Krues	Josif Bagëri	Durrës	Shqip
1914 – 1916	Përparimi	Gjon Bazhdari	Shkodër	Shqip
1915	Zani i Shkodrës	D. Ndo Nikaj	Shkodër	Shqip
1917 – 1918	Posta e Shqypniës	A. Gjergj Fishta	Shkodër	Shqip – gjermanisht
1917 – 1922	Konkordia	Vasil Dilo	Gjirokastrë	Shqip
1918	Kuvendi	Sotir Gjika	Roma	Shqip – italisht
1918	E Vërteta	(prej Shoq. Djelmunija)	Stambollë	Shqip
1918 – 1919	Qarku Letrar	–	Elbasan	Shqip
1919	Opinga	Nikolla Lako	Boulogne (Seine)	Shqip – frëngjisht
1919	Koha e Re	N. Ivanaj	Shkodër	Shqip
1919	Kombi	–	Shkodër	Shqip
1919 – 1923	Agimi	Kristo Floqi etj.	Shkodër	Shqip
1919 – 1924	Hylli i Dritës	–	Shkodër	Shqip
1920	Zani i Ri	Osman Myderizi	Tiranë	Shqip
1920 vazhdon	Shqipëri e Re	Mihal Xoxe	Konstancë	Shqip
1921 – 1922	Bagëti e Bujqësi	Drejtorja e Bujqësis	Tiranë	Shqip
1921 – 1922	Grueja Shqiptare	–	Shkoder	Shqip
1921 – 1921	Shkreptima e Korçës	Muamer Abidin	Korçë	Shqip
1921 – 1922	Shpresa Kombëtare	Marigo J. Pozio	Vlorë	Shqip
1921	Shkëndija	Mehmet Vokshi	Shkoder	Shqip
1921 – 1923	Mbrojtja Kombtare	Dom Mark Vasa	Vlore	
1921 – 1923	Shkolla e ré	Gasper Mikeli	Shkoder	
1921	Posta e Korçës	Zhan N. Gorguzi	Korça	
1921 - 1923	Mbleta	Evdhoksia Germenji	Korçë	
1921	Qarku i Bilishti	Mazllum Bilishti	Bilisht	

Zani i Naltë

Koha e botimit dhe e pushimit	Titulli	Drejtori	Vendi	Gjuha e përdorur
1921 – 1922	Shkumbini	Filip Papajani	Elbasan	
1921 – 1922	Kumtari Arsimuer	–	Tiranë	Shqip
1921	Rasegna italo-albanese	–	Palermo	Italisht – shqip
1921	Drita	Veli Harshova	Gjinokastës	Shqip
1921 – 1922	Atdheu	Seid Kemal	Vlonë	Shqip
1921 – 1923	Perparimi	Petro Harizi	Korçë	Shqip
1921 – 1923	Agimi	Karl Gurakuqi	Shkoder	Shqip
1921 – 1923	Reforma	Varfe Ali Prishta	Klisyrë	Shqip
1921 – 1922	Fial e lirë	Abdul Kuçi	Vlonë	Shqip
1921 vazhdon	Djalëria	Shoqnija studente Vjenë	Vjenë	Shqip
1921 – 1922	Jet' e Re	(Fazli Frashër Selim Mborja)	Korçë	Shqip
1922	Shpresa e atdheut	–	Romë	Shqip
1922	Djersa e Bulkut	Gani Aliko	Fjer	Shqip
1922	The Albanian Journal	–	Chicago	Inglisht – shqip
1921 – 1923	Dodona	Jorgji D. Bubani	Kostancë	Shqip
1921 – 1923	Minerva	R. Kolaj	Graz	Shqip
1921 – 1922	Dit' e re	Teki Selenica	Tiranë	Shqip
1922 vazhdon	Fletorja zyrtare	Zyra e Shtypit	Tiranë	Shqip
1921 – 1923	Shkëndia	Milto Sot. Gurra	Korçë	Shqip
1921 – 1923	Kryqi i kuq Shqiptar	Dr. A. Sadedin	Tiranë	Shqip
1922	Rilindja Shqiptare	Louis Dufour	Paris	Shqip
1922	Perilindja Arsimtare	Thoma Abrami	Korçë	Shqip
1922	Zekthi	M. S. Gurra	Korçë	Shqip
1922 – 1924	Arsimtari	Beqir Tafani	Tiranë	Shqip
1922 – 1924	Revista Pedagogjike	Salih Çeka	Tiranë	Shqip
1922 – 1926	Afrimi	Mehmet Vokshi	Shkodër	Shqip
1922 – 1924	Shqiptari i Amerikës	Leoni Kristo	Korçë	Shqip
1922 – 1926	Elbasani	A. Hastopalli	Elbasan	Shqip
1922 – 1923	Zëri i popullit	Petraq Katro	Korçë	Shqip
1923	Flamuri	A. Sula	Tiranë	Shqip
1923 – 1924	Shtypi	Dr. Terenc Toçi	Tiranë	Shqip
1923	Bota e Re	Faik Konica	Boston	Shqip
1923	Mprojtja e Vatres	G. A. Katundi	New - Bedford	Shqip
1923 – 1924	Populli	Bedri Pejani	Tiranë	Shqip
1923 - 1923	Politika	Seid Kemal	Vlonë	Shqip
1923	Rraporta të përjavëshme	Dr. Ernest Novack	Tiranë	Shqip
1923	Fletorja e Klerit Katolik	D. L. Shantoja	Shkodër	Shqip
1923	Rrufeja	H. Jusuf Banka	Tiranë	Shqip
1923 – 1924	Ura e Skumbinit	Ahmet Dakli	Elbasan	Shqip
1923 – 1924	Shqyptari i lirë	Av. E. Kokona	Tiranë	Shqip
1923 vazhdon	Zani i Naltë	Ismail Maçi	Tiranë	Shqip
1923	Zëri i Gjinokastres	P. Harito	Gjinokastër Shqip	

Zani i Naltë

Koha e botimit dhe e pushimit	Titulli	Drejtori	Vendi	Gjuha e përdorur
1923	Xhurnalli Politik	–	në Shtetet e Bashkueme	Shqip
1923	Dëshira Kombtare	–	në Shtetet e Bashkueme	Shqip
1923 - 1924	Paqja	Nastas Frashëri	Stamboll	Shqip
1923	Purteka	–	Boston	Shqip
1923	Kombi në rrezik	–	Boston	Shqip
1923 – 1924	Ora e Maleve	Shuk Gurakuqi	Shkoder	Shqip
1923 vazhdon	Gazeta e Korçës	Zhan Gorguzi	Korçë	Shqip
1923	Afërimi	Petro Scaglione	New-York	Shqip
1923	E Drejta	Leonidha Naçi	Korçë	Shqip
1923 – 1924	Shpresa Kombëtare	N. Disdari	Shkodër	Shqip
1923 – 1924	Vllaznija	N. Shllaku	Shkodër	Shqip
1923 – 1925	Republika	N. Ivanaj	Shkodër	Shqip
1923	Bised' e lirë	P. Harito	Gjirokastrë	Shqip
1923 - 1924	Xhoka	Hakki Fefiku	Tiranë	Shqip
1923	Udha e së vërtetës	H. Kadri	Shkodër	Shqip
1923	Liçeni	Xhevat Starova	Korçë	Shqip
1924 – 1926	Dajti	H. I. Dalliu	Tiranë	Shqip
1924	Dokumenta Historike	Lef Nosi	Elbasan	Shqip
1924 vazhdon	Laboremus	Shkolla Teknike	Tiranë	Shqip - anglisht
1924	Bota	–	Korçë	Shqip
1924 – 1924	Ku vemi	Salih Çeka	Tiranë	Shqip
1924	Shpresa	Petro L. Peppo	Korçë	Shqip
1924 – 1924	Bashkimi	Llazar Fundo	Tiranë	Shqip
1924 – 1925	Gjergj Kastrioti	Dr. Visar Xhuvani	Tiranë	Shqip
1924 – 1924	Shekulli	Bahri Omari	Tiranë	Shqip
1924	Lirija	Av. V. Dilo	Tiranë	Shqip
1924	Reforma	Nebil Çika	Tiranë	Shqip
1924 - 1925	Tirana	Av. V. Dilo	Tiranë	Shqip
1925	Brezi i ri	Pashuk Ndok Illia	Shkodër	Shqip
1925	Indipendenca Shqiptare	Kristo Floqi	Tiranë	Shqip
1925 vazhdon	Zani i Popullit	Kol Mjeda	Shkoder	Shqip
1926	Labëria	Xhevad Kallanxhiu	Gjinokastër	Shqip
1926 vazhdon	Zëri i Korçës	Dhori Kotti	Korçë	Shqip
1926 – 1927	Rilindja Shqiptare	Namik Selim Delvina	Tiranë	Shqip
1926 vazhdon	Demokratia	Xh. Kallanxhi	Gjinokastër	Shqip
1926 – 1927	Shqipnia	L. Naçi	Tiranë	Shqip
1926 vazhdon	Dituria	Lumo Skendo	Tiranë	Shqip
1926 vazhdon	Jeta	Kryqi i kuq	Tiranë	Shqip
1927 vazhdon	Telegrafi	K. Cekrezi	Tiranë	Shqip
1927 vazhdon ²	Kombi Shqiptar	P. Harizi	Tiranë	Shqip

2. Tregon se në vitin 1928, kur autori e ka botuar këtë tabelë, revista ka vazhduar botimin.

Rregullat e shkrimit

Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.

2. Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.

3. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt i shkurtër, duke radhitur të gjitha nënçështjet.

4. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtron.

5. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat, që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij.

6. Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data – Muaji – Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.

7. Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.

8. Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 10 referenca dhe vepra.

9. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që ka studiuar dhe referuar duhet vendosur në formë citati, në thonjëza, shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë.

10. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë, autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marrë citati.

11. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë: p.sh. akses më 10 Maj 2008. Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me «Justify».

12. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.

13. Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.